



Mbështetur nga:

FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Shtator 2021



28

REKOMANDIME

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE
NGA GJYKATA E LARTË

Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Fondacionit.

Autorë: Av. Theodoros Alexandridis
Dr. Irena Dule
Av. Dorian Matlija

Botues: Qendra “Res Publica”

28

REKOMANDIME

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE
NGA GJYKATA E LARTË

TREGUESI I LËNDËS

5 Hyrje

7 Konteksti

7 Sfondi i reformës në Drejtësi

9 Ndryshimet ligjore në kuadër të reformës në drejtësi

10 Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)

13 Gjykata e Lartë

15 Efektet e reformës dhe mosfunksionimi i Gjykatës së Lartë

15 Efektet anësore të shkaktuara nga largimi i gjyqtarëve nga sistemi

17 Cfarë është bërë për uljen e numrit të çështjeve

27 Praktika e GJEDNJ dhe praktika të tjera të mira

27 Hyrje

28 Rekomandimet për trajtimin e çështjeve të prapambetura pranë Gjykatës së Lartë në bazë të standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

41 Çfarë tjetër mund të bëhet?

41 Shqyrtimi i vendimeve të mospranimit nga një gjyqtar

42 Plotësimi i trupave gjyqësore me gjyqtarë të lartë në një kohë të shpejtë

44 Plotësimi i personelit ndihmës me këshilltarë/nëpunës të tjerë brenda organikës

44 Kufizimi i çështjeve që mund të gjykohen nga Gjykata e Lartë

45 Kompjuterizimi i regjistrimit dhe menaxhimit të çështjeve dhe digjitalizimi i dosjeve të çështjeve dhe komunikimeve

TREGUESI I LËNDËS

- 46 Ndryshimet ligjore dhe të politikave gjyqësore

- 48 Kontroll i praktikave të autoriteteve administrative të cilët janë burimet e mosmarrëveshjeve ligjore

- 49 Masat praktike për të luftuar abuzimin me të drejtat procedurale

- 49 Dhënia e shpërblimeve për produktivitet

5 | Monitorimi i udhërrëfyesit

- 51 Emërimi/Komandimi i Këshilltarëve Ligjorë, si dhe personelit administrativ mbështetës në GJL

- 53 Emërimi/Komandimi i Kancelarit të Përhershëm të Gjykatës së Lartë

- 53 Qendra e Dokumentacionit si personel administrativ mbështetës

- 54 Emërimi dhe ngritja në detyrë e Gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë

- 55 Kohëzgjatja e procesit të vetingut

- 56 Përmirësimi i Metodave dhe Proceseve të Punës

- 56 Sigurimi i burimeve financiare

- 57 Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura

- 58 Metodologjia e punës për administrimin e dosjeve gjyqësore të prapambetura

- 59 Kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi

- 60 Ndryshimet ligjore

6 | Përmbledhje sintetike e rekomandimeve

- 61 Ndryshimet ligjore

- 63 Masat që mund të merren nga qeveria

- 64 Masat që mund të merren nga KLGJ

- 67 Masa që mund të merren nga Gjykata e Lartë

I. HYRJE

Ky raport u hartua nga ekspertë të Qendrës “Res Publica”, në kuadër të projektit “Përmirësimi i efektivitetit të evadimit të dosjeve në Gjykatën e Lartë”, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Raporti ka për qëllim vlerësimin e efekteve negative të reformës në drejtësi lidhur me numrin e lartë të dosjeve në Gjykatën e Lartë dhe rekomandimin e masave për rikthimin e normalitetit dhe efikasitetit të Gjykatës së Lartë, me qëllim përshpejtimin e gjykimeve dhe uljen e numrit të çështjeve që presin të gjykohen. Raporti është hartuar pas konsultimeve me grupe interesi, avokatë dhe nëpunës të gjykatave.

Pas miratimit të Reformës në Drejtësi në vitin 2016, si një nevojë për rritjen e paaanësisë dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor, sot, 5 vjet pas miratimit të saj vihen re problematika të shumta lidhur me funksionalitetin e gjykatave. Për shkak të procesit të vetingut, shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar e shumë të tjerë janë dorëhequr duke krijuar kështu vakanca masive në sistemin gjyqësor. Por, teksa numri i gjyqtarëve sa vjen e reduktohet si pasojë e reformës, numri i çështjeve rritet në përpjestim të zhdrejtë. Si rrjedhojë, stoku i çështjeve në pritje për t’u gjykuar i kalon kapacitetet e mundshme që mund t’i përgjigjen dhe të mund të shqyrtohen në afatet e arsyeshme në të gjitha gjykatat, si dhe në Gjykatën e Lartë, që është në fokus të këtij raporti.

Mosfunksionimi i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që cenon parimin e shtetit të së drejtës, duke mos i dhënë mundësi efektive ankimi qytetarëve, por gjithashtu e lë shtegun të hapur që qytetarët të ankohen për vendimet e dhëna nga gjykatat e apelit direkt në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Mundësia që kjo gjykatë të marrë një vendim kundër shtetit u rrit për shkak të mungesës së këtyre filtrave kombëtarë (Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese), duke sjellë kështu potencialisht kosto shtesë për buxhetin e shtetit shqiptar.

Nga ana tjetër aksesin në drejtësi mbetet një përparësi kyçe në një shtet demokratik. Funksionimi i Gjykatës së Lartë është thelbësor për sistemin e drejtësisë në Shqipëri me efekte të drejtpërdrejta në jetën e qytetarëve. Mungesa e Gjykatës së Lartë është kritike, pasi çështjet që vijnë nga gjykatat më të ulta nuk mund të marrin një zgjidhje përfundimtare, dhe kështu Shqipëria shkel sistematikisht të drejtën për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

Nëse situata aktuale prek edhe mekanizmin e përshpejtimit dhe dëmshpërblimit ndaj tejzgjatjes së tepruar të procedurave gjyqësore, kjo me shumë gjasë do të çojë në rritjen e numrit të çështjeve që përfundojnë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në raportin në vijim janë adresuar problematikat e mësipërme, së pari pasi janë vlerësuar shkaqet që kanë krijuar këtë anomali, të cilat trajtohen në pjesën e dytë të raportit. Në po të njëjtën pjesë gjendet një përshkrim i funksioneve dhe kompetencave të Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) si dy organet kryesore të cilat kanë barrën dhe kompetencën për zgjidhjen e problemit. Në pjesën e tretë janë vlerësuar praktikrat e mira të vendeve të cilat janë përballur me një problematikë të ngjashme, përfshirë vetë Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në pjesën e katërt trajtohen efektet e reformës duke e ndarë këtë pjesë në dy nënkapituj, ku në njërin trajtohen se cilat janë masat që tashmë janë marrë për të pakësuar efektet negative në fjalë dhe në nënkapitullin tjetër trajtohen se cilat janë masat e tjera që mund të merren në të ardhmen. Një pjesë e posaçme i është lënë monitorimit të Udhërrëfyesit të KLGJ-GJL për efikasitetin e Gjykatës së Lartë 2020-2021, si akti më konkret që adreson problematikën e numrit të lartë të dosjeve në pritje për gjykim, që gjendet në pjesën e pestë të raportit.

Në përfundim, në mënyrë të përmbledhur jepen gjetjet dhe rekomandimet për masa të tjera ndihmuese në uljen e numrit të çështjeve, pa u kufizuar vetëm në masa administrative, por duke kërkuar edhe masa legislative për adresimin e problemit.

Është e rëndësishme të theksohet se, në fokus të hartuesve të këtij raporti, rekomandimet janë dhënë duke mbajtur parasysh nevojën për të mos kompromentuar cilësinë e vendimarrjes dhe ruajtjen e standardit të procesit të rregullt ligjor.

II. KONTEKSTI

2.1. Sfondi i reformës në Drejtësi

Reforma në sistemin e drejtësisë është një nga reformat më të thella dhe gjithë përfshirëse të ndërmarra në Shqipëri gjatë viteve të fundit, e cila synon të adresojë problemin e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të evidentuara ndër pengesat kryesore për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik shoqëror të vendit dhe antarësimin në Bashkimin Evropian.

Pas miratimit të amendamentit kushtetues në vitin 2016 dhe miratimit të një sërë ligjesh organike, nisi efektet kjo reformë, që përfshinte sistemin e drejtësisë në tërësi. Faza e parë e implementimit të saj ka qenë e ngarkuar me dinamika politike dhe vështirësi menaxheriale për shkak të kompleksitetit të kryerjes së disa veprimeve rrënjësore njëkohësisht. Për pasojë, siç ishte relativisht e pritshme, pasuan një sërë efektesh anësore.

Pas pesë vitesh të aplikimit të këtij projekti, ndër efektet negative të reformës në drejtësi dhe procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve (veting), megjithëse me vonesa, shkaktoi dhe vijon të shkaktojë vakanca të konsiderueshme në gjykata dhe prokurori, gjë e cila është shoqëruar me një ndikim të fortë në mbarëvajtjen e rregullt të procedurave, volumit të ngarkesës, shpërndarjes së saj dhe afateve në dhënien e drejtësisë.

Megjithëse Reforma në Drejtësi është ndër shkaqet kryesore të stokut të madh të çështjeve, vonesat që kanë ardhur ndër vite kanë patur ndikimin e saj në shpejtësinë e shqyrtimit të çështjeve. Në mënyrë skematike shkaqet e ngarkesës së dosjeve që pritet të shqyrtohen nga gjykata e lartë paraqiten si vijon:

- Mungesa e infrastrukturës dhe probelemeve të tjera para reformës
- Rënia e ritmit të punës së gjyqtarëve para vetingut
- Mungesa e gjyqtarëve dhe mosformimi i trupave gjyqësore gjatë vetingut
- Mbingarkesa dhe numri i ulët i gjyqtarëve pas vetingut

Situata nuk ka qenë normale edhe para se të fillonte reforma në drejtësi. Nuk ka patur një sistem elektronik efikas dhe sistemi i punës ishte manual. Gjykata nuk ka punuar me kapacitet

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

të plotë prej 19 gjyqtarësh. Në kohët e saj më të mira, Gjykatën e Lartë ka funksionuar me 17 anëtarë. Mungesa edhe e një gjyqtari të vetëm krijon vështirësi, pasi nuk formohet dot trupa e rradhës prej 3 gjyqtarësh. Pra, sistemi në tërësi nuk ka funksionuar plotësisht.

Nga ana tjetër një numër i madh me dosje presin të shqyrtohen që nga viti 2012. Ka një numër të konsiderueshëm vendimesh të formës së prerë të pezulluara që në vitin 2013; vendime të prishura e të kthyerat për rigjykim nga gjykatat e apelit; numër të lartë ankimesh të veçanta apo çështje të mbetura pezull prej vitesh, për shkak mosmarrëveshjesh të kompetencës mes gjykatash apo konfliktesh juridiksionale.

Kësaj shtate iu mbivendos faza para veting-ut. Në këtë fazë gjyqtarët prisnin të kalonin në veting dhe kjo shkaktoi shpërqëndrim tek ata në ushtrimin e detyrës, gjë që pasoi me uljen e ritmit të punës. Më tej, vetingu nxorri që në fillimet e tij një numër të lartë gjyqtaresh të lartë nga sistemi. Kjo sollti mangësi në formimin e trupave gjykues, derisa pas dy vjetësh nuk formohej dot asnjë trup gjykues, gjë që e nxorri Gjykatën e Lartë jashtë funksionit.

Gjykata filloi të funksiononte vetëm në muajin Mars të vitit 2020, pas formimit të trupës së parë të gjykatës. Kjo kohë korespondoi me mbylljen e përkohshme të gjykatave deri në muajin Maj 2020 për shkak masave kufizuese kundër pandemisë së shkaktuar nga Covid19. Menjëherë me marrjen e detyrës trupa e parë nisi punën për shqyrtimin e dosjeve, por kapacitetet e kësaj trupe ishin të kufizuara. Në Maj 2021 Gjykata u plotësua edhe me 4 gjyqtarë të rinj dhe në Korrik 2021 kësaj trupe iu shtuan edhe 2 gjyqtarë të tjerë.

Në momentin e hartimit të këtij raporti Gjykata e Lartë funksionon me 9 anëtarë, ndërsa janë formuar 2 trupa gjyqësore për çështjet civile, 2 për çështjet administrative dhe 3 trupa për çështjet penale dhe siç mund të kuptohet lehtë, këto trupa gjyqësore janë kombinim i të njëjtëve gjyqtarë, gjë e cila ndikon në eficiencë. Procesi për të plotësuar vendet vakante vazhdon, por ndërkohë në Gjykatën e Lartë po shtohet me ritme të shpejta sasia e dosjeve për t'u shqyrtuar.

Përveç kësaj, ky numër pritet të ketë një valë tjetër shtimi, nëse kemi parasysh efektet e vakancave në gjykatat e zakonshme, të cilat tashmë janë të mbingarkuara me dosje gjyqësore. Bollëku i çështjeve në pritje për tu shqyrtuar nga këto gjykata do të jetë kontigjent potencial për të shtuar stokun e çështjeve në Gjykatën e Lartë në një moment të dytë, pasi gjykatat e zakonshme do nisin të kthehen drejt normalitetit.

Konkretisht, sipas Raportit Vjetor të KLGJ-së për vitin 2019 rritja e stokut të çështjeve të mbartura në rang vendi, duke përfshirë Gjykatën e Lartë është në nivel të konsiderueshëm, me një rritje prej rreth 18% për 2019, nga 49.196 çështje të mbartura në 2018 në 58.291 në çështje që mbarten nga viti 2019).

Vetëm me numrin e çështjeve të mbartura nga viti 2018 për në vitin 2019, në total 77.853 çështje. Shpërndarja e stokut të çështjeve të mbartura sipas gjykatave është në propocion të drejtë me numrin total të çështjeve ose me ngarkesën e punës që përballojnë këto gjykata. Numrin me të madh të çështjeve të mbartura e mbajnë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, çështje të mbartura të cilave përbejnë 55.972 çështje, ose rreth 72% të çështjeve të mbartura në shkallë vendi.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Po sipas Raportit Vjetor të KLGJ-së, në vitin 2019 u regjistruan 152.399 çështje në shkallë vendi. Nga këto 123.481 çështje janë regjistruar pranë gjykatave të shkallës së parë, 22.769 janë çështjet që janë regjistruar në gjykatat e apelit, nëpërmjet ankimit ose si çështje në juridiksion fillestar të këtyre gjykatave, ndërsa 6.149 çështje u regjistruan në Gjykatën e Lartë. Ndërsa në vitin 2018 numri i dosjeve në pritje në Gjykatën e Lartë arriti mbi 28.000, me një rritje prej 31% në vit, në vitin 2019 numri arriti mbi 31.000 dhe në fund të vitit 2020 ky numër kaloi mbi 39.000 dosje, ku pjesa dërrmuese janë në pritje për t'u shqyrtuar nëse do të kalojnë për gjykim ose jo.

Sipas një llogaritje, me ritmet e sotme, për shqyrtimin e 35.000 dosje do të nevojiteshin 21 vjet. Kjo kohëzgjatje, konsiderohet jo vetëm e paarsyeshme, por dukshëm në disproporcion edhe me kapacitetet e vendeve të rajonit, ku kjo shifër varion nga 2 muaj në rastin e Serbisë, deri në 1 vit e 4 muaj në rastin e Maqedonisë së Veriut. Pra edhe sikur të konsiderohej se Gjykata e Lartë do të kishte në funksion të gjitha trupat e saj (6 të tillë), përsëri do të nevojitej një kohë tepër e gjatë, për uljen e numrit të dosjeve.

Për të gjitha sa më sipër mund të themi se përparimi i ngadaltë i zbatimit të reformës ka çuar në një numër në rritje të çështjeve gjyqësore të prapambetura, për të cilat gjykatat duhet të marrin një vendim. Qytetarët, si përfituesit përfundimtarë të reformës, nuk kanë pasur ende mundësinë për të marrë drejtësi duke hasur një vonesë të vazhdueshme në çështjet e tyre dhe duke zbehur shpresat për të marrë një vendim profesional të gjyqësorit në kohë. Në këtë mënyrë qartazi procesi i vetingut nuk u shoqërua me një plan të menduar mirë për plotësimin e pozicioneve vakante nga gjyqtarët e shkarkuar gjatë periudhës së reformimit dhe për përbalimin e efektëve mbi numrin e lartë të dosjeve në pritje për gjykim.

2.2. Ndryshimet ligjore në kuadër të reformës në drejtësi

Reforma nisi me miratimin e ndryshimeve kushtetuese, në Korrik 2016. Nga 26 nene të Kushtetutës që i përkasin sistemit të drejtësisë, u ndryshuan 21 prej tyre dhe iu shtuan 23 dispozita të reja. Për më tepër, u shkrinë tre institucione të përcaktuara në Kushtetutë dhe u parashikua krijimi i të paktën 12 institucione të reja.

Ndryshimet kushtetuese u pasuan me miratimin e paketës *Ligjet Organike*, si më poshtë:

- Ligj nr. 84, datë 6.10.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 95, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
- Ligj nr. 96, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”¹.
- Ligj nr. 97/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 98/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

1 Shfuqizuar disa nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

- Ligj nr. 115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”²
- Ligj nr. 8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”³

Ndryshimet ligjore prekën edhe kodet si Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil dhe Kodin Penal, si dhe ligjin për gjykimin e mos marrëveshjeve administrative.

Thujtse e gjithë paketa Ligjet Organike dhe kodet iu nënshtruan amendimeve të tjera në maj të vitit 2021, të cilat tentuan të adresojnë edhe përshpejtimin e gjykimeve edhe në Gjykatën e Lartë, si mekanizëm korrigjues i situatës së krijuar, analizë e të cilave gjendet në vijim të këtij raporti.

2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)

Këshilli i Lartë Gjyqësor është një nga organet e reja të krijuara në kuadër të reformës, i cili filloi funksionin e saj në 12.12.2018. Ky organ kushtetues ka më tepër kompetenca se parardhësi i tij Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), lidhur me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore dhe planifikimit financiar, ashtu edhe përcaktimin e standardeve etike profesionale të gjyqtarëve, me qëllim garantimin e një sistemi funksional, të paanshëm, eficient dhe me fokus qytetarin.

Këto kompetenca burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Me funksionet e reja KLGJ merr formën e “qeverisë” së gjyqësorit, ku përfshihet edhe Gjykata e Lartë. Kështu ky organ ka një rol kyç në konstituimin e Gjykatës së Lartë, pasi ai i propozon Presidentit kandidatët e përshtatshëm për të qenë anëtar të saj. Anëtarët e Gjykatës së Lartë zgjidhen me një maxhorancë prej 4/5 nga brenda sistemit dhe 1/5 nga jashtë sistemit.

KLGJ që në momentin e krijimit të saj u përball me vështirësi të shumta, një nga të cilat është mirëadministrimi i sistemit gjyqësor, në kushtet kur për shkak të rivlerësimit kalimtar shumë gjykata po përballen me mungesë të theksuar gjyqtarësh, gjë e cila ndikon në volumnin e çështjeve, zgjatjen e afateve dhe rrjedhimisht në procesin e rregullt ligjor.

Kujtojmë se KLGJ është ngarkuar për vlerësimin e kriterit të pasurisë, përse i përket kandidatëve jogjyqtarë (ndryshe nga kandidatët që vijnë nga rradha e gjyqtarëve, vlerësimi i të cilëve behët nga organet e rivlerësimit kalimtar).

2 Shfuqizuar disa nene me vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 10.4.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017

3 Ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Këshilli e filloi procedurën për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, me vendimin nr. 102, datë 5.7.2019. Në këtë vendim u përcaktuan kriteret e vlerësimit, pikëzimit e të renditjes, si dhe të rregullat më të hollësishme mbi procedurën e përzgjedhjes dhe emërimin e kandidatëve jogjyqtarë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Në përfundim të procesit KLGJ skualifikoi 12 nga 20 kandidatët që kishin shfaqur interesin për të kandiduar, pasi nuk plotësonin kriteret. Rastet e skualifikimit mund të përmbliidhen në mospasjen e gradës shkencore në drejtësi, i cili mbeti dhe shkaku më i zakonshëm. Arsye të tjera lidhen me mbajtjen e funksioneve politike gjatë 10 viteve të fundit, kushtin ndalues të riemërimit në Gjykatën e Lartë, largimi nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe një rast tjetër që kishte të bënte me përvojën profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Gjatë procedurës së shqyrtimit të kandidatëve, kishte edhe raste ku aplikantët që kishin shfaqur interes u tërhoqën nga kandidimi. Tërheqja e subjekteve nga kandidimi është vënë re të ndodhë pas tejkalimit të të gjitha afateve ligjore për depozitimin e dokumentacionit ligjor, i nevojshëm për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidimin për pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Duke qenë se tërheqja nuk është e detyrueshme të shpjegohet apo arsyetohet, nuk dihen arsyet që i kanë shtyrë kandidatët të veprojnë në këtë mënyrë.

Vetëm pas 8 muajsh, në datën 11 Mars 2020, tre gjyqtarë u dekretuan nga Presidenti i Republikës dhe ishin gati për të filluar detyrën. Nga KLGJ ishte parashikuar që i gjithë procesi i verifikimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të kualifikuar, ashtu dhe dërgimi i propozimit pranë Presidentit të Republikës për një pozicion të katërt, të përfundonte brenda muajit Mars 2020. Kjo nuk është bërë e mundur për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë globale COVID-19, e cila çoi në pezullimin e aktiviteteve të Këshillit bashkë me pezullimin e thirrjes për aplikime. Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”, KLGJ vendosi rifillimin e procedurave administrative të pezulluara, por thirrja për aplikime rifilloi kohë më vonë, kur KLGJ me vendimin nr.70, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në mbledhjen e datës 26 Shkurt 2020, ka hapur dhe procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira, 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile. Zgjedhja për plotësimin e gjyqtarëve në seksionin administrativ dhe civil është bërë për shkak të numrit të lartë të çështjeve të regjistruara në pritje për tu shqyrtuar kryesisht në këto ndarje. Sistemi i promovimit të gjyqtarëve është një risi në Shqipëri dhe synon të sigurojë një proces objektiv dhe të paanshëm, i cili bazohet tërësisht në një procedurë transparente dhe konkurruese.

Arsyet e kohëzgjatjes dhe vonesat në emërim të gjyqtarëve sipas KLGJ gjenden dhe varen qoftë nga dinamika dhe nga numri i aplikimeve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, ashtu dhe nga kohëzgjatja që marrin procedurat për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve.

Gjithashtu zbatimi i mekanizmit të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë kushtëzohet, si nga procesi i rivlerësimit kalimtar, ashtu dhe nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve që mund të kandidojnë për t'u bërë anëtarë në këtë gjykatë. Kështu raportohet në raportin vjetor të vitit 2019, nga KLGJ. Ndaj është e pritshme që procedurat të zgjasin më tepër se afatet e parashikuar në ligj apo rregulloret e miratuara nga KLGJ. Nga një

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

përlogaritje e përafërt mendohet që procedurat për zgjedhjen e tyre të shkojnë nga 4 muaj deri në 9 muaj nga moment i mbylljes së thirrjes për aplikim.

Në përpjekje për të adresuar ngarkesën e madhe të lidhur me numrin e lartë të dosjeve, KLGJ më datë 19.07.2019 miratoi planin strategjik për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2019-2020⁴, ku pjesë e planit ishte edhe bërja funksionale e Gjykatës së Lartë dhe reduktimi i çështjeve të mbartura në gjykata, gjë e cila trajtohet në vijim të këtij raporti. Ky dokument nuk e lidh me një detyrim ligjor Këshillin, por është në funksion të efikasitetit të punës së gjyqësorit. Rritja e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë dhe reduktimi i stokut të çështjeve në këtë gjykatë trajtohet me prioritet në këtë strategji, sipas së cilës KLGJ do të ndërmarrë masa jo vetëm për plotësimin e trupës gjyqësore të kësaj gjykate, por edhe për shtimin e burimeve njerëzore mbështetëse në të, zhvillimin e sistemit elektronik, shtimin e buxhetit, etj.

Vlen të theksohet se strategjia parashikon edhe monitorimin e planit të veprimeve të hartuara në kuadër të saj. Nuk kemi informacion nëse është monitoruar kjo strategji apo jo. Në faqen e KLGJ ka një sërë raportesh monitorimi, por që lidhen kryesisht me buxhetin, ndërsa mungon një dokument që të raportojë monitorimin e strategjisë.

Pavarësisht përpjekjeve të KLGJ, nga vlerësimi i situatës të parashtruar si më sipër mund të themi se nisur nga kompetencat e KLGJ, të cilat kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, ky institucion nuk arriti t'i ushtronte ato me efikasitetin e duhur, duke krijuar kështu bllokim institucional. Justifikimi për këtë gjendet te fakti se KLGJ u ngrit vetë me vonesë dhe hartimi i akteve nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë proces, të cilat duhet të jenë cilësore, kërkon kohën e tij, përsëri pasojat janë të dukshme kur institucioni më i lartë gjyqësor në vend ende nuk është funksional dhe ngarkesa e çështjeve në të sa vjen dhe rritet.

Gjithashtu, vështirësitë e KLGJ-së, në realizimin e funksioneve të tij, lidhen ndër të tjera me një sërë faktorësh si mungesa e personelit dhe infrastruktura e papërshtatshme. Përsa i përket personelit, Kuvendi me vendimin nr. 32, datë 26.2.2019, në pikën 1 të tij ka vendosur që stafi i KLGJ-së do të përbëhet nga 125 nëpunës. Pavarësisht këtij vendimi, sipas informacioneve të marra nga KLGJ rezultojnë se në momentin e hartimit të këtij raporti kanë qenë 77 nëpunës⁵. Një pjesë e këtyre nëpunësve erdhën si rezultat i mbartjes së strukturës ekzistuese që kishte pasur më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Por përsëri në organikën e këtij institucioni kemi një mungesë prej 48 nëpunësish.

Përsa i përket infrastrukturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë në administrim ambientet që më parë përdoreheshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për shkak edhe numrit të vogël të nëpunësve që ka pasur KLD (siç reflektohet nga VKM nr. 343/2019), rezultojnë që infrastruktura aktuale nuk është e mjaftueshme për të gjithë organikën e KLGJ-së.

4 Me Vendimin nr. 126 datë 19.07.2019, Këshilli miratoi Planin Strategjik për vitin 2019-2020, i cili është një udhërrëfyes për veprimtarinë e vetë Këshillit dhe sistemit gjyqësor në tërësi.

5 Sipas një përgjigje të KLGJ, kthyer një kërkesë për informacion të qendrës "Res Publica"

2.4. Gjykata e Lartë

Reforma në Drejtësi solli ndryshime thelbësore, si në përbërje dhe kompetencat e Gjykatës së Lartë, ashtu dhe në funksionimin e saj, duke e vendosur tashmë nën kontrollin e KLGJ-së, sa i takon administrimit të gjykatës, përzgjedhjes dhe propozimit për emërim të anëtarëve të saj dhe vlerësimin e tyre.

Pas ndryshimeve ligjore, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit.

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

Misioni ekskluziv i Gjykatës së Lartë do të jetë shqyrtimi i çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njehsimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në këtë kuadër, është vendosur një sistem i filtrimit të çështjeve që paraqiten në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet përcaktimit të shkaqeve taksative të ushtrimit të së drejtës për rekurs.

Sipas këtyre shkaqeve, të cilat janë unifikuar për të tre llojet e gjykimeve, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë çështjet që janë të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo kur vendimi që ankimohet është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjeve të thjeshta ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo do të thotë që nëse Gjykata e Lartë mban një qëndrim për një çështje, të gjitha gjykatat në nivele më të ulta, do të jenë të detyruara që për çështje të njëjta të kenë të njëjtin interpretim të ligjit. Vendimet e unifikuara, të njehsuara do të merren nga trupa jo me 3, por me 5 gjyqtarë.

Gjithashtu në ligj janë përcaktuar dhe kufij monetarë për paditë, poshtë të cilit nuk lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë do të ketë si mision unifikimin e jurisprudencës, ndërsa Kolegjet e Bashkuara do të merren me ndryshimin e saj, kur ndërmjet kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë nuk ka një qëndrim uniform lidhur me një çështje juridike. Këto ndryshime pritet të sjellin si pasojë edhe reduktimin e numrit të rekurseve në vazhdim.

Në fund të vitit 2017 numri i çështjeve të mbartura raportohet të jetë 22.000, ndërsa në fund të vitit 2018 ky numër u rrit me 6.657 çështje, duke mbërritur në 28.657 dosje të patrajtuara. Në mes të vitit 2019, kur kjo gjykatë mbeti me një anëtar nga 19 të parashikuar në organigramën e saj, numri i dosjeve në pritje për t'u gjykuar raportohet të ishte 34.311 ose 5.654 çështje më shumë se një vit më parë (2018).⁶

6 <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/09/RAPORTI-VJETOR-2019-pdf.pdf>

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

Vlen të thuhet se viti 2020 pati një rënie të numrit të çështjeve të ardhura për gjykim në Gjykatën e Lartë me 41% ulje nga viti i kaluar, gjë e cila nëse do vazhdonte kështu, do të frenonte rritjen progresive të numrit të çështjeve në pritje për gjykim.⁷ Më shumë se trend që do të ketë këtë ritëm kjo mund të shpjegohet me numrin më të ulët të çështjeve të gjykuara nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit në vitin pandemic. .

Trupa e re me 3 gjyqtarë të emëruar në mars 2020, u përball me një ngarkesë prej 35,196 çështjesh gjyqësore të pashqyrtuara, me çështje të ardhura në Gjykatë që në vitin 2010. Përveç kësaj, trupa gjyqësore nisi punën në momentin më të papërshtatshëm, pikërisht në kohën kur të gjithë strukturat shtetërore pezulluan veprimtarinë e tyre, si pasojë e pandemisë të shkaktuar nga Covid-19. Nga kjo kohë, kur nisi punën trupa e parë me 3 gjyqtarë, hynë edhe mbi 3.000 dosje të tjera në këtë gjykatë dhe numri në dhjetor 2020 shkoi në 39.054.

Një vit më vonë, në mars 2021, katër gjyqtarë të tjerë iu bashkuan trupës së Gjykatës së Lartë dhe bashkë me dy Gjyqtarët e tjerë të emëruar në korrik 2020, sot Gjykata e Lartë gjykon me 9 gjyqtarë.

⁷ Sipas raportit vjetor të KLGJ, 2020, viti 2020 numëroi 3246 çështje nga 6149 çështje të regjistruara në vitin 2019.

III. EFEKTET E REFORMËS DHE MOSFUNKSIONIMI I GJYKATËS SË LARTË

3.1. Efektet anësore të shkaktuara nga largimi i gjyqtarëve nga sistemi

Nëse në fillim të saj kryefjala e reformës ishte shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk kalonin standardet e vendosura për kalimin e veting-ut, sot vëmendja e aktorëve të përfshirë në reformë apo të atyre që preken nga kjo e fundit, duhet të jetë më e përqendruar tek eliminimi i pasojave negative që kanë shkaktuar këto vakanca dhe në tërësi, të pritshmërive për përmirësimin e standardeve për dhënien e drejtësisë.

Situata në Gjykatën e Lartë me rreth 39 mijë dosje, në pritje për shqyrtim është situatë jo normale. Me këtë sasi dosjesh, jo vetëm çështjet e dorëzuara më parë e që presin gjykimin do të kalojnë dukshëm kohën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, por edhe një çështje e paraqitur sot nuk do të mund të shqyrtohet brenda afateve ligjore, pasi janë në rradhë shumë çështje që presin prej vitesh të gjykohen. Duke zbatuar parimin kronologjik dhe gjykuar çështjet e vjetra, dashur pa dashur, do lihen të rehat në pritje. Kjo situatë pritet të vazhdojë edhe për disa vite të tjera, deri sa situata të normalizohet. Kjo pasi edhe gjyqtarët e rinj që do vijnë, do të duan kohën e tyre që të evadojnë çështjet, duke mos cenuar standardet e cilësisë së gjykimit.

Kohëzgjatja e madhe e dhënies së drejtësisë është e njëvlefshëm me mohimin e drejtësisë sepse shkel parimin e gjykimit në një kohë të arsyeshme, duke rezultuar në shkelje të procesit të rregullt ligjor, parim i mbrojtur nga neni 6 i KEDNJ dhe legjislacioni e jurisprudenca vendase. Ndërkohë, efektet negative në këtë gjykatë do të vijojnë edhe për shkak se gjykatat e zakonshme po përballen me të njëjtën problematikë që vjen duke u përkeqësuar për shkak të largimit të gjyqtarëve nga to.

Vërtet gjykimi në këtë shkallë është zakonisht përtej vendimeve të formës së prerë, por në një numër të madh të rasteve gjykimet në këtë gjykatë pengojnë edhe çështje që janë në gjykim në gjykatat e zakonshme dhe që për arsye procedurale i janë paraqitur Gjykatës së Lartë, pa pasur një vendimmarrje për themelin e çështjes. Nga përvoja e qendrës Res Publica, ende 6 nga 38 paditë e familjeve të viktimave të shpërthimit të Gërdecit kanë mbetur të bllokuara në Gjykatën e Lartë, pasi janë rrëzuar në shkallë të parë për shkak mospagimin e tarifës gjyqësore, apo të keqlllogaritjes së afateve të padisë, por që gjykata e apelit ka vendosur që të

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

rikthejë për shqyrtim këto raste duke konsideruar se paditë janë ngritur brenda afatit dhe/ose nuk duhej paguar tarifë. Gjykimi në shkallë të parë nuk ka rinisur ende sepse palët e paditura (Ministria e Mbrojtjes, MEICO dhe Avokatura e Shtetit) kanë paraqitur rekurse në Gjykatën e Lartë dhe deri në një vendimmarrje nga kjo gjykatë, proceset e personave të sipërpërmendur nuk rinisin, megjithëse vendimmarrjet janë të viteve 2016-2017 dhe se ka kaluar 13 vjet nga tragjedia.

Res Publica ka edhe një sërë rastesh të tjera me profil më të ulët publik, që janë bllokuar për arsye të ngjashme, ku më i spikaturi është rasti i një shtetaseje të huaj, e cila nuk merr dot kujdestarinë e fëmijëve të mitur për shkak se vendimi i gjyqit që ajo fitoi është pezulluar nga Gjykata e Lartë në pritje të shqyrtimit të rekursit të ish-bashkëshortit të saj (që në vitin 2015), duke shkëputur jetën e fëmijëve nga nëna për mbi 6 vjet, me pasoja pothuajse të pariparueshme në lidhjen familjare.

Një problem i mprehtë, që krijohet nga vonesa e shqyrtimit të rekurseve, është edhe cenimi i sigurisë juridike të palëve. Arsyeja kryesore pse vendosen afate për parashkrimin e padive është mbrojtja e sigurisë juridike, që palët potencialisht të paditëshme të mos jenë nën pasigurinë e përherëshme të një veprimi juridik kundër tyre. Ky efekt vjen edhe kur për një çështje që pret shqyrtimin në Gjykatën e Lartë krijohet vonesë e gjatë. Në këtë rast palët ndërgjyqëse jetojnë, njëra nën ankthin dhe tjetra me shpresën e një vendimi eventual të kësaj gjykate, megjithëse ka kaluar shumë kohë që çështja është mbyllur me vendim të formës së prerë, madje edhe është ekzekutuar. Ankthi i njëres palë dobëson aftësitë e investimit të sigurtë për të ardhmen, si dhe shpresa mban peng palën tjetër, duke krijuar apati që dëmton potencialet e reja investuese.

Në pamje të parë, problemi duket i llojit menaxherial, por nuk vjen vetëm për shkak të mungesës së përkohshme të numrit të plotë të gjyqtarëve. Sipas KLGJ, llogaritjet e projeksionit të sipërpërmendur janë bërë me kushtet e një gjykate të plotësuar. Edhe vetë skema ligjore se si funksionon kjo gjykatë është e papërshtatshme për të evaduar dosjet e grumbulluara, duke rrezikuar përjetësimin e këtij kolapsi, që fillimisht u konsiderua i përkohshëm. Për këto arsye nevojitet eksplorimi i të gjitha mundësive, ligjore e administrative, duke marrë shembuj nga gjykata të vendeve të tjera, ku shembulli më i mirë është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka zhvilluar mënyra për të evaduar një numër shumë të madh dosjesh, me pothuaj të njëjtin numër gjyqtarësh si Gjykata e Lartë në Shqipëri, sic u trajtua në kapitullin më sipër. Këto mundësi duhet të sigurojnë gjithashtu ligjshmërinë e ndërhyrjes, për të mos u përballur me pikëpyetje mbi ligjshmërinë e vendimmarrjeve.

Disa hapa janë ndërmarrë ndërkohë për të ulur stokun e çështjeve në pritje për gjykim të cilat i trajtojmë në vijim. Mbetet e rëndësishme të theksohet se për sa kemi informacion, masat që ndërmerren nuk na ka rezultuar që ndiqen nga një monitorim që do të ndihmonte në vlerësimin e efektshmërisë së masës konkrete.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për herë të parë me vendimin nr. 47, datë 11.02.2021, miratoi udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave. Ky udhëzues u përgatit në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë ndërkombëtarë, bazuar në metodologjinë e konsoliduar të CEPEJ dhe ka për qëllim vendosjen e rregullave standarde dhe të unifikuara

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

për të gjitha gjykatat për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave me qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e aktivitetit statistikor të gjykatave duke synuar rritjen e performancës dhe të efikasitetit. Mbetet për t'u parë se si do të zbatohet në praktikë ky vendim.

3.2. Cfarë është bërë për uljen e numrit të çështjeve

Sipas një deklarate për shtyp të Gjykatës së lartë, objektivat e Gjykatës që lidhen me evadimin e dosjeve gjyqësore të prapambetura, mund të përmbliken kryesisht në këto çështje:

- Plotësimi, në muajt e parë të vitit 2021, me të paktën një trupë të re gjyqtarësh dhe në vijimësi, formatimi i plotë i përbërjes së saj;
- Identifikimi i çështjeve ligjore me përmbajtje të njëjtë në lëndë që synon marrjen e vendimeve që unifikojnë praktikën gjyqësore;
- Miratimi së fundmi i modelit të strukturës së Gjykatës së Lartë, si dhe përshtatja e saj me nevojat e gjyqimit që paraqiten nga realiteti i ri kushtetues dhe ligjor;
- Miratimi brenda tremujorit të parë të vitit 2021 të ndryshimeve të domosdoshme në legjislacionin procedural, të cilat e bëjnë më efektiv gjykimin në Gjykatën e Lartë.

Për të realizuar këto objektiva u morën një sërë masash, siç trajtohen në vijim.

a. Metodologjia e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë

Me fillimin e punës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nisi punën duke miratuar një metodologji për trajtimin e numrit të madh të dosjeve që prisnin radhën të gjykoheshin. Kjo metodologji ka në bazë dy parime: atë kronologjik dhe prioritar. Me parimin kronologjik do të gjykohej çështje të vjetra, duke shqyrtuar më parë rekursat e depozituara më herët në kohë.

Ndërsa parimi i çështjeve urgjente priorizon ato rekurse që ligji të detyron t'i shqyrtosh më shpejt. P.sh., nëse është fjala për një çështje ekstradimi ajo është urgjente, pasi ka afate procedurale që duhen respektuar. Nëse ka një çështje juridiksioni, kompetence apo konflikti mes gjykatash edhe këto konsiderohen urgjente. Me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale, Civile dhe ligjin për gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative, i jepet e drejta palës të kërkojë përshpejtimin e një çështje për raste të veçanta dhe urgjente, duke e argumentuar kërkesën.

Efektet e përdorimit të metodologjisë së mësipërme kanë qenë si më poshtë:

Me një trup prej 3 gjyqtarësh janë evaduar brenda 8 muajve, 2 mijë dosje.

Sipas një deklarate për shtyp të Kryetarit të Gjykatës së Lartë⁸, në fund të vitit 2020, metodologjia e ndjekur, por edhe efektiviteti i punës së trupës gjyqësore ka krijuar tashmë bazën e nevojshme dhe mundësinë që pas formatimit të plotë të Gjykatës së Lartë, me 6 trupa gjyqësore, stoku i çështjeve do të evadohet më shpejt. Nëse çdo trupë gjyqësore do të

8 http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Deklarate_per_Median_e_Zevendes_Kryetarit_te_Gjykeses_se_Larte_Z_Sokol_Sadushi_8027_1.php

gjykojë më tepër se 2 mijë çështje në vit, atëherë do të arrihet të gjykojen më tepër se 12 mijë çështje në vit dhe situata do të ndryshojë shpejt për mirë. Llojet e çështjeve që do të gjykojen janë të treja fushave: ato janë çështje civile, penale dhe administrative, por shumica janë të fushës administrative me rreth 800, ndërkohë që 600 janë çështje civile dhe 400 penale⁹. Ju sjellim në kujtesë që Gjykata e Lartë në funksionimin e saj të plotë ka shqyrtuar vetëm 4.413 vendime në vitin 2017 dhe 2.330 vendime në vitin 2018.

b. Memorandumi i mirëkuptimit USAID-KLGJ-GJL

Hapa të tjerë janë ndërmarrë për qëllim të uljes së numrit të çështjeve që presin prej vitesh të gjykojen. KLGJ ngriti një grup pune me fokus reduktimin e numrit të lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë. Ky grup pune në fund vitin 2019 i propozoi KLGJ-së miratimin e një Memorandumi Mirëkuptimi për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, sipas rekomandimeve të Projektit “Drejtësi për të gjithë” mbështetur nga USAID. Memorandumi u miratua me Vendimin nr. 131, datë 30.03.2020 të KLGJ dhe u nënshkrua në datë 29 Prill 2020, nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, së bashku me përfaqësuesen vendore të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Ky memorandum synon të ofrojë mbështetje në drejtim të një pune më efikase për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, parandalimin dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, gjë e cila do të realizohet mes dy metodave kryesore:

- rekrutimin e një stafi mbështetës juristësh, të cilët do të ndihmojnë administratën e kësaj gjykate për të trajtuar me shpejtësi çështjet e stokut të mbetura në gjykatë, (nëpunësit për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura – NUNCP)
- bashkëpunimin me ekspertë për të përfunduar vlerësimin e sistemit aktual të ICMIS-it (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore) dhe përcaktimin e ndryshimeve të nevojshme.

Lidhur me metodën e parë, rekrutimi i juristëve që do të ndihmojnë stafin administrativ të gjykatës është një nga angazhimet më të rëndësishme të këtij memorandumi, i cili filloi të jetëzohet me shpalljen e vendeve vakant për këto pozicione. Kriteret e punësimit në këto pozicione kërkonin përfundimin e masterit dhe eksperiencë pune prej minimumi 2 vjetësh.¹⁰ Bazuar në metodologjinë e ndjekur për rekrutimin e këtij ekipi¹¹, vihet re se për njoftimin

9 Sipas një vlerësimi të GJL, çështjet të ndara sipas fushave vlerësohet të jenë: 51% civile, 32% administrative; 17% penale.

10 Kërkesat miniale për rekrutimin e këtij stafi janë:

- *Të jetë diplomuar në drejtësi nga një universitet i akredituar, pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve. Kandidatët që kanë edhe një diplomë “Master i shkencave” në drejtësi, po ashtu nga një universitet i akredituar, do të kenë përparësi;*
- *Të ketë përvojë profesionale jo më pak se 2 (dy) vjet në një prej këtyre: në sistemin gjyqësor ose në prokurori, në një pozicion juristi brenda administratës publike, në një nga profesionet e lira të ligjit, në profesionin e avokatit, ose në ndonjë pozicion tjetër ekuivalent në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare.*
- *Kombinimi i përvojës praktike të lartpërmendur me mësimdhënien në fushën e drejtësisë do të merret në konsideratë.*

11 Metodologjia e rekrutimit dhe përzgjedhjes të NUNÇP-së

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

lidhur me pozicionet vakante ishin marrë 282 aplikime të plota prej të cilave 139 prej tyre plotësonin kriterin e vendosur lidhur me ekperiencën profesionale, e cila duhet të jetë jo më pak se dy vite. Nga këta, 86 persona plotësonin kërkesën për Provimin e Avokatisë dhe u shqyrtuan kështu për *kriterin e totalit të viteve të eksperiencës*. Në përzgjedhjen e kandidatëve në këtë pikë u ndoq metodologjia e ndarjes së kandidatëve në të nënkualifikuar (më pak se 2 vite përvojë pune) dhe kandidatët e vlerësuar si të mbikualifikuar (6 ose më shumë vite përvojë pune), të cilët në fakt nuk u përzgjedhën për listën e shkurtër pasi u zbatua *kriteri i 2-të deri në më pak se 6 vite përvojë lidhur me fushën e punës*, si kohëzgjatja optimale për këtë pozicion. Konkretisht në listë u filtruan vetëm 32 kandidatë të cilët më pas ju nënshtruan provimit me shkrim.

Përdorimi i kësaj metodologjie mund të ndikojë në efikasitetin e këtij ekipi, duke qenë se jashtë listës përfundimtare që do t'i nënshtrohet më pas provimit kanë mbetur kandidatë të mbikualifikuar, pra me përvojë pune më shumë se 6 vite.

Referuar pagesës mujore bruto prej 87.000 lekësh dhe detyrave që ky ekip ndërmerr, të tilla si:

- kategorizimi i çështjeve (penale, civile, administrative) në nënkategori;
- analizimi i dosjes të çështjes, sipas rendit kronologjik të regjistrimit të saj, nën udhëzimet e këshilltarit ligjor;
- përgatitja e raporteve javore mbi numrin e çështjeve të trajtuara dhe mbi numrin e raporteve të plotësuar mbi çështjet;
- plotësimi i formularit dhe raportit mbi çështjen me të dhënat e nevojshme.¹²

tregon se rëndësia e këtij ekipi dhe përgjegjësitë e tij shkon përtej ndjekjes së procedurave burokratike/administrative. Kategorizimi i çështjeve dhe nënkategorizimi i tyre kërkon një formim mjaft të mirë në fushat respektive dhe analizimi i dosjes po ashtu nëpërmjet hartimit të një “relacioni” dhe formulari lidhur me të, kërkon një nivel të caktuar profesionalizmi.

Mendojmë se përdorimi i një metodologjie të tillë s'kualifikuese për kandidatët e “mbikualifikuar” nuk ndihmon dhe nuk është efikas për vetë rëndësinë që ka kjo strukturë. Përkundrazi, përzgjedhja e aplikuesve që shprehin vullnetin për të kontribuar në një situatë kaq delikate në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë, të cilët kanë një eksperiencë shumëvjeçare profesionale, duhet të prioritetizoheshin në procesin e rekrutimit të nëpunësve.

Gjithashtu paga e ofruar është një pagë “nxitëse” edhe për një person me eksperiencë mbi 6 vjet, ndaj është e paargumentuar mirë se pse këta persona janë përjashtuar nga mundësia e konkurimit. Edhe më e paqartë është vendosja e kriterit të eksperiencës në mësimdhënie që është preference, si jo relevant për përshkrimin e detyrave të pozicionit të punës. Për shembull çfarë përparësie do të kishte një pedagog i të drejtës agrare (pa marrë në konsideratë eksperiencën e tjerë), lidhur me këtë pozicion. Vendosja e kriterëve sidomos kur ato janë skualifikuese automatikisht në konkurime të tilla duhet të jenë të mirë analizuara dhe në përputhje me kërkesat e vendit të punës për të cilin aplikohet. Vihet re shpeshherë se këto kritere janë formale dhe nuk i përgjigjen qëllimit për të cilin vendosen, përveçse krijojnë diskriminim të një kategori subjektsh të kualifikuar.

12 <http://klgj.al/thirrje-per-aplikim-date-15-05-2020/>

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

Nga ana tjetër, ndihmës magjistratët gjithashtu, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni 2, gërma “h” janë të gjithë gjyqtarë të komanduar për të ndihmuar ata në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese në trajtimin e çështjeve. Për këtë qëllim, veprimtaria e tyre përfshin, në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinionëve me shkrim për çështje ligjore materiale ose procedurale. Pra veprimtaria e një ndihmësmagjistrati të komanduar është shumë e ngjashme me atë të nëpunësit të NUNCP, por kërkesat për rekrutimin e këtyre të fundit janë më pak rigorozë ndonëse rëndësia e detyrës së tyre është pothuaj e njëjtë. Për më tepër, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe, magjistratët e komanduar, të cilët kanë ushtruar më parë funksionin e magjistratit, vazhdojnë të marrin pagën në përputhje me kriteret e karrierës dhe vjetërsisë për funksionet e kryera më parë (neni 13 i ligjit). Pra dhe vetë kategorizimi i pagës bëhet në varësi të eksperiencës së tyre të mëparshme, ndërkohë që paga e të gjithë ekipit të NUNCP-së është e njëllotë pavarësisht karrierës apo vjetërsisë për detyrat e kryera më parë.

Duke u rikthyer te arsyeja e ngritjes së ekipit të NUNCP që është rritja e ritmit me të cilin trajtohen çështjet gjyqësore, për të mundësuar që këshilltarët ligjorë të përqendrohen më tepër te relacioni i çështjeve, sesa te detyrat administrative. Një përgatitje më efikase e çështjeve do të bëjë të mundur që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ta rrisin numrin e çështjeve që ata përfundojnë/mbyllin çdo muaj. Në këtë kuptim nëpunësi do të ndihmojnë këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë, duke përmbushur funksione dhe detyra administrative:

- Duke ndjekur planin e punës, të përcaktuar sipas llojit të çështjeve (penale, civile dhe administrative), i kategorizon çështjet në nënkategori;
- Analizon secilën dosje të çështjes, sipas rendit kronologjik të regjistrimit të saj, nën udhëzimet e këshilltarit ligjor;
- Për çdo çështje, plotëson formularin e raportit mbi çështjen me të dhënat e nevojshme, bazuar në trajnimin dhe udhëzimet e marra nga gjykata dhe ia kalon atë këshilltarit ligjor.
- Përgatit raporte javore mbi numrin e çështjeve të trajtuara dhe mbi numrin e raporteve të plotësuara mbi çështjet.

Pra, siç duket, ekipi dhe këta punonjës do të kryejnë një pjesë apo të gjitha funksionet e ndihmësve të sotëm ligjorë. Ata do të studiojnë dosjen dhe përgatisin relacion për vendimet e mëparshme, pretendimet e palëve, problemet ligjore, si dhe japin mendim nëse rekursi duhet pranuar apo refuzuar, në bazë të të cilit gjyqtarët vendosin.

Vlen të vihet në pikpyetje cilësia e relacioneve, duke pasur parasysh eksperiencën e pakët të këtyre nëpunësve përballë përgjegjësisë së madhe në bërjen e relacionit të një dosje gjyqësore ku diskutohen çështje të njehsimit të praktikës gjyqësore. Duhet thënë se duke pasur parasysh rëndësinë e përgjegjësisë të përfshira, nevoja për rritje të numrit të personelit nuk duhet të nënkuptojë kriteret më pak të rrepta përzgjedhjeje. Nga sa u vu re më sipër kriteret e vendosura për këta punonjës janë relativisht të ulëta. Garancitë në këtë rast mund të kompensohen mes trajnimeve të vazhdueshme të këtij stafi.

Lidhur me metodën e dytë, Memorandumi parashikon:

- mbështetjen e nevojshme teknike për të realizuar hartëzimin gjithëpërfshirës të procesit të punës për të gjitha proceset aktuale në këtë gjykatë;

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

- përcaktimin e proceseve më efikase, të cilat të jenë në pajtim me kodet proceduralë të rishikuar, me ligjet e reformës dhe me modelet e praktikave më të mira;
- bashkëpunimin me ekspertë për të përfunduar vlerësimin e sistemit aktual të ICMIS-it (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore) dhe përcaktimin e ndryshimeve të nevojshme, mbështetur në hartëzimin e proceseve të punës nga “siç janë” në “siç duhet të jenë”;
- bërjen e vlerësimeve buxhetore dhe financiare për modifikimet në sistemin ICMIS, e cila konsiderohet si thembra e Akilit në sistemin aktual gjyqësor.

c. Udhërrëfytesa për efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe reduktimin e stokut të çështjeve të prapambetura 2020-2021

Në Korrik 2020 u prezantua Udhërrëfytesa për funksionimin e Gjykatës së Lartë. Udhërrëfytesa është një plan veprimi i qartë, i cili synon të garantojë aksesin e domosdoshëm në drejtësi, uljen e numrit të çështjeve gjyqësore, vendimmarrje të strukturuar e të qendrueshme drejt orientimit të praktikës gjyqësore.

Angazhimet dhe elementet e këtij dokumenti politikash paraqesin rëndësi të veçantë në realizimin e qëllimit të evadimit të dosjeve gjyqësore, ndaj ato janë pjesë e monitorimit që qendra Res Publica ka bërë në kuadër të këtij projekti, rezultatet e së cilave gjenden në vijim.

d. Ndryshimet ligjore, Mars 2021

Pas vetëm 4 vitesh nga miratimi i tyre në kuadër të reformës në drejtësi, 10 ligje të paketës ligjore “Ligjet organike” dhe kodet e procedurave u amenduan, duke pasur në fokus edhe uljen e fluksit të dosjeve, dhe pakësimin e efekteve negative të reformës në këtë kuadër.

Ky fluks ndryshimesh ligjore prekin drejtpërsërdrejt veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë, ku ndër to edhe atë të Gjykatës së Lartë. Në fokus të këtyre ndryshimeve është edhe rritja e efikasitetit të gjykatave dhe korrigjimi i efekteve negative të pakësimit të numrit të gjyqtarëve për shkak të procesit “veting”. Një nga zgjidhjet e ofruara ka qenë edhe ulja e numrit të trupës gjyqësore për disa lloj çështjesh. Këto ndryshime kaluan me një urgjencë të pajustificuar dhe shumë të kritikuar edhe nga aktorë politikë dhe shoqëria civile. Kështu këto ndryshime janë bërë përmes procedurave antikushtetuese, pa transparencë. Nuk u respektuan kërkesat e nenit 83 të Kushtetutës, pika 3 sipas së cilës nuk mund të miratohen me procedurë të përshpejtuar Kodet. Konkretisht janë dashur më pak se 30 ditë që këto ndryshime të miratoheshin. (depozitimi i kërkesës në kuvend është më 25 Shkurt 2021 dhe data e miratimit është 23 Mars 2021).

Në këtë kuptim, problematikat e konstatuara sa i takon mbingarkesën së punës në gjykata mund të kishin gjetur zgjidhje më të plota, pa cenuar në mënyrë të paekuilibruar parime të tjera siç cituam më sipër. Qeveria që ka bërë mbrojtjen e projektligjeve, ashtu edhe deputetët që kanë qenë formalisht propozues për ndryshimet, nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme për të identifikuar dhe vlerësuar realisht mungesat apo problematikat që has pushteti gjyqësor. Vetëm mes një procesi konsultimi gjithpërfshirës, mirë analizimit, studimit, do të mund të arrihej një vlerësim objektiv dhe zgjidhje që të garantonte nevojën e qytetarëve për një drejtësi të shpejtë, por edhe cilësore.

Thënë sa më sipër, në vijim është një tablo me të gjitha ndryshimet ligjore që prekin veprimtarinë e kësaj gjykate dhe si kontribuojnë këto ndryshime në uljen e numrit të dosjeve.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile

Sipas relacionit shoqërues të projektligjit¹³, ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile vijnë si rezultat i evidentimit të një sërë problematikave të vëna re gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji (miratuar me shumicë të cilësuar), që lidhen kryesisht me vendimet për caktimin e juridiksionit dhe kompetencës të gjykatave, shqyrtimin e ankimeve, depozitimin dhe shqyrtimin e rekurseve, gjykimin për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, shqyrtimin e çështjeve nga gjykata, si dhe vendimet e Gjykatës së Lartë. Në vijim paraqiten ndryshimet me efektet e pritshme që do të sjellin këto ndryshime në kuadër të uljes së ngarkesës së Gjykatës së Lartë.

- Në nenin 35 është shtuar një paragraph me përmbajtje: ***Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.*** Gjykata merr në shqyrtim çështje si për njësimin ashtu edhe për ndryshimin e praktikës gjyqësore, por nuk ishte e përcaktuar qartë, nëse të dyja këto do të shqyrtoheshin në Kolegjet e Bashkuara. Me ndryshimet e nenit 35 dhe nenit 481 është bërë një “ndarje” e punëve, ku në mënyrë eksplicite, përcaktohet se çështjet për njehsim dhe zhvillim të praktikës gjyqësore do të shqyrtohen në trupë gjykuese me 5 gjyqtarë, duke lënë kështu për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara vetëm çështjet për ndryshim të praktikës gjyqësore. Kjo në fakt, mund të ndikojë në shpejtësinë e procesit të shqyrtimit të çështjeve të prapambetura, sidomos për ato çështje ku është e nevojshme të bëhet njësimi i praktikës apo zhvillimi i saj, të cilat mund të jenë më të shumta në numër, duke marrë parasysh se shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara kërkon pjesëmarrjen e gjithë gjyqtarëve, për pasojë angazhon energji dhe burime njerëzore më të mëdha.
- Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, për çështjen që shqyrton mund të vendosë nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Sipas modelit të nenit 9, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kundër vendimit të ndërmjetëm që rrëzon kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, nuk lejohet ankim. Kjo dispozitë nuk është zbatuar nga gjykatat, pasi është marrë për bazë parashikimi i Kodit të Procedurës Civile, nenit 59, sipas të cilit kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë. Pikërisht kjo dispozitë u ndryshua dhe u përshtat me modelin e nenit 9 për gjykimet administrative. Sipas këtij ndryshimi, do të lejohet ***rekurs i veçantë*** (një term që tashmë ka zëvendësuar atë të ankimit të veçantë) drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, ***vetëm nëse gjykata vendos për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor***, por jo kur e pranon atë. Lidhur me vendimet për pranim juridiksioni do të lejohet ankim në Gjykatën e Apelit (jo më drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë), së bashku me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar. Pra duket se jo vetëm është vendosur të bëhet një filtrim i çështjeve lidhur me juridiksionin që mund të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë (duke i kufizuar rastet) por edhe lidhur me gjykatat e rretheve, ku procesi mos të ndërpritet apo zvarritet në rast se ajo gjykon se çështja hyn në juridiksion gjyqësor, duke lejuar logjikisht kundërshtimin e juridiksionit vetëm pas dhënies së një vendimi përfundimtar ose jo.

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Megjithatë vihet re se në nenin 60 të Kodit, nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme, për të harmonizuar ndryshimet me nenin pararendës. Konkretisht në nenin 60 parashikohet se:

“Kur një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për një shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet nga Gjykata e Lartë me kërkesën e institucionit shtetëror ose të prokurorit. Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin.”

Nga përmbajtja e kësaj dispozite kuptojmë se kemi të bëjmë me rastin kur një gjykatë pranon juridiksonin gjyqësor, por nga ana tjetër **institucioni shtetëror që është palë në proces** pretendon të kundërtën, pra që çështja bën pjesë në juridiksionin administrativ. Në këtë rast, si çështje lidhur me juridiksionin, mosmarrëveshja duhet të zgjidhet në Gjykatën e Lartë me kërkesën e vetë institucionit shtetëror/prokurorit, duke pezulluar gjykimin në shkallën e parë. Kjo dispozitë duket se na rikthen në gjendjen fillestare (para ndryshimit të nenit 59), për rastet kur pala pretenduese është institucion shtetëror. Ky konfuzion mes dy dispozitave sjell dy pasoja negative: së pari vendos në pozitë jo të barabartë palët, në varësi nëse pala pretenduese është palë private apo institucion shtetëror dhe së dyti, sjell konfuzion dhe mbivendosje normash, ku nuk kuptohet se cila do të jetë baza ligjore ku palët do të mbështeten, lidhur me këtë çështje.

- Sipas ndryshimeve në nenin 62, vendimet mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjeve do të ankimohen me vendimin përfundimtar ose jo përfundimtar, duke lehtësuar kështu në këtë pikë punën e Gjykatës së Lartë, ku më parë i gjykonte drejtpërdrejtë ajo çështjet lidhur me kompetencën.

Në rastin kur gjykata konstaton (neni 61) se nuk është kompetente për çështjen i kalon aktet gjykatës që është kompetente, dhe cdo konflikt kompetence ndërmjet gjykatave, ndonëse s’lejohet, gjykata ka të drejtë të parashtrojë pranë Gjykatës së Lartë, e cila shqyrton në dhomë këshillimi me trup gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë. Procedura në lidhje me këtë pikë ka mbetur e pandryshuar.

- Po kështu, janë kryer ndryshimet e nevojshme në nenin 75, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar se lidhur me këto kërkesa tashmë do të vendosë një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, dhe jo një trup gjykues prej 3 gjyqtarësh, gjë e cila do të pasojë me uljen e ngarkesës së gjykatës.
- Nenet 466 dhe 467 të Kodit të Procedurës Civile kanë parashikuar dy raste kur kundër vendimeve të apelit lejohet rekurs i veçantë, respektivisht rasti kundër *vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes (neni 466) dhe kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim*. Me këto dispozita duket se ligjvënësi ka dashur të rrisë kategoritë e rasteve kur bëhet rekurs i veçantë (me afat 5 ditor) me qëllim përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve të tilla (afatet e nenit 470), në Gjykatë të Lartë duke mos lejuar kështu “*zvarritjen e tyre*” duke marrë parasysh se afati për të shqyrtuar këto çështje është 30 ditë. (neni 470). Më parë kundër një vendimi të tillë lejohej rekursi brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit në mënyrë të arsyetuar dhe shqyrtimi nga gjykata nuk kishte prioritet.

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

- Në nenin 475 është shtuar një fjali sipas së cilës pala që paraqet rekursin ka detyrimin të argumentojë, nëse ekzistojnë shkaqet e rekursit (neni 472 i Kodit). Kjo lehtëson në të njëjtën kohë dhe punën e nëpunësve gjyqësorë, këshilltarëve dhe trupit gjykues në shqyrtimin e rekursit, duke ndikuar në shpejtësinë e gjykimit. Për më tepër, është rekomanduar (mund të paraqitet) forma zyrtare e miratuar nga KLGJ për hartimin e një rekursi. Kjo ndihmon në orientimin dhe shqyrtimin e rekursit dhe shmang paraqitjen e formave të ndryshme që mund të konfundojnë Gjykatën.
- Ndryshimet e nenit 476 sjellin një “mekanzëm filtrimi” të rekurseve, që lehtëson punën e Gjykatës së Lartë, sipas së cilës rekursitet do të shqyrtohen paraprakisht nga gjyqtari/relatori që ka dhënë vendimin për të parë nëse rekursi paraqet ose jo të meta. Kjo ndihmon Gjykatën e Lartë dhe shmang vonesat që mund të krijohen në momentin e paraqitjes së rekursit, nëse rezulton se ai paraqet të meta. Gjithashtu sanksionimi shprehimisht i detyrimit të gjykatës për të njoftuar palën për plotësim të metash brenda afatit 5 ditor, do të reduktojë edhe çështjet që riktheheshin për gjykim, pas konstatimit të Gjykatës Kushtetuese të cenimit të aksesit në gjykatë, në rastet kur është vendosur mospranimi i rekursit, pa i dhënë mundësi palës të plotësojë të metat e konstatuara të rekursit.
- Një ndryshim të përgjithshëm ka pësuar neni 481, ku fillimisht, vihet re se kalimi i çështjes për njësim apo ndryshim nuk është më një e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, por dhe Kolegji Civil që kryesisht apo me kërkesë të palëve mund të vendos nisjen e kësaj procedure. Kjo në fakt, ndihmon Kryetarin e Gjykatës së Lartë, por e shpërndan njëherazi përgjegjësinë/kompetencën për të nisur këtë procedurë dhe tek Kolegji Civil, duke rritur kështu vigjilencën dhe rrjedhimisht cilësinë në vendimmarrje.

Së dyti, vendimi i ndërmjetëm, për nisjen e procedurës së njësimit apo ndryshimit të praktikës, përcakton se cilat çështje do të shtrohen për njësim/ndryshim, në mënyrë të arsyetuar, gjë e cila ndihmon që procedura të përqëndrohet vetëm në pikat e përcaktuara, duke përshpejtuar procesin e vendimmarrjes nga njëra anë dhe duke shtuar ngarkesën e gjyqtarit, i cili do të duhet të arsyetojë vendimin. Së treti, parashikimi që vendimi i ndërmjetëm për njësim/ndryshim të praktikës gjyqësore të publikohet në faqen e gjykatës, do të ndihojë palët e treta, persona juridik publikë ose privatë të njihen dhe të paraqesin mendimet me shkrim, në rastin kur së bashku me Avokaturën e Shtetit mund të ftohen nga gjykata nëse çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore (*një formë e amicus curia*). Edhe mendimet me shkrim të këtyre subjekteve do të publikohen në faqen e gjykatës.

- Ndryshimet në nenin 482 paraqesin disa përparësi. Së pari, datën dhe orën e shqyrtimit nuk e cakton më Kryetari i gjykatës, por gjyqtari relator i caktuar me short. Kjo do të sjelli efekte në organizimin e punës dhe menaxhim më të mirë të kohës.

Së dyti, referuar dhe mekanizmit të ndjekur nga GJL, ku prioritare janë çështjet e prapambetura dhe ato të urgjencës, vihet re se kjo është inkorporuar dhe në Kod, ku është parashikuar e drejta e palës për ta kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara. Në fakt, ndonëse kjo është në favor të palës kur ndodhet në të tilla kushte, mund të ndodhë që të ketë abuzime, pranë gjyqtarit mund

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

të paraqiten kërkesa të shumta për shqyrtim të përshpejtuar, duke rritur kështu volumin e punës, marrë parasysh që gjyqtari duhet të paraqesë një relacion të detajuar lidhur me këtë (përgatitja e të cilit sigurisht merr kohën e vet). Një korrigjim i mundshëm i këtyre efekteve mund të ishte lënia e relacionit nëpunësve gjyqësorë dhe/ose këshilltarëve dhe të miratohej nga gjyqtari.

- Neni 485 ka pësuar disa ndryshime. Pas ndryshimeve është parashikuar mundësia që Gjykata e Lartë të vendosë mospranimin e rekursit kur nuk ndodhet brenda shkaqeve të nenit 472 dhe gjithashtu mundësia për të zgjidhur përfundimisht çështjen, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit apo të shkallës së parë, nëse në çdo rast zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtim apo rivlerësim të fakteve dhe provave.

Këto ndryshime do të ndikojnë dhe shërbejnë për të shmangur “zvarritjen” e procesit të zgjidhjes së çështjes në tërësi, edhe pse në afatshkurtër mund të “mbingarkojë” punën e gjykatës në kushtet ku ajo ndodhet tani.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale

Sipas relacioni shoqërues¹⁴ ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale janë kryer si rezultat i evidentimit të një sërë problematikash që lidhen kryesisht me përbërjen e Gjykatës së Lartë dhe trupin gjykues, shqyrtimin e ankimeve, paraqitjen dhe përmbajtjen e rekurseve, kundërrekursin, njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, procedimet paragjykimore, si dhe vendimet e Kolegjit Penal ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Këto ndryshime vijnë paralelisht dhe në harmoni me ndryshimet e kryera në Kodin e Procedurave Civile dhe ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Meqënëse pjesa më e madhe e ndryshimeve janë pothuaj identike me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, të cilat u trajtuan më sipër, më poshtë po evidentojmë dispozita të tjera të Kodit të ndryshuara dhe të paanalizuara.

- Ndryshimet në listën e çështjeve që do të gjykohen nga një gjyqtar dhe jo nga tre gjyqtarë kanë efekt të drejtpërdrejt në lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Konkretisht çështjet që do të gjykohen jo me tre, por me një gjyqtar janë:
 - kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;
 - ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale apo pushimin e çështjes për kundërvajtjet penale;
 - kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet;
 - kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq;
 - kërkesa e prokurorit për miratimin e urdhrit penal;
 - kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;
 - kërkesat për rivendosje në afat;
 - kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja,

14 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210227124120Relacion%207905.pdf>

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

sipas titullit X të këtij Kodi;

- çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta.

- Neni 264 parashikon rastet kur vendoset zgjatja e afateve të paraburgimit, e cila bëhet me vendim gjykate dhe në çdo rast mund të ankimohet. Me ndryshimet e fundit është hequr mundësia të zgjidhnin vetë palët, nëse do të ankimonin vendimin në Apel apo para Gjykatës së Lartë. Pas ndryshimeve ankimi bëhet vetëm në Apel, duke lehtësuar kështu punën dhe mbingarkesën që ka tashmë Gjykata e Lartë.

- Në nenin 435 është shtuar një paragraf me këtë përmbajtje:

“Rekursi paraqitet me shkrim brenda 45 ditëve nga e nesërmyja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit. Afati për paraqitjen e rekursit kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë është 20 ditë. Rekursi shqyrtohet nga Gjykata e Lartë jo më vonë se dy muaj nga momenti i regjistrimit të tij në sekretarinë gjyqësore.”

Në këtë dispozitë është parashikuar e drejta e rekursit (sipas Kodit të Procedurës Civile ishte emërtuar recurs i veçantë) për të kundërshtuar vendimin e apelit ku është vendosur prishja e gjykimit dhe kthimi për gjykim në shkallën e parë. Në këtë rast i vetmi ndryshim është lidhur me afatet për shqyrtim dhe paraqitje rekursi pranë Gjykatës së Lartë.

- Neni 437, pas ndryshimeve të bëra së fundmi, duket se lehtëson gjykimin të paktën në dhomë këshillimi duke vendosur rregullin e përgjithshëm për shqyrtimin e çështjes pa praninë e palëve, por vetëm në raste specifike të përcaktuara në gërmën “a” dhe “b”, ku: a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, mund të bëhet në prani të tyre. Kështu procesi i shqyrtimit, qoftë dhe të çështjeve të prapambetura, mund të ecë më shpejt.

Ndryshimet në ligjin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

Këto ndryshime kanë ndjekur të njëjtin model me ato të kodeve, duke harmonizuar procedurat e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Vlen të theksohet rasti i ndryshimeve në nenin 63 të këtij ligji, ku parashikohen llojet e vendimeve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar si risi vendimmarrjen jopërfundimtare të mospranimit të rekursit në seancë gjyqësore. Kjo ka sjellë edhe shfuqizimin e nenit 60/1, ku parashikohet se gjykata vendos në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji. Ky parashikim është përfshirë në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 63 të ligjit.

Ky parashikim është njësoj edhe në kodet e procedurave të trajtuara më sipër.

IV. PRAKTIKA E GJEDNJ DHE PRAKTIKA TË TJERA TË MIRA

4.1. Hyrje

Qëllimi i këtij kapitulli është të ofrojë modele që adresojnë dhe parandalojnë vonesat në procedurat gjyqësore, bazuar në praktika të mira dhe mekanizma ligjorë të miratuara nga vendet e tjera të Këshillit të Evropës, me theks në përshpejtimin e procedurave në pritje të gjykatave në krye të hierarkisë gjyqësore (Gjykata e Lartë / Gjykata Kushtetuese), me shpresën se këto praktika mund të shërbejnë si një burim frymëzimi për autoritetet kompetente shqiptare. Një vëmendje e veçantë vihet mbi mekanizmat ligjorë, efektiviteti dhe përshtatshmëria e të cilave u miratua nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (refuar më tutje si “Gjykata”). Duhet të theksohet në këtë aspekt se janë dorëzuar çështjet e para në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave të ndryshme të mbrojtura sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (këtu e tutje “Konventa”) për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese.¹⁵

Ky kapitull përbëhet nga tre seksione. Në seksionin e parë, jepen një sërë sugjerimesh në lidhje me miratimin e masave të përkohshme dhe “ad hoc” me qëllim lehtësimin e numrit të mbetur në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë si për çështjet penale ashtu edhe ato civile.

Në seksionin e dytë, do të parashtrohen sugjerime të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me miratimin e masave të përhershme, të tilla si futja e kritereve të reja të pranueshmërisë për paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, me synimin për të

15 Shih *Keta kundër Shqipërisë*, nr. 9227/19, depozituar në 5 Shkurt 2019 dhe komunikuar në 3 Prill 2019; çështja ka të bëjë me pamundësinë e pretenduar për aplikantin për të kundërshtuar paraburgimin e tij para Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese. Shih gjithashtu *Bara k. Shqipërisë*, nr. 43391/18, depozituar në 4 Shtator 2018 dhe komunikuar Qeverisë Shqiptare në 15 Nëntor 2018; në këtë rast, aplikanti ankohet se mosfunksionimi i Gjykatës së Lartë shkel të drejtën e tij për t’iu drejtuar gjykatës dhe ia pamundëson të përdorë procedurat në të cilat ai kundërshton vendimin e organit përkatës për ta emëruar atë si Rektor të Universitetit të Mjekësisë. Duhet të theksohet se të dyja çështjet iu komunikuan Qeverisë Shqiptare në një kohë rekord, dëshmi kjo e rëndësisë që i ka kushtuar Gjykata këtyre çështjeve.

ndaluar ‘përmbytje’ të ardhshme të çështjeve në Gjykatën e Lartë, duke mundësuar që ajo të përqendrojë kohën dhe energjitë e saj në shqyrtimin e ankesave në kohën e duhur. Duhet të theksohet ndërkohë që disa nga këto masa (p.sh. formimi i trupës gjykuese me një gjyqtar të vetëm, i cili do të vlerësojë pranueshmërinë e ankesave) nuk janë veçanërisht të komplikuar dhe mund të miratohen brenda një periudhe të shkurtër kohe¹⁶. Thënë kjo, dhe në parim, zbatimi prapaveprues i legjislacionit në lidhje me çështje thjesht procedurale (të tilla si p.sh. gjykimi, me efekt prapaveprues, i një çështje që pret të gjykohet në Gjykatën e Lartë nga një panel prej tre anëtarësh në një formacion me një gjyqtar të vetëm) nuk ngre ndonjë çështje papërputhshmërie me Konventën.¹⁷

Së fundmi, seksioni i tretë përmban një listë të rekomandimeve drejtuar grupeve të ndryshme të interesit në sistemin shqiptar të drejtësisë. Meqenëse, në një të ardhme të parashikueshme nuk ka shumë gjasa që të ketë reformë të legjislacionit përkatës, duke përjashtuar kështu mundësinë e një reforme gjithëpërfshirëse të kriterëve të pranueshmërisë për plotësimin e një rekursi për çështje të ligjit në Gjykatën e Lartë (së bashku reformat në Itali të paraqitura më poshtë), u gjykua e këshillueshme që të përqendroheshim në rekomandime që janë relativisht të lehta për t’u prezantuar në bazë të kornizës ligjore ekzistuese.

4.2. Rekomandimet për trajtimin e çështjeve të prapambetura pranë Gjykatës së Lartë në bazë të standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

a. Përgjegjësia e shtetit shqiptar për çështjet e prapambetura gjyqësore përpara Gjykatës së Lartë

Duhet të kujtojmë këtu se shteti shqiptar mban një pjesë të madhe të përgjegjësisë për problemin e përhershëm të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, i cili u përkeqësua nga pasojat e procesit të Vetëing-ut (shkarkimet/dorëheqjet e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë) dhe dështimi i shtetit për të parashikuar dhe adresuar paraprakisht këtë çështje.

Në veçanti, sipas përvojës së qendrës Res Publica, por edhe mendimit të profesionistëve të shumtë ligjor, shteti shqiptar shpesh paraqet ankesa në Gjykatën e Lartë duke e ditur plotësisht mirë se këto burime ligjore nuk kanë asnjë perspektivë suksesi ose janë haptazi abuzive. Si tregues, Res Publica vëren se afërsisht 50 çështje administrative në lidhje me dëmshpërblimin e familjarëve të viktimave dhe të plagosurve nga shpërthimi i Gërdecit janë aktualisht në pritje para Gjykatës së Lartë, pas paraqitjes së rekursit nga Avokatura e

16 Sidoqoftë, transferimi i çështjeve nga Gjykata Civile te Gjykatat Administrative pas hyrjes në fuqi të Ligjit 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Mosmarrëveshjet Administrative” nuk solli ndonjë përplasje me Kushtetutën.

17 Shiko *Beshiri dhe të tjerët k. Shqipërisë* (dhjetor), nr. 29026/06, 17 Mars 2020, ku Gjykata vendosi që prezantimi me efekt prapaveprues i një ligji që synon adresimin e një problemi të sistemit të identifikuar në vendimin pilot të një Gjykate dhe duke i shërbyer kështu interesit publik, nuk ishte në kundërshtim me Konventën, me Gjykatën duke vërejtur në veçanti se ligji i ri nuk kishte ndonjë ndikim në vendimet që ishin tashmë përfundimtare që kishin përcaktuar shumën e dëmshpërblimit për t’u paguar dhe / ose kishte urdhëruar rikthimin në natyrë të pronës ish-pronarëve.

Shtetit dhe palët e paditura. Në dritën e vendimeve të proceseve penale në lidhje me çështjen e sipërpërmendur, por edhe arsyetimin shumë të detajuar të gjykatave administrative në vendimet e tyre për dhënien e dëmshpërblimeve ndaj viktimave, është pothuajse e pamundur që Gjykata e Lartë të rrëzojë vendimet e gjykatave të apelit, pasi përgjegjësia e shtetit për vdekjen e viktimave dhe / ose të afërmeve të tyre është tashmë e përcaktuar përfundimisht dhe e mbështetur mbi një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës. Vendosmëria e Shtetit Shqiptar për t'i ankimuar këto vendime, pa sjellë ndonjë argument bindës, por thjesht duke këmbëngulur se përgjegjësia e shtetit nuk mund të përcaktohet, nuk shërben për asnjë qëllim të vlefshëm (të tilla si p.sh. mbrojtja e financave të Shtetit), por vetëm sa zgjat ankthin e paditësve që nuk mund të mbyllin njëherë e mirë atë kapitull tragjik të jetës së tyre. Për më tepër, në dritën e shkresave voluminoze të secilës çështje, si dhe ndryshimet shumë të imta midis tyre për çështje që kërkojnë rishikimin e ekspertizës teknike (në lidhje me vlerësimin e saktë të demit pasuror e jopasuror që do t'i jepet secilit paditës, mbi faktorë të ndryshëm si p.sh. lidhja e tyre jetësore/emocionale me viktimën (at), diçka që mund të konstatohet vetëm me anë të një ekspertize psikologjike, e cila më pas mund të kundërshtohet vetëm me një akt tjetër ekspertimi psikologjik, koha që Gjykata e Lartë do të duhet të shpenzojë vetëm në mënyrë që të rishikojë me kujdes këto dosje - le të lëmë mënjanë analizën e tyre në thellësi - do të jetë kohë shumë e gjatë, kohë e cila do të ishte më mirë të investohej me shqyrtimin e rasteve të tjera.

b. Jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me përparësinë në shqyrtimin e çështjeve, veçanërisht në kontekstin e ngjarjeve të mëdha shoqërore dhe politike

Sipas Gjykatës, arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe në përputhje me faktorët e mëposhtëm: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit dhe e autoriteteve shtetërore përkatëse dhe rëndësia e interesit që është në rrezik për kërkuesin në mosmarrëveshje.¹⁸ Ndërsa ka pranuar që në rrethana të caktuara të jashtëzakonshme (të tilla si tranzicioni i një vendi nga një regjim autoritar në një regjim demokratik) një çështje e caktuar e prapambetur mund të tolerohet, ajo gjithashtu ka theksuar se një qëndrim i tillë nuk u heq shteteve detyrimin për të ndërmarrë veprime përmirësuese “të menjëhershme” dhe për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore me qëllim që të trajtojnë ndikimin e situatës së jashtëzakonshme në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe të sigurojnë që kjo “prapambetje e përkohshme” të mos bëhet e përhershme.¹⁹ Gjithmonë sipas Gjykatës, shtetet që gjenden në një situatë të tillë duhet të vendosin mbi metodat e “gjykimit ligjor”, të tilla si caktimi i përparësisë së çështjeve jo në bazë të datës kur ato janë paraqitur, por në shkallën e tyre të urgjencës dhe rëndësisë dhe, në veçanti, për interesin që është në rrezik për personat në fjalë²⁰, ose grupimi së bashku i disa çështjeve të ngjashme

18 *Comingersoll S.A. k. Portugalisë* [DHM], 35382/97, 6 Prill 2000, paragrafi 19.

19 *Bucholz k. Gjermanisë*, nr. 7759/77, 6 Maj 1981, paragrafi 51. Në atë rast, Qeveria e paditur ia kishte atribuar çështjeve të prapambetura recesionit ekonomik që çoi në një rritje të konsiderueshme të vëllimit të çështjeve të marrëdhënive të punës para gjykatave. Gjykata ka bërë vërejtje të ngjashme në lidhje me prapambetjet gjyqësore të grumbulluara pas bashkimit të Republikës Federale të Gjermanisë (*Süssman k. Gjermanisë* [DHM], nr. 20024/92, 16 Shtator 1996) dhe rivendosjen e demokracisë në Spanjë (*Unión Alimentaria Sanders SA kundër Spanjës*, nr. 11681/85, 7 Korrik 1989).

20 *Zimmermann dhe Steiner k. Zvicres*, nr. 8737/79. 13 Korrik 1983, paragrafi 29.

dhe shqyrtimi i tyre së bashku (që mund të nënkuptojë që çështjet e ngritura më herët do të shqyrtohen së bashku me çështjet e paraqitura më vonë para së njëjtës gjykatë), në mënyrë që të formohet një pamje më gjithëpërfshirëse e çështjeve ligjore nën shqyrtim.²¹ Duhet të theksohet në këtë aspekt se Gjykata ka përvetësuar në vitin 2009 (dhe që prej asaj kohe ka amenduar shumë ndryshime) një politikë që i jep prioritet përshpejtimit të proceseve dhe gjykimin e çështjeve më të rëndësishme dhe serioze. Sipas kësaj politike, aplikimet hyrëse shpërndahen në njërën prej shtatë kategorive; te kategoria e parë dërgohen aplikimet që janë më të rëndësishme dhe urgjente (p.sh. rastet kur Gjykata ka pranuar masa të përkohshme sipas Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës) dhe çështjet e kategorisë së shtatë lidhen me aplikime qartazi të papranueshme. Çështja e kategorisë së parë do të trajtohet, në parim, para një çështje të kategorisë së dytë e kështu me radhë. Së fundmi, vonesat mund të shmangen gjithashtu nëse gjykatat që qëndrojnë “në krye të hierarkisë” të kenë mundësinë e nxjerrjes së një vendimi përfundimtar vetë, në vend që ta dërgojnë çështjen në gjykata më të ulëta për rishqyrtim.²² Ndërsa shmanget përpilimi i një liste të vështirë dhe të shpejtë të çështjeve që duhet të caktohen me përparësi në çdo kohë, hulumtimet në jurisprudencën e Gjykatës tregojnë se çështjet e kujdestarisë së fëmijëve duhet të trajtohen me shpejtësi²³, veçanërisht në rastet kur kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pakthyeshme në marrëdhënien prind-fëmijë.²⁴ Mosmarrëveshjet e punësimit nga natyra e tyre kërkojnë shqyrtim dhe vendim të shpejtë²⁵, veçanërisht në rastet kur shumica e diskutueshme e dëmshpërblimit ose rivendosja e tij në punë është me rëndësi jetike për jetesën e aplikantit.²⁶ Konsiderata të tilla zbatohen në rastet kur paraqitësit e kërkesave janë të moshuar dhe/ose ata po ankohen për të drejtën e tyre për një përfitim/pension që është burimi i tyre kryesor i të ardhurave²⁷, ose janë të sëmurë rëndë²⁸. Lidhur me procedimet penale, rastet kur i pandehuri mbahet në paraburgim duhet të trajtohet me kujdes të veçantë, për arsye që mund të merren me mend²⁹, po aq kujdes kërkohet gjithashtu në rastet e çështjeve lidhur me dispozitat thelbësore të Konventës siç është neni 2 (e drejta për jetën) dhe neni 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues), apo dënimi.³⁰ Për ilustrim, Gjykata ka konsideruar që kohëzgjatja e procedurave të një gjyqi për marrëdhënie pune, prej një viti e nëntë muaj para Gjykatës Franceze të Kasacionit në një çështje që ishte caktuar me përparësi, do të konsiderohet e arsyeshme.³¹

21 *Süssman k. Gjermanisë* [DHM], op. cit., paragrafi 59.

22 Shih p.sh. *Topallaj k. Shqipërisë*, nr. 32913/03, paragrafi 77.

23 *Hokkanen k. Finlandës*, nr. 19823/92, 23 Shtator 1994, paragrafi 72; *Niederböster k. Gjermanisë*, nr. 39547/98, 27 Shkurt 2003, paragrafi 39.

24 *Tsikakis k. Gjermanisë*, nr. 1521/06, 10 Shkurt 2011, paragrafi 64 dhe 68.

25 *Vocaturo k. Italisë*, 24 Maj 1991, Seria A no. 206-C, paragrafi 17; *Ruotolo k. Italisë*, 27 Shkurt 1992, Series A no. 230-D, paragrafi 17; dhe *Frydlender k. Francës* [DHM], nr. 30979/96, 27 Qershor 2000, paragrafi 45.

26 *Doustaly k. Francës*, 23 Prill 1998, Raporti i gjykimeve dhe vendimeve 1998-II, paragrafi 48, *Ruotolo k. Italisë*, op. cit., paragrafi 117.

27 *Codarcea k. Rumanisë*, nr. 31675/04, 2 Qershor 2009, paragrafi 89, *Mocié k. Francës*, nr. 46096/99, 8 Prill 2003, paragrafi 22.

28 *Henra k. Francës*, nr. 110/1997, 29 Prill 1998, paragrafi 68.

29 *Stögmüller k. Austrisë*, gjykimi i 10 Nentorit 1969, paragrafi 5. Shih gjithashtu *Keta k. Shqipërisë*, op. cit.

30 *Caloc k. Francës*, nr. 33951/96, 20 July 2000, paragrafi 120.

31 *Guichon k. Francës*, nr. 40491/98, 21 Mars 2000.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Gjykata gjithashtu ka bërë një dallim midis çështjeve që janë në pritje para gjykatave të nivelit më të ulët dhe çështjeve që janë në pritje para gjykatave të “larta” (të tilla si Gjykata e Lartë apo ajo Kushtetuese). Ndërsa në mënyrë të qartë të gjitha gjykatat duhet të përpiqen të japin vendimet e tyre me shpejtësi dhe efikasitet, Gjykata ka vlerësuar se në dritën e rolit që gjykatat e “larta” (Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese) luajnë në promovimin e sigurisë juridike dhe sigurimin e administrimit të duhur të drejtësisë brenda sistemeve të tyre gjyqësore përkatëse - veçanërisht pas ngjarjeve të rëndësishme shoqërore dhe historike, vonesat në gjykimin e procedurave para gjykatave të tilla mund të justifikohen - në një shtrirje më të madhe se vonesat para gjykatave të zakonshme – me kusht të parashikimit që masat korrigjuese të merren në mënyrë të menjëhershme. Kështu për shembull, kohëzgjatja e procedurave prej dy vitesh e shtatë muajsh para Gjykatës Kushtetuese Sllovene në lidhje me të drejtën e paditësit për paradhënie të pagesës së pensionit të aftësisë së kufizuar - i cili ishte burimi i tij i vetëm i të ardhurave - u konsiderua se nuk shkel të drejtat e paditësit sipas nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme), pasi çështja e paditësit paraqiti një kompleksitet të pamohueshëm pas shpërbërjes së ish-Republikës Socialiste të Jugosllavisë dhe formimit të shteteve të pavarura, si dhe nevojën shoqërore që Gjykata Kushtetuese të kalonte më shumë kohë dhe të mbajë më shumë seanca për këtë çështje, në dritën e kompleksitetit të saj, por edhe të rëndësisë së sqarimit të të gjitha aspekteve ligjore përkatëse të çështjes, veçanërisht në dritën e paraqitjes së ankesave të tjera të shumta kushtetuese që u ngritën nga çështje të ngjashme faktike dhe ligjore.³² Gjykata gjithashtu ka konstatuar se Gjykatat e Larta, për shkak të rolit dhe pozitës në sistemet ligjore vendase, nuk u kërkohet të përfshijnë në gjykimet e tyre një arsyetim të hollësishëm kur thjesht u duhet të refuzojnë një rekurs si të papranueshëm, ose që nuk ka asnjë shans “fitoreje”.³³ Këto parime zbatohen gjithashtu në lidhje me shkallën e arsytimit që vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë kur rishikimi i gjykatës më të lartë shqyrton ankimet (dmth. rastet kur paraqitja e një ankimi ose një rekursi nuk është automatike, por i nënshtrohet së pari regjistrimit dhe dhënies së një kërkesë për të paraqitur një ankesë).³⁴

Parime të ngjashme janë të zbatueshme edhe në lidhje me ankimet kundër paraburgimit në pritje për gjykim pranë gjykatave të larta, nëse janë përmbushur disa kushte të veçanta. Në një çështje të fundit kundër Turqisë, disa nga ankuesit argumentuan se paraburgimi i tyre për më shumë se një vit pas ankimimit para Gjykatës Kushtetuese nuk ishte “i shpejtë” për qëllimet e Nenit 5§4 të Konventës. Në dritën e kompleksitetit të çështjes, të faktit se ngarkesa e çështjeve të Gjykatës Kushtetuese turke ishte rritur gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që ishte deklaruar në Turqi pas grushtit të pasuksesshëm të shtetit, në vitin 2016 dhe aspekte të tjera të rendit juridik turk (të tilla si rishikimi automatik i ligjshmërisë së paraburgimit çdo tridhjetë ditë), ishin arsye për të thënë se nuk kishte shkelje të nenit 5§4 të Konventës.³⁵

Duke iu kthyer sërish procedurave penale, Gjykata ka konsideruar se një gjykim i zgjatur prej një viti e pesë muaj para Gjykatës së Lartë bullgare në lidhje me një vepër mashtrimi bankar do të konsiderohej afat i arsyeshëm.³⁶

32 *Tričković k. Sllovenisë*, nr. 39914/98, 12 Qershor 2001, paragrafi 60 – 68.

33 *Gorou k. Greqisë* (nr. 2) [DHM], no. 12686/03, paragrafi 41. Shih gjithashtu *Vevecka k. Shqipërisë* (dec), nr. 40554/04, 26 Maj 2020, paragrafi 52.

34 *Kukkonen k. Finlandës* (nr.2), nr. 47628/06, 13 Janar 2009, paragrafi 29

35 *Sabuncu dhe Te Tjeret k. Turqisë*, nr. 23199/17, 10 Nentor 2020, paragrafet 197 – 200.

36 *Kuibichev k. Bullgarisë*, nr. 39271/98, 30 Shtator 2004

Së fundmi, Gjykata ka qenë kritike ndaj avokatëve të cilët, përmes veprimeve të tyre, sjellin vonesa në procedurë, edhe pse arsyet e tyre mund të jenë pjesërisht të vlefshme. Kështu në çështjen *Stefanov kundër Bullgarisë*, Gjykata konsideroi se një gjobë prej 60 eurosh për një avokat të caktuar kryesisht i cili refuzoi të përfaqësonte klientin e tij, në shenjë protestë që ta detyronte t'i parapaguante shpërblimin e parashikuar nga ligji ishte e arsyeshme dhe kishte qëllimin legjitim të siguronte administrimin e shpejtë të drejtësisë.³⁷

c. Praktikën më të mirë dhe rekomandimet për miratimin e masave për orientimin e procedurave para Gjykatës së Lartë në bazë të standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Megjithëse për arsye të ndryshme, gjykata të tjera të larta gjithashtu janë përballur me sfida të ngjashme në lidhje me vëllimin e çështjeve të prapambetura të dorëzuara pranë tyre për shqyrtim. Në të vërtetë, edhe Gjykata duhej të merrte një sërë masash drastike me qëllim që të zgjidhte çështjet e prapambetura gjithnjë e në rritje që janë në pritje pranë saj.

i. Qasja e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në adresimin e çështjeve të prapambetura

Gjykata e kuptoi herët që për shkak të përmasës që po merrte problemi i çështjeve të prapambetura, ai nuk mund të zgjidhej thjesht duke rritur fondet për Gjykatën në mënyrë që të mundësohej rritja e kapacitetit të stafit në Zyrën e Regjistrimit. Ajo që duhej ishte një reformë rrënjësore. Kjo reformë u përcaktua në Protokollin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut³⁸, i cili hyri në fuqi në 2010 dhe vërtetë rreth dy boshteve kryesore.

Së pari, u përmirësua aftësia filtruese e Gjykatës me qëllim që të merrej me aplikime haptazi të papranueshme. Kjo u bë e mundur me prezantimin e një formacioni të ri gjyqësor, përkatësisht prezencën e një gjyqtari të vetëm, i cili është kompetent për refuzimin e kërkesave haptazi të papranueshme, duke lehtësuar kështu numrin e mbetur të çështjeve pranë Gjykatës. Në të vërtetë, në ditët e sotme shumica dërrmuese e kërkesave shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm. Sipas të dhënave statistikore, Gjykata shqyrtoi 40.667 kërkesa dhe deklaroi të papranueshme ose hoqi nga lista e rasteve 38.480 kërkesa (afro 95%); 33.288 prej tyre (87%) u shpallën të papranueshme nga një gjyqtar i vetëm.³⁹

Në të njëjtën kohë, komitetet me tre anëtarë kishin juridiksion për të gjykuar në lidhje me bazueshmërinë e aplikimeve (dhe jo vetëm vendimet e papranueshmërisë); në lidhje me çështjet që ishin shqyrtuar tashmë nga Gjykata dhe ishin pjesë e praktikës jurisprudenciale tashmë të konsoliduar. Një zhvillim që pasoi këtë gjë ka qenë miratimi nga Gjykata në vitin

37 No. 35399/05, 27 Tetor 2015, paragrafi 64.

38 Dokumenti mund të aksesohet në anglisht: https://www.echr.coe.int/Documents/Library_Collection_P14_ETS194E_ENG.pdf

39 Shih Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, *Analiza e statistikave 2019, Janar 2020*, e disponueshme në Anglisht: https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Stats_analysis_2019_ENG.pdf, faqe 4.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

2011⁴⁰ i *institucionit të gjyimit pilot*, ku Gjykata shqyrton me përparësi një aplikim që thekson një rend strukturor ose sistemik në kuadrin ligjor të brendshëm, një problem që tashmë është ose mund të bëhet objekt i aplikimeve të shumta (që mund të rrisin numrin e çështjeve të prapambetura të Gjykatës). Në kontekstin e një gjykimi pilot, Gjykata zakonisht do të japë urdhërime detyruese për gjykatat vendase lidhur me masat që duhet të ndërmerren për të adresuar problemin. Gjykata gjithashtu ka mundësinë të shtyjë shqyrtimin e çështjeve të ngjashme, me shpresën se shteti i paditur do të ndërmerre masa të shpejta nga të cilat mund të përfitojnë edhe ankuesit e këtyre rasteve.

Së dyti, kriteret e reja të pranueshmërisë u prezantuan si pjesë e reformës rrënjësore të Gjykatës. Kështu, rastet kur aplikanti nuk mund të vërtetojë se ai/ajo pëson një *“disavantazh të rëndësishëm”* pas shkëlqes së pretenduar të të drejtave të tij/saj parashikuar në Konventë në mënyrë që rastet kur aplikanti nuk ka pësuar një disavantazh të rëndësishëm të deklarohen të papranueshme, dhe u futën masa për t’u marrë në mënyrë më efektive me raste të përsëritura. Në të njëjtën mënyrë, Gjykata vendosi kriteret administrative më rigorozet. Kështu, sipas Rregullit 47 të Rregullores së Gjykatës⁴¹, aplikantët tani mund të paraqesin një kërkesë duke plotësuar vetëm një formular të posaçëm aplikimi, i cili ka një model standard prej 13 faqesh. Aplikanti duhet të përcaktojë në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes dhe argumentet e tij / saj ligjore. Informacioni i përfshirë në formularin e aplikimit duhet të jetë i mjaftueshëm për t’i dhënë mundësi Gjykatës të përcaktojë natyrën dhe fushën e aplikimit dhe, si i tillë, formulari i plotësuar i aplikimit duhet të mjaftojë. Dështimi në plotësimin e formularit në përputhje me udhëzimet e gjykatës, të dhëna në Udhëzuesit Praktik passjell mospranueshmërinë e aplikimit.⁴²

ii. Përmbledhje e masave të miratuara nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës me qëllim adresimin e çështjeve të prapambetura në gjykata

Shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës janë përballur dhe disa ende po përballen, me problemin e numrit të madh të çështjeve të prapambetura pranë gjykatave të tyre. Nisur nga kjo, shumica e tyre zbatuan reforma të gjera apo krijuan mekanizma ligjorë me qëllim zvogëlimin e numrit të çështjeve të mbetura dhe parandalimin e formimit të tyre në të ardhmen. Disa nga këto reforma dhe masa janë përshkruar më poshtë. Në funksion të qëllimit të këtij studimi, fokusi është vendosur vetëm në masat që u miratuan nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ose nga Gjykata. Së fundmi, rikujtojmë se përgjatë gjithë këtij dokumenti theksi është vendosur te mekanizmat parandalues, dhe jo thjesht të ata kompensues, për adresimin e çështjeve të prapambetura në gjykata.

Disa shembuj të masave të ndërmarra në kontekstin e reformave gjithëpërfshirëse gjyqësore paraqiten në vijim.

40 Kodifikuar në nenin 61 të Rregullores së Gjykatës.

41 Rregullorja mund të aksesohet në gjuhën shqipe në adresën: https://www.echr.coe.int/Documents/Rule_47_SQI.pdf

42 Mund të aksesohet në gjuhën angleze në adresën: https://www.echr.coe.int/Documents/PD_institution_proceedings_ENG.pdf

Slovakia

Pas një serie gjykimesh nga Gjykata në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, autoritetet sllovaqe midis vitit 2007 dhe 2010, kryen katër reforma legislative. Më e gjera ishte ajo e katërta, e njohur si reforma e madhe e Kodit të Procedurës Civile (KPC), e cila çoi në thjeshtimin e rregullimeve për shërbimin e dokumenteve, zgjerimin e kapaciteteve të gjykatave për të shqyrtuar një çështje pa seancë dëgjimore dhe kufizimin e mundësisë që gjykatat e apelit dhe gjykatat e larta të kundërshtojnë ose të prishin vendimet e dhëna nga një gjykatë më e ulët, dhe t'i kthejnë ato për rishikim.

Rikthimi i çështjes në një shkallë më të ulët është i mundur vetëm kur gjykatat e ulëta kanë gabuar haptazi me faktet e çështjes dhe zbatojnë gabimisht ligjin; në mënyrë të ngjashme, dhe pas futjes së parimit të rishikimit në procese gjyqësore, Gjykata e Lartë tani mundet proprio motu/ kryesisht të ndreqë vendimet e gjykatës më të ulët dhe të dalë me një vendim të formës së prerë në vend që ta dërgojë çështjen për rishqyrtim në gjykatat më të ulëta⁴³. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, organi i ngarkuar me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës nga Shtetet Anëtare, konsideroi se këto ndryshime, së bashku me masa të tjera, siç është alokimi më i mirë i personelit gjyqësor, ishin një hap në drejtimin e duhur dhe përfundimisht mbylli mbikëqyrjen e aktgjyqimeve të Gjykatës.⁴⁴

Republika Çeke

Autoritetet Çeke ndërmorën një sërë masash të ngjashme në kontekstin e reformave ligjore që ata kryen. Qëllimi i këtyre masave ishte zvogëlimi i ngarkesës së gjyqtarëve, thjeshtimi i procedurave dhe parandalimi i vonesave. Ndër masat e ndërmarra ishin ri-përcaktimi i detyrave të gjyqtarëve dhe personelit ndihmës siç janë nëpunësit e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, me këta të fundit që tani gëzojnë një mandat më të gjerë dhe kryejnë detyra që deri vonë kryheshin nga gjyqtarët. Masa të tjera përfshijnë inkurajimin e zgjidhjes miqësore dhe ndërmjetësimin midis palëve, kujdesin e veçantë në rastet familjare, vendimmarrjen e shpejtë në procedurat në lidhje me fëmijët dhe mundësinë e ndërmjetësimit dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve midis prindërve⁴⁵. Komiteti i Ministrave i ka vlerësuar këto masa pozitivisht dhe si rezultat mbylli mbikëqyrjen e gjyqimeve përkatëse.⁴⁶

43 *Action plan / action Report of the Slovak Government*, DH-DD(2011)518E, 30 June 2011, e aksesueshme në Anglisht në adresën: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22fulltext%22:%22Jakub%22,%22display%22:\[2\],%22EXECIdentifier%22:%22DH-DD\(2011\)518E%22,%22EXECDocumentTypeCollection%22:%22CEC%22](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22fulltext%22:%22Jakub%22,%22display%22:[2],%22EXECIdentifier%22:%22DH-DD(2011)518E%22,%22EXECDocumentTypeCollection%22:%22CEC%22)} faqe 5.

44 Rezoluta CM/ResDH(2012)59[1] *Execution of the judgments of the European Court of Human Rights 110 cases against the Slovak Republic*, mund të aksesohet në gjuhën angleze në adresën: <https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22EXECIdentifier%22:%22001-109748%22>}}

45 Komiteti i Ministrave, *Supervision of the Execution of Judgments of the European Court of Human Rights, 3rd Annual Report 2009*, e aksesueshme në gjuhën angleze: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090001680592ac5>, faqe 121. Shih gjithashtu *Action Report of the Czech Republic*, DH-DD(2013)237, 26 Mars 2013, gjendet në gjuhën angleze në linkun: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22EXECIdentifier%22:%22DH-DD\(2013\)327E%22](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22EXECIdentifier%22:%22DH-DD(2013)327E%22)}}

46 Rezoluta CM/ResDH(2013)89 *Bořánková and Hartman and 69 other cases against the Czech Republic Execution of the judgments of the European Court of Human Rights*, gjendet në anglisht në adresën: <https://hudoc.exec.coe.int/eng#%22EXECIdentifier%22:%22001-122060%22>}}

Italia

Vonesat e tepruara në procedurat administrative kishin çuar në formimin e një numri të pafundëm të çështjeve të prapambetura. Si rrjedhojë, u miratuan një sërë masash të gjera, Kodi i Procedurës Administrative (CAP) që u miratua në 2010 prezantoi një seri mjetesh efektive procedurale që mundësoi trajtimin e çështjeve të pazgjidhura dhe zgjidhjen me efikasitet të çështjeve të reja që depozitoheshin në gjykatë. Për shembull, gjykatat administrative tani mund të dalin me një vendim të formës së shkurtuar duke përmbledhur arsyet themelore kur gjykata vëren se një kërkesë është qartazi e bazuar ose, anasjelltas, dukshëm e pabazuar. Për më tepër, pasi vuri në dukje se shumë çështje para gjykatave administrative në lidhje me prokurimet publike, autoritetet italiane morën një sërë masash me qëllim përshpejtimin e procedurave të tilla. Sipas Kodit të Procedurës Administrative, tani është e mundur të përcaktohet procedura gjatë seancës dëgjimore për masat e përkohshme / urgjente, ndërsa në çdo rast procesi gjyqësor do të duhet të përfundojë brenda 45 ditëve nga skadimi i afatit të palëve për t'u përfshirë në proces. Për më tepër, u miratuan masa me qëllim të zvogëlimit të çështjeve administrative, për shembull futja e procedurave të thjeshtuara në dhoma dhe disa metoda alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Masat e përshkruara më sipër u shoqëruan me futjen e një sistemi të fuqishëm monitorimi që synonte sigurimin e të dhënave statistikore të përditësuara dhe të besueshme për numrin e aplikimeve të paraqitura, të përpunuara dhe në pritje para gjykatave administrative dhe për kohëzgjatjen e tyre mesatare. Sistemi është zgjeruar në mënyrë që të mbledhë informacione edhe për aspekte të tjera të procesit administrativ, të tilla si numri i masave të përkohshme/urgjente dhe vendimet e formës së shkurtuar të miratuara.

Nuk vonoi shumë dhe këto masa dhanë rezultate. Kështu në vitin 2015, përkatësisht pesë vjet pas miratimit të masave, u regjistrua një rënie e konsiderueshme në numrin e çështjeve të pazgjidhura para Këshillit të Shtetit dhe gjykatave administrative rajonale, me numrin e mbetur të kërkesave në pritje para këtyre gjykatave nga 467.419 në 2011, në 268.246 (ulje prej 43%) në 2015. Sa i përket kohëzgjatjes mesatare të procedurave para Këshillit të Shtetit, informacioni i dhënë tregon se është më pak se një vit në çështjet e prokurimit publik dhe rreth një vit e gjysmë për procedurat në lidhje me vendimet nga autoritetet e pavarura administrative. Për më tepër, kohëzgjatja mesatare e procedimeve për të marrë një masë të përkohshme/urgjente është rreth 30 ditë para Këshillit të Shtetit dhe 45 ditë para gjykatave rajonale administrative (30 ditë në çështjet në lidhje me prokurimin publik). Duke shprehur kënaqësinë e tij me këto masa dhe ndikimin e tyre, Komiteti i Ministrave vendosi në 2016 për të mbyllur mbikëqyrjen në lidhje me 75 raste, por gjithashtu u kërkoi autoriteteve italiane të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të zvogëluar më tej numrin e prapambetur.⁴⁷

Të njëjtat masa u ndërmorën edhe në lidhje me procedurat penale. Pas ndryshimeve të vitit 2017 në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, theksi u vu në përshpejtimin e procedurave të veçanta të tilla si gjykimi i shkurtuar (*giudizio abbreviato*) dhe marrëveshjet e

47 Komiteti i Ministrave, takimi i 1273-te, 6-8 Dhjetor 2016 (DH), *Decision regarding the Abenavoli group v. Italy (Application No. 25587/94) Supervision of the execution of the European Court's judgments*, e aksesueshme në link-un: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#{"EXECIdentifier": \["CM/Del/Dec\(2016\)1273/H46-13"\]}](https://hudoc.exec.coe.int/eng#{)

fajësisë. Ankesat të adresuara në Gjykatën e Lartë në lidhje me marrëveshjet për pranimin e fajësisë tani janë të kufizuara në rrethana shumë specifike, siç janë defektet në lidhje me vullnetin e lirë të të akuzuarit, dhe negocimi i fajësisë për krime të lehta është tani i mundur edhe në procedurat e apelit (*concordato sui motivi d'appello*). Ndryshime të ngjashme u prezantuan gjithashtu në vitin 2018.

Një numër i konsiderueshëm i masave të miratuara synojnë të kufizojnë aksesin në Gjykatën e Lartë, prokurorët tani kanë më pak mundësi për të ankimuar vendimet e pafajësisë të Gjykatës së Lartë të mbështetura nga gjykatat e apelit si dhe dënimet, ndërsa ankesat në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të marrëveshjeve të fajësisë tani janë të pranueshme vetëm nëse ankimohen për moszbatim të rregullt të ligjit.

Në mënyrë të ngjashme, u prezantua një procedurë e thjeshtuar për disponimin e apeliave *prima facie* të papranueshme para Gjykatës së Lartë. Rekursat tani mund të paraqiten vetëm nga avokatë të regjistruar në një listë të veçantë, ndërsa aplikohen gjopa më të larta për ankesat e papranuara dhe padyshim ato abuzive. Për më tepër, Gjykata e Lartë tani mund të procedojë dhe të japë një vendim përfundimtar pa e dërguar çështjen në gjykatat më të ulëta në më shumë rrethana, ndërsa procedura për korrigjimin e gabimeve në gjykime është thjeshtuar. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, dhe për të siguruar qasje më efektive në drejtësi për paditësit, sipas ndryshimeve të reja, Gjykata e Lartë është e detyruar t'u sigurojë palëve informacion dhe argumente më gjithëpërfshirëse në lidhje me vendimin e saj potencial për të refuzuar një rekurs si të papranueshëm, duke i dhënë kështu një mundësi më të mirë paditësit për të paraqitur kundër-argumentet përkatëse. Si rezultat i këtyre masave, shkalla e pastrimit të Gjykatës së Lartë (d.m.th. ndryshimi midis çështjeve të reja dhe të përfunduara të shprehura në terma përqindjeje) për vitin 2016 ishte 110.7%, ndërsa kohëzgjatja mesatare e procedimeve për të njëjtin vit ishte 240 ditë⁴⁸. Komiteti i Ministrave vuri në dukje këto zhvillime, mirëpriti reformën në drejtësinë penale, por u bëri thirrje autoriteteve italiane të vazhdojnë monitorimin e situatës dhe të kryejnë një vlerësim më të hollësishëm për sa i përket ndikimit të reformës në pastrimin e çështjeve të prapambetura të gjykatave penale, në veçanti ato para gjykatës së apelit ku situata dukej se vazhdonte të ishte problematike.⁴⁹

iii. Masat / mekanizmat ligjorë që mund të ndihmojnë në trajtimin e numrit të mbetur të çështjeve pranë gjykatave të larta

Një përmbledhje e jurisprudencës së Gjykatës zbulon se ajo ka mbështetur disa masa ad hoc të miratuara nga shtetet me qëllim përshpejtimin e procesit, si dhe uljen e numrit të mbetur të çështjeve të prapambetura të gjykatave të niveleve më të larta. Duhet të theksohet se në të gjitha këto raste, Gjykata vuri theksin e veçantë që kufizimet përkatëse ishin përcaktuar në ligj ose ishin përcaktuar në një praktikë të konsoliduar të jurisprudencës.

48 Plani i veprimtimit i Qeverisë Italiane, DH-DD(2018)700, 6 Korrik 2018, i aksesueshëm në Frengisht në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016808c2977

49 Committee of Ministers, 1324th meeting, 18-20 September 2018 (DH), *Decision regarding the Ledonne No. 1 group v. Italy (Application No. 35742/97) Supervision of the execution of the European Court's judgments*, i aksesueshëm në anglisht në linkun: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#{"EXECIdentifier":\["004-28200"\]}](https://hudoc.exec.coe.int/eng#{)

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Kështu, në çështjen e *Vegotex International SA kundër Belgjikës*⁵⁰, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë nuk ka shkelur nenin 6 të Konventës, pse ajo ka marrë njohuri *proprio motu* / *kryesisht* dhe pse e ka mbështetur vendimin e saj mbi një çështje (domethënë futjen e legjislacionit të ri me efekt prapaveprues) zbatueshmëria e së cilës u refuzua nga gjykata e apelit dhe prandaj kërkuesi nuk e kishte adresuar më pas në Gjykatën e Lartë. Gjykata konsideroi se ky mekanizëm i veçantë ligjor nuk ishte në parim në kundërshtim me Konventën, nëse palëve iu ishte dhënë mundësia për të komentuar mbi zbatimin e saj të mundshëm. Në çështjen në fjalë, Gjykata vuri në dukje se megjithëse propozimi nga Avokati i Përgjithshëm i Gjykatës së Lartë iu njoftua ankuesit vetëm disa ditë para seancës, aplikanti mund të kishte komentuar mbi propozimin dhe mund të kishte parashtruar pretendime të tjera edhe pas seancës dëgjimore.

Në një seri çështjesh të tjera, Gjykata ka konsideruar se kriteret kufizuese të pranueshmërisë së paraqitjes së një ankese në Gjykatën e Lartë, që synojnë përshtypimin e përpunimit të ankesave/rekurseve pranë gjykatës së lartë, nuk ngritën ndonjë problematikë në lidhje me përputhjen e tyre me të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës, të parashikuar shprehimisht edhe në nenin 6 të Konventës. Në çështjen *Trevisanato kundër Italisë*⁵¹, Gjykata nuk gjeti gabime në kërkesën ndaj avokatëve specialistë të cilët duhet ta përmbledhin çdo fazë ankimi apo rekursi me një paragraf, në të cilën të parashtrohet në mënyrë eksplicite parimi ligjor që pretendohet të jetë shkelur, nuk përbën një kufizim joproportional as nuk e konsiderojnë *formalizim të tepërt*. Në çështjen *Astikos Kai Paratheristikos Oikodomikos Synetairismos Axiomatikon and Karagiorgos v. Greece*⁵², Gjykata konsideroi se kërkesa ndaj aplikuesit/ankuesit për të treguar, në mënyrë të detajuar në deklaratën e tij fillestare se secila prej shkallëve të gjykimit ngriti një problematikë specifike juridike vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe se ajo zgjidhje ishte e papajtueshme me praktikën e konsoliduar e të gjithëpranuar të Këshillit të Shtetit ose të një gjykate tjetër më të lartë ose me një vendim përfundimtar të gjykatave administrative, ose përndryshe që nuk kishte asnjë praktikë gjyqësore të rëndësishme për çështjen ligjore në fjalë, nuk përbente kufizim joproportional të së drejtës së tij / saj për t'iu drejtuar Kolegjit të Çështjeve Administrative pranë Gjykatës së Lartë. Kjo erdhi si rrjedhojë e rolit specifik të luajtur nga ajo gjykatë si gjykatë përgjegjëse për sigurimin e qendrueshmërisë së praktikës gjyqësore, dhe ishte e pranueshme që procedurat para saj t'i nënshtroheshin një numri më të madh të kriterëve të pranueshmërisë. Për më tepër, paraqitja e një ankese të pranueshme nga ana ligjore, subjekt të ekzistencës së fakteve objektive dhe kërkesa nga ankuesi që të sigurojë prova të ekzistencës së tyre, të cilat ishin kriterë të parashikuara nga ligji dhe të interpretuara nga praktika gjyqësore administrative, nuk ishin, në vetvete, joproportionale me qëllimin e ndjekur nga masa në fjalë, përkatësisht për të lejuar që gjykata të arrijë një vendim të shpejtë për çështjet me interes të përgjithshëm në mënyrë që të krijojë menjëherë një praktikë të re gjyqësore që do të ndiqet nga gjykatat e nivelit më të ulët në të ardhmen.

I ngjashëm ishte përfundimi i Gjykatës në çështjen e fundit të *Efstratiou dhe të tjerët kundër Greqisë*⁵³. Në atë rast, Gjykata konsideroi se një kërkesë e dorëzuar pranë saj e që ishte dorëzuar fillimisht në shkallët më të ulëta të gjykimit, duhej të futej në dosje në formën e një dokumenti të vetëm, me referenca të drejtpërdrejta në faqet ku u bënë argumente përkatëse

50 Nr. 49812/09, 10 Nëntor 2020.

51 Nr. 32610/07, 15 Shtator 2016.

52 (Dec), nr. 29382/16 dhe 489/17, 9 Maj 2017.

53 Nr. 53221/14, 19 Nëntor 2020.

ose nga provat në të cilat u mbështet, në vend se thjesht duke iu referuar “materialit të sjellë para gjykatës së shkallës së parë”- kjo sjellje e Gjykatës nuk përbën *formalizëm të tepruar*. Kjo u kërkua pasi kërkesa kishte për qëllim lehtësimin e gjyqtarëve të gjykatës së apelit për të identifikuar argumentet e paditësve pa humbur kohë duke konsultuar edhe njëherë nga e para në dosjen e çështjes.

Gjykata gjithashtu ka vendosur që “gjykatave të larta” të mos iu kërkohet të japin arsytim shterues kur refuzojnë rekursin. Kështu, në çështjen *Kadagishvili kundër Gjeorgjisë*, Gjykata konsideroi se arsyet e kufizuara të paraqitura nga Gjykata e Lartë për shpalljen të papranueshëm të ankimit për një çështje penale në Gjykatën e Apelit, domethënë se pranimit i tij (rekursi) “nuk ishte i rëndësishëm për zhvillimin e ligjit dhe praktikës koherente gjyqësore” dhe se vendimi i kundërshtuar ishte i përshtatshëm pasi nuk ishte në kundërshtim me praktikën e konsoliduar gjyqësore. Në këtë gjykim, Gjykata mori parasysh se Gjykata e Lartë e Gjeorgjisë nuk bëri një rishikim të plotë të çështjes, por shqyrtoi vetëm aspekte të veçanta ligjore të çështjes. Gjithashtu kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje për shkak se arsyet përkatëse ligjore të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm nuk janë përmbushur, nuk ka nevojë që Gjykata e Lartë të bëjë një arsytim të gjerë.⁵⁴

Së fundmi, Gjykata ka konsideruar se vendosja e një pragu të specifikuar (kriteri i pranimit të *ratione valoris*) për t’ju drejtuar një gjykate të lartë i shërben qëllimit legjitim që të sigurohemi se vetëm çështjet e një rëndësie të caktuar të paraqiten para saj, dhe që gjykata të kërkohet të investohet vetëm për çështje të një rëndësie të tillë që i përshtatet rolit të saj dhe si rezultat është në parim një kufizim i pranueshëm i së drejtës për t’ju drejtuar gjykatës; sidoqoftë Gjykata paralajmëroi po ashtu se proporcionaliteti i një kufizimi të tillë duhet të vlerësohet rast pas rasti (*Zubac kundër Kroacisë*⁵⁵).

iv. Rekomandime për institucionet kompetente në bazë të praktikave të mësipërme

Avokaturës së Shtetit

Është e domosdoshme që institucioni i Avokaturës së Shtetit të ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës të të gjitha rekursve që ka depozituar dhe aktualisht janë në pritje në Gjykatën e Lartë, me qëllim tërheqjen nga ato çështje në të cilat pretendimet e saj nuk janë të mirëargumentuara dhe kanë shumë pak shanse të pranohen/të fitohen. Kjo do ta bëjë vendimin e gjykatës së apelit të përvokueshëm dhe për këtë arsye plotësisht të ekzekutueshëm. Për më tepër, dhe/ose në mënyrë alternative, Zyra e Avokaturës së Shtetit duhet të shqyrtojë mundësinë ose arritjen e zgjidhjeve jashtë gjykatës në lidhje me disa prej këtyre çështjeve (veçanërisht çështje komplekse ku interesat financiare të konsiderueshme janë në rrezik); në të njëjtën kohë, marrëveshjet e tilla jashtë gjykatës do të jenë gjithashtu të dobishme për fondin publik, pasi palët mund të bien dakord për pagimin e dëmeve më të ulëta. Në këtë drejtim, vihet re se Gjykata ka pranuar që dëmet e paguara në këto marrëveshje mund të jenë më të ulëta se ato të paguara pas miratimit të një vendimi gjyqësor, pasi marrëveshjet e tilla kanë përfitime të pamohueshme edhe për paditësit, për aq sa nuk kanë përse të presin për

54 Nr. 12391/06. 14 Maj 2020, paragrafi 175.

55 [DHM], nr. 40160/12, 5 Prill 2018.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

përfundimin e procedurave gjyqësore në mënyrë që të marrin kompensimin e tyre, dhe as nuk rrezikojnë të shkaktojnë kosto të larta ligjore dhe tarifa në rast se pretendimet e tyre në fund të fundit do të refuzohen.⁵⁶

Gjykatës së Lartë

Edhe pse është e mundur që disa prej rekomandimeve të mëposhtme mund të jenë miratuar tashmë, ose janë në proces, në kontekstin e këtij projekti mund të konsiderojmë:

Së pari, Gjykata e Lartë duhet të kryejë një analizë gjithëpërfshirëse të çështjeve që i janë bërë “stok”. Gjetjet e hulumtimit duhet të ndahen nga tregues të ndryshëm, të tilla si data e depozitimit, tema, mosha/situata personale e paditësit, e vlerësimit nëse ajo nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë, nëse ngre një çështje të re dhe / ose nëse çështjet që ajo ngriti mund të adresohen në bazë të praktikës së konsoliduar të Gjykatës së Lartë (p.sh. ngre një çështje juridike që ka qenë objekt i një Vendimi Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara).

Ky filtrim i çështjeve do të lejojë Gjykatën e Lartë t'i grupojë ato në kategori të ndryshme (p.sh. ato që janë haptazi të papranueshme, çështje që trajtojnë çështje të reja ligjore, çështje që kërkojnë kujdes të veçantë për shkak të natyrës së çështjes e kështu me radhë). Më pas, duhet t'u jepet përparësi çështjeve që mund të zgjidhen lehtësisht dhe pa u investuar shumë burime nga Gjykata e Lartë (p.sh. raste të papranueshme, të cilat besohet se përbëjnë pjesën më të madhe të numrit të mbetur të tanishëm), çështje që janë të shumta dhe ngrenë çështje të ngjashme (p.sh. pajtueshmëria me Kushtetutën e metodës së llogaritjes së kompensimit në procedurat e shpronësimit - një çështje që është adresuar tashmë nga Gjykata e cila udhëzon gjerësisht gjykatat vendase në vendimin e saj)⁵⁷, ose rastet kur vonesa në dhënien e një vendimi mund të ketë pasoja të pakthyeshme mbi paditësin (p.sh. çështjet e paraburgimit, çështjet e së drejtës familjare në lidhje me të drejtën për të takuar fëmijët e mitur, por jo në rastet kur fëmijët janë afër moshës së rritur; në mënyrë të ngjashme, përparësi duhet t'u jepet rasteve të aplikantëve me një moshë të thyer që ankohen për çështje të pensionit të tyre kur ky është burimi kryesor i të ardhurave, por jo për shembull për të moshuarit që nuk kanë asnjë problem thelbësor, por ankohen për shumën e kompensimit për shpronësimin e njërës prej pronave). Me fjalë të tjera, dhe të paktën përkohësisht, Gjykata e Lartë duhet të miratojë një politikë me përparësi të kundërt me atë të Gjykatës të përshtatshme sipër: thënë ndryshe, përparësi duhet t'u jepet atyre çështjeve që mund të zgjidhen lehtësisht gjyqësisht dhe ato janë çështjet që gjykata do t'i klasifikojë si kategoria e gjashtë dhe e shtatë. Përfaqësuesit ligjorë të paditësve mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar Gjykatën e Lartë, dhe kjo shpjegohet më poshtë. Edhe pse jashtë temës së këtij studimi, këshillohet që Gjykata Kushtetuese të miratojë masa të ngjashme, me qëllim që të sigurojë që një pjesë e prapambetur e Gjykatës së Lartë të mos transferohet tek ajo.

Në të njëjtën kohë, rekomandohet që Gjykata e Lartë të shmangë dërgimin e çështjes për shqyrtim të ri në gjykata më të ulëta pasi kjo vetëm do të rrisë zgjatjen e procedimeve. Për

56 *Dubjaková k. Slovakisë* (dec), nr. 67299/01, 19 Tetor 2004, L.F. k. Irlandës (dec), nr. 62007/17, 10 Nëntor 2020, paragrafi 126 – 127.

57 *Beshiri dhe të tjerët k. Shqipërisë* (dhjetor), op. cit .. Duhet të theksohet se ky vendim i veçantë ka të bëjë me një grup prej 12 aplikimesh me një total prej 104 aplikantësh. Aplikimi më i hershëm i grupit ishte paraqitur në 2006 dhe më i fundit në 2015.

më tepër, është shumë e këshillueshme që kur Gjykata e Lartë të japë vendimin e saj, ajo proprio motu dhe pa kërkuar ngritjen e një procesi gjyqësor të veçantë për këtë qëllim, të japë kompensim për kohëzgjatjen e procedimeve para saj siç parashikohet në legjislacionin procedural. Kjo jo vetëm që do t'u sigurojë dëmshpërblim paditësve për vonesën në shqyrtimin e çështjeve të tyre dhe do të përbëjë një njohje simbolike dhe materiale të shkeljes së të drejtës së tyre për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, por gjithashtu do të mbrojë Gjykatën e Lartë nga një 'përmbytje e re' nga një valë çështjesh që lidhen me të drejtën e dëmshpërblimit për zgjatjen e procedurave në të ardhmen në lidhje me çështjet për të cilat ka vendosur tashmë.

Gjykatës së Lartë dhe Dhomës së Avokatisë

Na duhet të sjellim në vëmendje që sipas nenit 3 paragrafi 2 i Ligjit 55/2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë", gjatë ushtrimit të profesionit të tyre avokatët duhet "të udhëhiqen kryesisht nga interesat e klientit që ai/ajo përfaqëson".

Avokatët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në asistimin e Gjykatës së Lartë në filtrimin e çështjeve të prapambetura përgjatë linjave të përmendura më lart me anë të mbledhjes së të dhënave. Kështu për shembull, Gjykata e Lartë mund të hartojë një pyetësor/format (që përmban pyetje/kuti për t'u shënuar që synojnë lejimin e Gjykatës së Lartë të klasifikojë çështjet në grupe të ndryshme dhe më pas të vendosë se cilit grupi duhet t'i jepet përparësi) - dhe në rastin më të mirë, të jetë pyetësor elektronik që mund të plotësohet në internet - dhe, në bashkëpunim me Dhomën e Avokatëve, t'u kërkojë avokatëve që ta plotësojnë atë. Besohet se kjo kërkesë nuk do të shkaktojë shqetësime të mëdha për avokatët (pasi ata janë të njohur me çështjet e tyre dhe mund ta plotësojnë shpejt formularin përkatës. Në të njëjtën kohë, kërkesa për ta bërë këtë bie qartë në fushën e detyrimeve të tyre, pasi kjo do të lejojë Gjykatën e Lartë të procedojë më shpejt çështjet e tyre.

V. CFARË TJETËR MUND TË BËHET?

5.1. Shqyrtimi i vendimeve të mospranimit nga një gjyqtar

Nga statistikat e Gjykatës së Lartë vihet re se numri i mospranimeve të rekurseve të shqyrtuara gjatë një viti është tepër i lartë. Në tabelën në vijim jepen shifrat lidhur me numrin e mospranimeve në 5 vitet e fundit.

Fig. 1 - Mospranime rekursi në 5 vitet e fundit

| Viti | Numri i rekurseve | Gjykime | | Mospranime | |
|--------------|-------------------|-------------|---------------|--------------|---------------|
| | | Nr. | % | Nr. | % |
| 2016 | 5815 | 1140 | 19.6 % | 4675 | 80.4 % |
| 2017 | 3754 | 1221 | 32.5 % | 2533 | 67.5 % |
| 2018 | 1673 | 216 | 12.9 % | 1457 | 87.1 % |
| 2019 | 489 | 17 | 3.5 % | 472 | 96.5 % |
| 2020 | 1478 | 62 | 4.2 % | 1461 | 95.8 % |
| Total | 13209 | 2656 | 20.1 % | 10553 | 79.9 % |

Sic rezulton, rreth 80% e çështjeve të depozituara në Gjykatën e Lartë nuk e kalojnë testin e pranueshmërisë, ndaj, për këtë arsye, Gjykata e Lartë ka shpallur mospranimin e tyre. Aktualisht, gjykata nuk ka asnjë mekanizëm “filtrues” për t’i identifikuar dhe zgjidhur me shpejtësi këto çështje, kur depozitohen. Si rezultat, mund të thuhet se afro 80% e palëve ndërgjyqëse që kanë çështje në Gjykatën e Lartë, presin për vite të tëra, vetëm për të mësuar në fund të pritjes se çështjet e tyre as nuk kualifikoheshin për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë⁵⁸. Duke e eliminuar këtë kategori nga çështjet e prapambetura, si dhe duke vënë në zbatim masa filtruese, do të bëhet e mundur që gjykata të përqendrohet në ngarkesën e çështjeve që vërtet i takojnë, pra ato që janë depozituar siç duhet dhe kualifikohen për t’u shqyrtuar nga gjykata dhe për rrjedhojë, duhet të gjykohen plotësisht prej saj.

58 Thirrja për aplikim të nëpunësve të çështjeve të prapambetura, http://www.gjykataelarte.gov.al/web/bro_posting_and_sow_final_alb_2478.pdf

Në këtë kontekst, çështje të kësaj natyre mund të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Natyra kolegjiale e vendimmarrjes përbën një mjet shtesë të garantimit të paanshmërisë së gjykatësve, ndaj gjykimi me një gjyqtar nuk do të ofronte garanci optimale, por vendimi për mospranimin e një rekursi nuk është në thelb një gjykim, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim nëse çështja pranohet për t'u gjykuar apo jo. Garantitë për këtë lloj vendimarrje sigurohen nga vet statusi dhe eksperiencia e Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Sidoqoftë benefitet janë të sigurta në adresimin e problematikës së uljes në masë të një numri të madh çështjesh që presin të gjykohen. Ngarkesa e çdo gjyqtari do të binte automatikisht, duke sjellë rezultat në gjykimin nga ana e një gjyqtari të më shumë çështjesh. Gjithashtu caktimi i çështjeve tek një gjyqtar i vetëm mundëson shfrytëzimin maksimal të burimeve njerëzore në dispozicion, ndërsa vendimmarrja kolegjiale paraqet vështirësi objektive në lidhje me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe ndërlikon realizimin e procedimeve. Gjithsesi, një parashikim i tillë në kodet e procedurës dhe ligjit për gjykimet administrative mund të ishte edhe një ndryshim tranzitor, deri në normalizimin e situatës post reformë.

5.2. Plotësimi i trupave gjyqësore me gjyqtarë të lartë në një kohë të shpejtë

Një ndër problemet për plotësimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është edhe procesi i emërimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Zhvillimi i një anketimi nga KLGJ do të ndihmonte për të kuptuar, cilat janë arsyet që stepen kandidatët e kualifikuar për t'u promovuar. Duke evidentuar shkaqet, hartimi i një plani veprimi nxitës dhe promovues do të shërbente për të rritur gatishmërinë e gjyqtarëve të pavetuar për të kandiduar.

Nga ana e KLGJ, sipas një shkrese drejtuar qendrës Res Publica, duket se është bërë gjithsesi një analizë, për sa i përket pengesave që kanë kushtëzuar procesin e emërimit të gjyqtarëve, metodologjinë e së cilës nuk e njohim ende dhe që listohen si më poshtë:

- ***Ndërvarësia me procesin e rivlerësimit kalimtar.*** Duke qenë se disa kandidatë që nuk kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar kanë aplikuar në disa pozicione të lira, priten ende rezultatet e këtij procesi. Për pasojë, vijimi i mëtejshëm i procedurës së ngritjes në detyrë dhe renditjes së kandidatëve është kushtëzuar me përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, siç është rekomanduar nga Komisioni i Venecias.
- ***Respektimi i të drejtave të kandidatëve në proces.*** Disa kandidatë për gjyqtarë, që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, kanë ankimuar vendimet e Këshillit në lidhje me përzgjedhjen e vetëm 3 pozicioneve të lira për aplikim, sic është parashikuar në kuadrin nënligjor në fuqi. Për pasojë, vijimi i mëtejshëm i procedurës së ngritjes në detyrë dhe renditjes së kandidatëve ka qenë i kushtëzuar me përfundimin e proceseve gjyqësore të ankimit qoftë në gjykatat administrative dhe Gjykatën e Lartë. Këto procese kanë marrë një kohë të konsiderueshme për trajtim.
- ***Kriza e shkaktuar nga Covid-19.*** Viti 2020 shënoi një ngadalësim të përkohshëm të

PËR PËRSHPEJTIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

aktivitetit të KLGJ për shkak të pandemisë globale Covid-19, sikurse edhe çdo institucion tjetër. Thirrja për aplikantët nga gjyqësori u pezullua që prej datës 12 mars 2020 për t'u hapur përsëri me Vendimin nr. 142, dt 22.04.2020.

- **Skema e re e vlerësimit të gjyqtarëve.** Këshilli ka miratuar dhe po zbaton një sistem të ri të promovimit të gjyqtarëve, i cili kërkon për efekt të ngritjes në detyrë që gjyqtarët kandidatë të kenë dy vlerësime etiko-profesionale. Aktualisht një pjesë e gjyqtarëve aplikantë nuk kanë qenë të vlerësuar dy herë nga ish-KLD. Për rrjedhojë, KLGJ, përmes Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, po trajton me prioritet vlerësimin e kandidatëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë për në Gjykatën e Lartë. Për pasojë këto procese vlerësuese të gjyqtarëve kandidatë kërkojnë kohën e nevojshme për t'u realizuar.

Nga ana tjetër, lidhur me vështirësitë e emërimeve dhe ngritjes në detyrë, Kryetarja e KLGJ në prezantimin e raportit 2020 në Kuvend u shpreh se:

“..Me gjithë ‘shtesën për vështirësi në punë’ në masën 60 % të pagës gjatë 2020 dhe 80% aktualisht dhe fushatat e vazhdueshme ndërjegjësuere, humbja e privatësisë së gjyqtarit dhe familjarëve, si dhe trysnia e procesit të rivlerësimit kalimtar mbeten shkaqet kryesore të bezitimit të gjyqtarëve për të aplikuar në këto pozicione.”

Lidhur me procesin e vetingut, është e domosdoshme arritja e një marrëveshjeje ndërinstitucionale për prioritizimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë. Mund të ndodhë që numri i kandidatëve të gatshëm të vijë duke u rritur, por përsëri procesi do të pengohet nga procedura e gjatë e vlerësimit, përmes vetingut.

Duke parë këtë situatë jemi të mendimit se për të bërë funksionale këtë gjykatë nevojitet lehtësim i kriterëve kualifikuese, me qëllim rritjen e numrit të kandidatëve. Ky rekomandim bëhet edhe më i vlefshëm, nëse shikojmë se shumë kriterë kualifikuese të sotme nuk janë justifikuese dhe as domethënëse për pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kështu për shembull, eksperiencia prej 15 vitesh mund të jetë preferenciale por jo kriter kualifikues. Ajo duhet të vlerësohet së bashku me kriteret e tjera. Kështu një kandidat që ka 14 vite eksperiencë mund të ketë një përgatitje të mjaftueshme dhe njësoj me atë që ka 15 vite pune. Në të njëjtën mënyrë pozicioni i këshilltarit mund të rikonsiderohet për t'u hequr si kriter skualifikues, pasi nuk mund të jetë njësoj një individ i përfshirë drejtpërdrejt në politikë siç është ministri apo deputeti dhe një individ që ka punuar në pozicionin e teknikut si këshilltar, apo sekretar i tij. Në përgjithësi kriteret duhet të rishikohen dhe vlerësohen në kontekstin e dhënë dhe sipas nevojave të shfaqura.

Nga ana tjetër KLGJ konstaton se faktor nxitës për shpejtimin e gjykimeve mendohet të jetë, (realizimi i një anketimi konkret do të jepte një pasqyrim më objektiv e jo subjektiv të situatës), hartimi i një harte të re gjyqësore. Kështu, për këtë ai ka dorëzuar një projekt-propozim në Ministrinë e Drejtësisë në fund të vitit 2020, për vazhdimësinë e së cilës nuk kemi informacion. Sipas këtij propozimi pritet që gjykatat e apelit të mblidhen në një të vetme, ndërsa të pakësohen gjykatat e rretheve gjyqësore. Ky projekt shihet në mënyrë kritike nga ekspertë të fushës. Prof. Dr. Jordan Daci bën këtë analizë lidhur me këtë nismë:

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

“Vetëm për vitin 2019 në shkallë vendi çështje civile ka pasur pa gjykuar 15.114 çështje dhe penale 4.969. Pra gjithsej rreth 20.083. Duke pasur parasysh që për çdo vit normal dhe jo si viti 2020 dhe 2021 me kolapsin që ka pësuar, vetëm për 2019 janë mbartur në shkallë vendi 4.254 nga 9.223 çështje në total dhe çështje civile janë mbartur 8.253 nga 15.114 në total. Pra janë mbartur rreth 62.27%. Duke e krahasuar mbartjen me numrin e çështje të reja të ardhura për këtë vit prej 4.969 penale dhe 6.990 civile ose në total 6.990 çështje, i bie që shtesa në mbartje të jetë më këto të dhëna, për çdo vit të jetë rreth 5.517 çështje.

Aktualisht vetëm Gjykata e Apelit në maj 2021 ka rreth 17.000 çështje të pagjykuara. Kjo gjykatë civile në shkallë vendi në 2019 ka pasur rreth 30.6 % të ngarkesës në shkallë vendi dhe penale në shkallë vendi në 2019 ka pasur rreth 782 ose 8.47 % të ngarkesës në shkallë vendi.

Pra aktualisht mund të jenë afërsisht në shkallë vendi minimalisht rreth, nëse marrim ngarkesën e Tiranës mesatarisht në 20 %, në shkallë vendi rezulton të jenë në pritje rreth 85.000 çështje dhe me mbartjet e reja dhe vendet e lira të tjera që krijohen çdo ditë mund të shkojë deri në fund të vitit rreth 100.000 – 110.000 çështje.

Pra Gjykata e Apelit duhet të gjykojë të paktën 100.000 çështje që e ndarë me një ngarkesë normale 200 çështje në vit duhet të ketë 500 gjyqtarë për t'i gjykuar brenda një viti ose 500 gjyqtarë për t'i gjykuar brenda 5 vitesh dhe nëse trefishtë ngarkesën 600 çështje në vit kërkon 166 gjyqtarë për t'i gjykuar për 1 vit dhe ose 166 gjyqtarë për t'i gjykuar brenda 5 vitesh. Pa shtuar këtu rritjen e natyrshme për vitet në vijim.”

5.3. Plotësimi i personelit ndihmës me këshilltarë/nëpunës të tjerë brenda organikës

Sot në Gjykatën e Lartë janë të punësuar 16 këshilltarë, nga të cilët 10 janë magjistratë dhe 6 jo magjistratë. Ky numër nuk e plotëson raportin e dy këshilltarëve për çdo gjyqtar sot. Megjithatë numri i këshilltarëve mund të synohet të jetë deri në 36, duke ruajtur raportin me numrin në potencial të gjyqtarëve dhe jo me numrin real të tyre.

Përpijeke duhen bërë edhe për nxitjen e plotësimit me 8 nëpunës të tjerë të Qendrës së Dokumentacionit dhe pa diskutim me emërimin e Kancelarit.

Me gjithë rëndësinë që i është dhënë rekrutimit dhe trainimit të njësisë mbështetëse të Gjykatës së Lartë, kancelarit dhe nëpunësve të Qendrës së Dokumentacionit, synimet e parashikuara nga KLGJ dhe Gjykata e Lartë në Udhërrëfyesin e rritjes së efektivitetit të Gjykatës së Lartë 2020-2021, lidhur me këtë pikë nuk janë plotësuar sipas afateve të parashikuara në Udhërrëfyes dhe as më pas në kohën e monitorimit të këtij dokumenti, siç do trajtojmë në vijim. Nëse vështirësitë në plotësimin e gjykatës me gjyqtarë janë më të kuptueshme, plotësimi me numrin e duhur të stafit mbështetës duhet të përshtatet dhe të jetë më fleksibël, si në kritere, ashtu edhe në nxitje të formave të ndryshme.

5.4. Kufizimi i çështjeve që mund të gjykohen nga Gjykata e Lartë

Siç e shprehëm më lart, Gjykata Evropiane nuk e cilëson shkelje nëse disa çështje që nuk paraqesin “disavantazhe të rëndësishme” mund të lihen jashtë shqyrtimit nga “gjykatat e

larta”. Se cilat mund të jenë këto çështje kjo mund të jetë objekt i studime të mëtejshme nga akademia, praktikantët dhe politikëbërësit.

5.5. Kompjuterizimi i regjistrimit dhe menaxhimit të çështjeve dhe digjitalizimi i dosjeve të çështjeve dhe komunikimeve

Krijimi i sistemeve të kompjuterizuara për regjistrimin dhe ndjekjen e çështjeve është thelbësor për garantimin e menaxhimit të duhur të ngarkesës së çështjeve të çdo gjykate sepse detyrat e shpërndarjes së çështjeve, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe mbikëqyrjes së zhvillimit të procedimeve mund të kryhen brenda një kohe më të shpejtë dhe në mënyrë më ekonomike.

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve ishte një nga projektet që do të shihej me prioritet, sipas Udhërrëfyesit të efikasitetit në Gjykatën e Lartë, por që ende është në fazën e studimit se ku duhet të ndërhyhet për të përmirësuar këtë sistem. Sipas raportit vjetor, të KLGj, për vitin 2020:

“...gjatë vitit 2020, KLGJ në bashkëpunim me gjykatat ka realizuar analizën e plotë të problematikave dhe nevojat imediate që duhet të përmbushen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve. Mangësitë e raportuara nga gjykatat janë të natyrave të ndryshme dhe tashmë janë kthyer në pengesë të punës dhe veprimtarisë së tyre.Në funksion të rritjes së transparencës e cila ndikon drejtpërdrejt në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, Këshilli vlerëson emergjente nevojën për një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve.investimi për një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore është një investim afatgjatë i cili, ndër të tjera, do t'i mundësojë Këshillit ndërmarrjen e politikave gjyqësore të bazuar në të dhëna statistikore të sakta dhe të shumëllojshme, në funksion të një drejtësie pa vonesa për qytetarët.”

Sistemet kompjuterike të menaxhimit të çështjeve në gjykata duhet të prioritizohen, pasi ato janë një mjet kyç që u mundëson personelit dhe përdoruesve të kenë akses elektronik të shpejtë dhe ekonomik në informacionin mbi fazën e procedimeve dhe të realizojnë korrespondencën e nevojshme gjatë procedimeve, gjë e cila ka ulur ngarkesën e punës dhe ka shpejtuar gjykimin e çështjeve, siç tregohet në disa shembuj në vijim.

Në Slloveni, që prej vitit 2012, një sistem i ri i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave gjyqësore mundëson krijimin e paneleve që i japin mundësinë kryetarit të gjykatës dhe administratorëve të gjykatave që të kenë akses në informacion të besueshëm dhe analitik për vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e organizimit të punës.

Në Spanjë, komunikimi i digjitalizuar, ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, të sistemit gjyqësor është bërë një fenomen i përgjithshëm, i cili ka mundësuar uljen e shpenzimeve dhe vonesave, duke siguruar vërtetësinë dhe integritetin e dokumenteve të komunikuar.

Në Poloni, Kodi i Procedurës Civile u ndryshua kohët e fundit për të lejuar paraqitjen e parashtrimeve dhe dokumenteve të tjera në formë elektronike.

Që prej vitit 2009, Turqia ka vënë në funksionim sistemin kompjuterik UYAP në nivel kombëtar për menaxhimin e çështjeve dhe komunikimeve për përdoruesit. Për shembull, avokatët mund të informohen me SMS për datat e seancave.

Sipas një Udhërrëfyese të Komisionit Europian për Eficencën e Drejtësisë, të Këshillit të Evropës, "Për masat strukturore të miratuara nga disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës për përmirësimin e funksionimit të së drejtës civile dhe administrative, miratuar në 7 Dhjetor 2016⁵⁹ ka dalë në disa rezultate nga të cilat janë shkëputur ato të lidhura me zhvillimin e teknologjisë, të cilat mund të adoptohen si masa edhe në rastin tonë. Këto rezultate përmbledhen në vijim.

Teknologjia e informacionit ofron mënyra për të përshpejtuar disa veprimtari gjyqësore që tradicionalisht përfshijnë hartimin fizik të një dokumenti. Kjo zbatohet, së pari, për regjistrimet e seancave, të cilat mund të përgatiten në mënyrë më efektive dhe më gjithëpërfshirëse nëpërmjet përdorimit të kompjuterëve.

Më përgjithësisht, është e qartë se përdorimi i duhur i pajisjeve kompjuterike mundëson ruajtjen e burimeve njerëzore të nevojshme për disa veprimtari dhe si rrjedhojë, rishpërndarjen e tyre për qëllimin e duhur.

Pas kompjuterizimit të regjistrimit dhe menaxhimit të çështjeve, mund të parashikohet mundësia e krijimit të instrumentëve informatikë të cilat gjenerojnë automatikisht nga sistemi elementë të caktuar standardë të informacionit dhe formave të fjalëve, duke përdorur modele të standardizuara të vendimmarrjes: kjo ndihmon në marrjen e vendimeve me strukturë të qendrushme dhe koherente, duke kursyer kohën e hartimit dhe duke shkurtuar gabimet ortografike/të drejtshkrimit. Kjo do të ishte edhe më e dobishme nëse dosja e çështjes (duke përfshirë, për shembull, procesverbalin e seancës dhe parashtrimet e palëve) gjithashtu do të digjitalizohej: materiale të tjera që gjyqtari ndryshe do të duhet t'i kopjonte manualisht, si rrjedhojë, mund të përfshiheshin automatikisht në tekstin e vendimit. Kjo metodë pune, e cila përdoret rregullisht në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është testuar në Shërbimin e Prokurorisë së Përgjithshme të Landit të Brandenburgut (Gjermani).

5.6. Ndryshimet ligjore dhe të politikave gjyqësore

Në mënyrë që ulja e ngarkesës në Gjykatën e Lartë të realizohet sa më shpejtë të jetë e mundur, bashkëpunimi për të ndryshuar politikat dhe legjislacionin me qëllim përmirësimin e tyre është i domosdoshëm.

Nxitja e zgjidhjeve gjyqësore me pajtim dhe ndërmjetësim⁶⁰

Pajtimi dhe ndërmjetësimi janë alternativa të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve, benefitet e të cilave, për individët, kompanitë dhe administratën publike njihen gjerësisht. Gjithashtu, duke qenë se pajtimi dhe ndërmjetësimi mund të ndihmojë në zhbllokimin e sistemeve gjyqësore dhe të finalizojnë procedimet brenda një periudhe më të shkurtër, ato po promovohen ndjeshëm në vendet e KE-së.

59 <https://rm.coe.int/komisioni-europian-per-eficencen-e-drejtises-cepej-masat-strukturore-/1680748281>

60 Po aty.

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

Vendet e Bashkimit Europian kanë miratuar masa për inkurajimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me anë të ndërmjetësimit, bazuar në Direktivën e BE 2008/52/EC të datës 21 Maj 2008, mbi aspekte të caktuara në çështjet civile dhe tregtare.

Holanda ka miratuar një sërë masash për të shmangur zgjidhjen gjyqësore të mosmarrëveshjeve në një seri tipologji çështjesh. Për shembull, shoqatat e konsumatorit luajnë një rol të rëndësishëm përpara se procedimet të kalojnë në çështje ku përfshihen të drejtat e konsumatorit, sepse ato janë institucione me anëtarësi të përfshirë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në çështjet tregtare, arbitrazhi tregtar shpesh ofrohet nga organizatat e sektorit, për shembull sektori i ndërtimit. Në sektorin e sigurimeve, ekspertët teknikë (në aksidentet rrugore) janë të akredituar nga kompanitë e sigurimeve, të cilat vet i ofrojnë klientëve të tyre një ekspertizë ligjore. Avokatëve u kërkohen konsulta normalisht me qëllimin për të nisur procedimet, pasi kanë dështuar të gjitha këto mjete për të arritur një zgjidhje miqësore. Pasi procedimet janë realizuar, inkurajohet një sjellje bashkëpunuese nga palët, me ndihmën e gjyqtarëve, të cilët veprojnë edhe si vendimmarrës edhe si ndërmjetësues.

Në Mbretërinë e Bashkuar, bazuar në suksesin e projektit pilot të prezantuar në vitin 2005 në Gjykatën e Mançesterit, u themelua një Shërbim Ndërmjetësimi për Paditë e Vogla në të gjitha juridiksionet në vend. Ky shërbim i ofron palëve një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të disponueshëm përpara ose madje edhe gjatë procedimeve ligjore, i cili duket se ofron përfitime të mëdha në lidhje me kostot dhe afatet kohorë.

Në vitet e fundit, edhe Italia është përpjekur të thjeshtojë zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjeve. Nga njëra anë, cilido që mendon të ndërmarrë një veprim ligjor për të kërkuar dëmshpërblim si rezultat i një aksidenti rrugor ose ndonjë veprim tjetër ku kërkohet të paguhet një shumë deri në 50.000 EUR, duhet të ftojë palën tjetër të negociojë mbi këtë çështje me ndihmën e avokatëve të tyre respektivë. Nga ana tjetër, në seancën e parë dëgjimore dhe gjatë gjithë procedimeve, gjyqtari mund të propozojë një zgjidhje miqësore. Në Itali, përpjekja për të ndërmarrë ndërmjetësimin jashtëgjyqësor është një parakusht për sjelljen e një çështje përpara gjykatës në një gamë të gjerë çështjesh (trashëgimi, bashkëpronësi, përgjegjësi mjekësore, etj.) në të njëjtën kohë, gjatë gjithë procedimeve gjyqësore, gjyqtari ka autoritetin t'i referojë palët tek një ndërmjetësues.

Përveç përjashtimit statutor, ndërmarrja e një veprimi ligjor në Zvicër mund të bëhet vetëm pas dështimit të një përpjekje për pajtim, zakonisht të realizuar përpara gjykatës kompetente ose një gjykate tjetër të përcaktuar për këtë aspekt.

Në Rumani, gjyqtari është i detyruar të zgjidhë një mosmarrëveshje civile, me anë të një zgjidhje miqësore me ndihmën e një ndërmjetësuesi. Nëse është gjyqtari ai i cili e rekomandon ndërmjetësimin, palët (të ndihmuara nga avokatët e tyre) duhet të marrin pjesë të paktën në një takim fillestar, i cili është falas. Nëse palët arrijnë në një marrëveshje në procesin e ndërmjetësimit, kjo marrëveshje formalizohet me anë të vendimi gjykate dhe palëve mund t'iu kthehen kostot e tyre gjyqësore. Kodi i ri i Procedurës Civile ka parashikuar një kërkesë për pajtim si një parakusht për një veprim ligjor për t'u ndërmarrë ndaj një autoriteti administrativ (autoriteti duhet t'i kërkohet të tërheqë vendimin e tij brenda 30 ditëve) dhe për mosmarrëveshjet tregtare kundrejt një shume parash (pala tjetër duhet të informohet për kërkesën, duhet të paraqiten të dhënat e dokumentuara dhe duhet të kërkohet një takim

për të negociuar një marrëveshje). Shembulli i Rumanisë mund të jetë i përshtatshëm për kontekstin shqiptar, por duhet pasur parasysh se promovimi i zgjidhjeve me ndërmjetësim do të ndikojë në numrin e çështjeve në të ardhmen, por nuk zgjidh emergjencën e sotme.

Veprime të cilat mund të inkurajojnë këto metoda për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (veçanërisht në tipa të caktuara mosmarrëveshjesh) përfshijnë rritjen e sasisë së informacionit dhënë qytetarëve mbi karakteristikat dhe avantazhet e pajtimit dhe ndërmjetësimit, duke garantuar profesionalizmin e pajtuesve dhe të ndërmjetësve dhe duke parashikuar format e ndihmës financiare (në lidhje me kostot, ndihmën ligjore dhe përfitimet e taksave. Mendojmë që praktika Rumune është praktika që mund t'i përshtatet më shumë kontekstit shqiptar.

5.7. Kontroll i praktikave të autoriteteve administrative të cilët janë burimet e mosmarrëveshjeve ligjore

Ngarkesa të mëdha me çështje shpesh janë rezultat i pasigurisë që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe shtetit të së drejtës. Ato janë gjithashtu rezultat i praktikave (ose mosveprimit) të agjencive ose organizatave të caktuara (autoritete administrative, fondet e shëndetit/të pensionit, kompanitë e mëdha, etj.) të cilat me vendimarrjen e tyre prekin grupe të mëdha individësh e për pasojë janë potencial konfliktesh gjyqësore. Në këto raste, problemi duhet zgjidhur që në burim, duke penalizuar sjelljen (jo) ligjore të këtyre agjencive, duke sqaruar legjislacionin ose duke ndryshuar praktikat administrative, të cilat çojnë në mosmarrëveshje dhe në fluks padish. Shembull i këtij fenomeni janë paditë për përfitim të pensionit, ku prej vitesh një numër i madh qytetarësh i janë drejtuar gjykatave me padi për të përfituar pensionin, i cili pretendohet i llogaritur gabim nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore. Këto lloj padish në pjesën dërmuese të rasteve janë pranuar nga gjykata, duke konstatuar kështu në mënyrë të konsoliduar një sjellje të paligjshme të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Duke hequr një numër të madh të këtyre padive, të cilat me gjasa përfundojnë me rekurs, do të mund të ulej numri i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, por duke parandaluar fluksin e këtyre lloj çështjeve në të ardhmen. Këto filtrime për të vlerësuar se cilat rekurse kanë merita, mund të bëjë Avokatura e Shtetit, e cila ka kapacitete të mjaftueshme dhe mbron interesat e buxhetit të shtetit.

5.8. Masat praktike për të luftuar abuzimin me të drejtat procedurale

Së fundmi, duhen përmendur masat e ndryshme të cilat mund të prezantohen për të luftuar abuzimin me të drejtat procedurale nga pikëpamja e aksesit në një gjykatë dhe mbi të gjitha nga avokatët mbrojtës.

Me ndryshimet në kodet e procedurave, në kuadër të reformës në drejtësi, janë parashikuar vënie gjobash ndaj palës që përdor taktika dukshëm abuzive përmes dorëzimit të rekurseve abuzivë, me qëllim për të reduktuar stokun e çështjeve.

Një masë shtesë në këtë kontekst mund të ishte vendosja e sanksioneve ndaj avokatëve që abuzojnë me të drejtat procedurale, pa ngritur asnjë çështje ligjore nga ato që duhet të shqyrtojë Gjykata e Lartë, për shembull, duke listuar vetëm të njëjtat pretendime të paraqitura

në gjykatën e apelit dhe duke i ndryshuar emrin në “rekurs”. Avokatët luajnë një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve ndaj është e nevojshme të garantohet se profesionistët nuk do të abuzojnë me sistemin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave për qëllimin e vetëm për përfitime financiare. Kështu, është e rëndësishme të monitorohet pajtimi me rregullat e etikës profesionale dhe të ushtrohen penalizimet e duhura për shkeljet, të cilat kanë një ndikim të madh në administrimin e duhur të drejtësisë.

5.9. Dhënia e shpërblimeve për produktivitet

Dhënia e shpërblimeve për produktivitet, në rast të suksesit në eliminimin e çështjeve të prapambetura/të pazgjidhura është një mënyrë e konsideruar e sukseshme në vende që kanë aplikuar këtë lloj mase. Si rrjedhojë e marrjes së kësaj mase, gjyqtarët e ngarkuar me këtë detyrë do të përpunonin më shumë çështje, të motivuar nga shpërblimi.

Kjo mënyrë është promovuar dhe testuar në Slloveni, në vijim të vendimit të GJEDNJ-së, 6 tetor 2005, në çështjen *Lukenda k. Sllovenisë*, si një nga masat dhe komponentët e “Projektit Lukenda” të miratuar për të trajtuar çështjet e prapambetura / të pazgjidhura që pengojnë punën e gjykatave dhe janë burimi kryesor i konstatimeve të përsëritura të shkeljeve të kërkesës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

5.10. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë

Sipas një raport vlerësimi për sistemin gjyqësor, të hartuar me mbështetjen e Këshillit të Evropës në 2018, u vu re se në renditjen e referuar, Shqipëria mban vendin e fundit në rajon dhe disa vendeve të Këshillit të Evropës, për numër gjyqtarësh për banorë. Koncretisht për 100 mijë banorë numri i gjyqtarëve është 12.5, krahasuar me mesataren prej 25.4. Rekomandohet që ky numër në ratsin e një kërkesë kaq të madhe për shpejtim të çështjeve gjyqësore të mund të rritet duke tentuar të paktën mesataren. Ky rekomandim nuk prek drejtpërdrejt Gjykatën e Lartë, por indirekt do të ndikojë në dhënien e vendimeve në kohë më të arsyeshme.

Në rastin eventual të konsiderimit të rritjes së numrit të gjyqtarëve, kjo kërkon edhe rritjen e këshilltarëve ligjorë numri i të cilëve caktohet në proporcion me atë të gjyqtarëve. Por numri i këtyre të fundit në Gjykatën e Lartë mund të rritet edhe duke ndryshuar raportin e këshilltarëve për cdo gjyqatr nga dy në tre të tillë. Kjo nevojë raportohet edhe në raportin e Gjykatës së Lartë, 2021, sipas të cilit një këshilltar evadon rreth 25 çështje/muaj, duke e cuar në 4125 çështje në vit numrin e dosjeve të evaduara nga 15 këshillatrët ligjorë aktual.⁶¹ Në këtë kuptim numri i këshilltarve ligjorë më i madh do të ndihmonte në evadim më të shpejtë të dosjeve. Kuptohet që kjo mund të jetë një masë e përkohshme, deri në arritjen e një stabiliteti të numrit të çështjeve që gjykohen brenda një afati të arsyeshëm.

61 Raport vlerësimi i Gjykatës së Lartë, dërguar si përgjigje kërkesës për informacion të bërë nga autorët e studimit, në shtator 2021.

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

VI. MONITORIMI I UDHËRRËFYESIT

Sic e prezantuar më sipër, Udhërrëfyesi për efikasitetin në Gjykatën e Lartë 2020-2021 është dokumenti politik më i rëndësishëm në këtë aspekt, i hartuar nga KLGJ. E për këtë rëndësi që paraqet gjatë projektit, qendra Res publica bëri një vlerësim dhe monitorim të detyrave të marra përsipër sipas këtij dokumenti. Procesi i monitorimit ka vlerë më së shumti për të vlerësuar e mirëanalizuar masat e ardhshme që duhen ndërmarrë për zgjidhjen më të plotë të problemit.

Sipas Udhërrëfyesis është dakordësuar lidhur me synimet e përbashkëta për të ndërmarrë hapa të nevojshëm që gjykata të arrijë sa më shpejt “funksionalitetin optimal” brenda vitit 2020. Sipas planit të veprimit është synuar të arrihet:

- *Gjykata arrin një gjendje funksionaliteti, sa më pranë optimale të jetë e mundur;*
- *Ridhënia e aksesit në drejtësi;*
- *Vihen në zbatim metoda më efikase dhe të efektshme të përpunimit të çështjeve;*
- *Fillon ulja e konsiderueshme e numrit të çështjeve të prapambetura;*
- *Gjykata funksionale ndërmerr veprime të shpejta për të përmbushur detyrimin e saj për zgjedhjen e anëtarëve për në Gjykatën Kushtetuese.*

Për efekt të këtij studimi, monitorimi është fokusuar në një nga 5 synimet e mësipërme e konkretisht në uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë. Përpos objektivave dhe afateve të vendosura nga Këshilli dhe Gjykata e Lartë, vihet re se aktualisht realizimi i tyre nuk është i plotë. Monitorimi është kryer duke pasur parasysh disa pika të planit të përcaktuar në udhërrëfyen të tilla si:

6.1. Emërimi/Komandimi i Këshilltarëve Ligjorë, si dhe personelit administrativ mbështetës në Gjykatën e Lartë

Struktura mbështetëse pranë trupës gjyquese është shumë e rëndësishme për të ndihmuar në shqyrtimin e çështjeve të prapambetura me shpejtësi dhe efikasitet. Kështu, për të përshpejtuar emërimin e kancelarit, këshilltarëve ligjorë dhe personelit administrativ në Gjykatën e Lartë, Udhërrëfyesi parashikon në planin e veprimit:

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

- Miratimin e rregullave të brendshme standarde të nevojshme për Gjykatën e Lartë, në mënyrë që Gjykata të mund të miratojë rregulla të mëtejshme të detajuara sipas përcaktimeve ligjore, duke lejuar kështu arritjen e një numri të përshtatshëm këshilltarësh ligjorë në Gjykatë;
- Sigurimi i të gjitha akteve nënligjore që të jenë gati për të lejuar emërimin e menjëhershëm të katër këshilltarëve ligjorë që do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës (SHM) në Gusht 2020;
- Hapja e procedurave të brendshme të komandimit për numrin e përshtatshëm të ndihmës magjistratëve.

Përpos vështirësive në emërimin e nëpunësve të administratës, i rëndësishëm është trajnimi i administratës gjyqësore, me fokus të veçantë trajnimin e stafit të gjykatës: *kancelarë; kryesekretarë; sekretarë gjyqësorë dhe nëpunës gjyqësorë, me qëllim rritjen e aftësive profesionale të këtyre punonjësve.* Në këtë kuadër është planifikuar parashikimi i temave të posaçme për trajnimin e personelit, për çështje që lidhen me veprimtarinë procedurale dhe administrative në zyrat e gjykatave, etikën, marrëdhëniet me median dhe publikun. Gjithashtu është i rëndësishëm dhe përmirësimi i regjistrave për nxjerrjen e të dhënave për çështjet e zvarritura. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon marrjen e masave nga ana e kryetarëve, kancelarëve në bashkëpunim me KLGJ-në.

Për të plotësuar objektivat lidhur me emërimet në Njësinë e Shërbimit Ligjor, KLGJ ka miratuar Vendimin nr. 643 datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, nëpërmjet të cilit janë miratuar rregullat e brendshme standarde të nevojshme për Gjykatën e Lartë për arritjen e një numri të përshtatshëm këshilltarësh ligjorë në Gjykatë. Sipas kësaj rregulloreje, neni 7, përcaktohet se:

“1. Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, që përbëhet nga këshilltarë ligjorë magjistratë dhe jomagjistratë, është strukturë ndihmëse dhe këshilluese në procesin vendimarrës të Gjykatës... Numri i përgjithshëm i këshilltarëve ligjorë si dhe rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe ndërveprimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor me strukturat e tjera të Gjykatës parashikohen në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Lartë.”

Për kategoritë *Këshilltarë Ligjorë të Komanduar* (ndihmësmagjistratë) dhe *Këshilltarë Ligjorë të Emëruar* (magjistratë), ligji nr 96/2016, “Për statusin e gjyqtarit” parashikon se numri i tyre përcaktohet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve dhe referuar Udhëzuesit të KLGJ-së, Gjykata e Lartë momentalisht aplikon raportin 2 me 1 të këshilltarëve ligjorë me gjyqtarët, por në çdo rast, sipas ligjit, numri i ndihmësmagjistratëve të komanduar duhet të jetë më shumë se gjysma e numrit total të këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor. Referuar strukturës, organikës dhe klasifikimit të vendeve të punës të personelit të Gjykatës së Lartë⁶², numri total i personelit të Njesisë të Shërbimit Ligjor të planifikuar është 34.

Sipas një përgjigje të KLGJ, në 15 Shkurt 2021 pas miratimit të këtyre rregullave standarde, Këshilli po procedon me përshtatjen e strukturës aktuale, sipas rregullave të reja të organizimit të brendshëm, si dhe me plotësimin e vakancave të krijuara në administratë me qëllim kryerjen me efektivitet të funksioneve ligjore. Pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

të dhënave deri në shkurt 2021, ushtrojnë detyrën 16 këshilltarë, nga të cilët 6 janë ndihmës magjistratë dhe 10 janë magjistratë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në Shtator 2020, ku 4 prej tyre kanë emërim të përkohshëm. Kështu, numri i këshilltarëve ligjorë, i cili sipas Udhërrëfyesit pritej të ishte 20, në fund të vitit 2020, në shkurt 2021 është 16, duke mos u siguruar as numri i nevojshëm i këshilltarëve/për gjyqtar, sipas raportit dy me një.

Ndërsa lidhur me emërimet e përkohshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përdorur këtë mekanizëm për të zhbllokuar procesin e emërimit dhe për të lejuar vazhdimin e punës në Gjykatën e Lartë. Megjithatë, një mekanizëm i tillë, përpos faktit që mund të ndihmojë për momentin në zgjidhjen e këtij ngërçi, nuk jep siguri të plotë se këta këshilltarë do të mund të emërohen me status të përhershëm në fund të procesit të verifikimit. Nëse një situatë e tillë do të ndodhte, kjo do të ishte kthim me hapa pas në gjendjen fillestare dhe në humbje kohe dhe energjie të shkuar dëm në drejtim të burimeve njerëzore.

6.2. Emërimi/Komandimi i Kancelarit të Përhershëm të Gjykatës së Lartë

Kancelari është një figurë kyçe në administrimin e gjykatës, e parë kjo edhe në kontekstin e ri të administrimit kolegjal të gjykatave, ku kancelari është pjesë vendimmarrëse e rëndësishme në Këshillin e Gjykatës së Lartë. Për shkak të kësaj rëndësie, Këshilli shprehet se aktualisht, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, po vlerëson përcaktimin e numrit të kancelarëve që do duhet të ndjekin programin formues pranë kësaj shkolle.

Në udhërrëfyes afati i parashikuar për konfirmimin e kancelarëve është Shkurt 2021. Lidhur me këtë angazhim, KLGJ fillimisht ka miratuar Vendimin nr. 424 datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” dhe pak ditë më vonë, Vendimin nr. 496, datë 21.10.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, i cili shënon fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë. Miratimi i këtyre akteve ndihmon procesin e rekrutimit të jetë i hapur dhe transparent. Pas miratimit të këtyre akteve do të krijohet mundësia për nisjen e procedurës për emërimin e përhershëm dhe të Kancelarit në Gjykatën e Lartë, sipas KLGJ.

Deri në Shkurt 2021, sipas një shkrese zyrtare të KLGJ, nuk ka përfunduar procedura e emërimit të Kancelarit të Përhershëm të Gjykatës së Lartë. KLGJ, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, po vlerëson përcaktimin e numrit të kancelarëve që do të duhet të ndjekin programin formues pranë kësaj shkolle.

Me sa duket KLGJ është ende larg plotësimit të këtij objekti, ku jo vetëm nuk është realizuar sipas planifikimit, por nuk dihet ende sa kohë do të duhet për t’u plotësuar ky pozicion. Një ndër problemet që ka ndikuar është vonesa në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar nga insitucionet e tjera për verifikimin e të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës.

6.3. Qendra e Dokumentacionit si personel administrativ mbështetës

Synimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas Udhërrëfyesit është gjithashtu dhe ngritja e kësaj Qendre në brendësi të Gjykatës së Lartë dhe bërjen e saj funksionale nëpërmjet rekrutimit

të personelit përgjegjës. Sipas objektivave⁶³, numri i nevojshëm i shpallur për kërkues ligjorë është 10. Me Vendimin nr. 338 datë 24.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mundur të miratojë aktin nënligjor “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, që hap rrugën e punësimit të personelit administrativ mbështetës. Megjithatë një ndër problemet e evidentuara që mund të pengonte këtë proces, përpos miratimit të vendimit, është sigurimi i burimeve financiare për rekrutimin e personelit të kualifikuar.

Sipas parashikimeve, brenda vitit 2020 stafi duhet të fillonte punën, por ndonëse Qendra e Dokumentacionit është krijuar, sipas informacionit të ardhur Res Publica, nga Gjykata e Lartë⁶⁴ në përbërjen e saj janë 2 punonjës dhe funksionaliteti i kësaj strukture nuk është akoma i plotë.

6.4. Emërimi dhe ngritja në detyrë e Gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë

Sipas planit strategjik të Këshillit (fq.15 e Udhërrëfyesit për Funksionalitetin e Gjykatës së Lartë) brenda 5 Dhjetorit 2020 pritej të ishin emëruar 10 gjyqtarë, ku për njërin prej tyre nga të cilët pritej përfundimi i procesit të emërimit të katërt nga radhët e jo magjistartëve, në Shtator 2020.

Kështu, Këshilli u zotua gjithashtu të ndërmernte të gjitha hapat për të adresuar pengesat lidhur me procesin e emërimit/ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Ky afat u shty në Korrik 2021, kur pritej të emërohesin edhe tre gjyqtarë të tjerë në Gjykatën e Lartë.

Momentalisht në Gjykatën e Lartë janë emëruar 9 gjyqtarë.

Ngadalësimi i procesit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, siç e trajtuam më sipër, raportohet të jetë për shkak të *vetingut, mungesës së interesit për të kandiduar, gjendjes në të cilën ndodhet vendi si pasojë e pandemisë COVID-19.*

Lidhur me procesin e emërimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë, KLGJ në një shkresë zyrtare është përgjigjur se pas procesit për emërimin e gjyqtarëve që vijnë nga rradhët e juristëve të spikatur për 4 pozicione vakante, proces i cili përfundoi me dekretimin e emërimit të 3 gjyqtarëve. Me Vendimin nr. 560, dt. 13.11.2020, KLGJ ka kualifikuar edhe kandidatin e katërt jogjyqtar dhe është në përfundim të procesit të vlerësimit të këtij kandidati. Kjo përgjigje është dhënë në datën 15 Shkurt 2021, dhe nuk kemi informacion më të vonë lidhur me këtë detaj.

Ndërkohë Këshilli hapi procedurat për 6 pozicione të lira, në datën 26.02.2020 dhe për 5 pozicione të lira, në datën 09.07.2020.

Për 11 pozicionet kandiduan 23 kandidatë, shumica e të cilëve aplikuan për disa nga pozicionet e lira. Nga këta kandidatë:

63 Fq. 17 e Udhërrëfyesit për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë
64 <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2021/01/1773.pdf>

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

- Dy u tërhoqën gjatë kandidimit;
- 16 janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe për ta Këshilli ka përmbyllur fazën e verifikimit të kriterëve ligjore, duke vendosur kualifikimin e tyre;
- Një kandidat është konfirmuar së fundi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit por vendimi i tij nuk është arsyetuar ende dhe për rrjedhojë nuk ka marrë formë të prerë;
- Ndërsa për 4 kandidatë ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Një nga objektivat e Udhërrëfyesit lidhur me evidentimin e shkaqeve që pengojnë kandidimet në pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë ishte edhe realizimi i një anketimi për të përcaktuar faktorët nxitës ose pengues që përkrahin/inkurajojnë, apo dekurajojnë gjyqtarët të kandidojnë për ngritjen në detyrë në rrethanat aktuale dhe të ardhshme.

Në përgjigje të kërkesës për informacion drejtuar nga Res Publica, lidhur me realizimin e këtij angazhimi, KLGJ në përgjigjen e vet nuk bën veçse një konstatim fakti tashmë të njohur lidhur me procesin e hapjes së thirrjeve për pozicionet vakante në instancat gjyqësore dhe hezitimin e gjyqtarëve për shkak të efekteve psikologjike të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe vonesat në verifikimin e kandidatëve.

Por, Këshilli nuk jep informacione lidhur me anketimin, mënyrën e realizimit të tij, metodologjinë e përzgjedhur të anketimit apo mënyrën e përpunimit të të dhënave të grumbulluara.

6.5. Kohëzgjatja e procesit të vetingut

Një ndër problemet në procesin e emërimit të gjyqtarëve është dhe vetingu. Sipas Udhërrëfyesit, arritja e një marrëveshje jo/institucionale (mirëkuptimi) me organet e vetingut, lidhur me prioritizimin e listës së kandidatëve në procesin e emërimit/ngritjes në detyrë do të ishte e nevojshme për shpejtimin e procesit. Lidhur me këtë, Këshilli propozon mekanizmin zhbllokues që lejon gjyqtarët e pavetuar të ngrihen në detyrë, përmes një verifikimi të brendshëm nga KLGJ, kur organet e vetingut nuk e finalizojnë vetingun e kandidatëve brenda një afati 3 mujor. Por ky mekanizëm rrezikon në anën tjetër cenimin e reputacionit të Këshillit dhe legjitimitetin e gjykatës.

Megjithatë përsëri procesi i ngritjes në detyrë paraqet vonesa. KLGJ shprehet në përgjigjen e saj lidhur me pengesat që kanë ndikuar në ngadalësimin e emërimit/ngritjes në detyrë të tilla si: *ndërvarësia me procesin e rivlerësimit kalimtar/ respektimin e të drejtave të kandidatëve në proces, gjendja e shkaktuar nga pandemia globale COVID-19 dhe skema e re e vlerësimit të gjyqtarëve* e miratuar nga vetë KLGJ, e cila sigurisht kërkon kohën e vet për t'u realizuar.

Pra, Këshilli, në mënyrë të tërthortë ka ndikuar në vonesat e ngritjes në detyrë/emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

6.6. Përmirësimi i Metodave dhe Proceseve të Punës

Një nga angazhimet në kuadër të Udhërrëfyesit është edhe përmirësimi i Metodave dhe Proceseve të Punës, pasi metodat aktuale manuale dhe elektronike të punës së Gjykatës nuk mbështesin përpunimin e efektshëm të çështjeve si dhe krijimi i Komisionit të Posacëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura.

Kështu, një ndër problemet e evidentuara është dhe sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve (ICMIS), e cila paraqet një sërë mangësish të tilla si:

- *ICMIS nuk ofron informacion të mjaftueshëm që gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë të vlerësojnë dhe kategorizojnë çështjet e reja të depozituara;*
- *ICMIS nuk siguron informacion të mjaftueshëm për analizën statistikore të ngarkesës me çështje duke krijuar kështu nevojën që Zyra e Regjistrimit të shpenzojë kohë shtesë për mbledhjen manuale të këtyre të dhënave;*
- *ICMIS nuk u lejon gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të kenë akses në versionet elektronike të vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke bërë që ata të shpenzojnë kohë të konsiderueshme për hedhjen sërish të këtyre vendimeve në vendimet e tyre.*
- *ICMIS kërkon që të ndërmerren hapa që kërkojnë kohë lidhur me hedhjen në sistem të vendimeve gjyqësore dhe mendimet e pakicës;*
- *ICMIS nuk ofron një bazë të dhënash që bën të mundur kërkimin e efektshëm të praktikës aktuale gjyqësore të Gjykatës së Lartë, gjë që e bën kërkimin ligjor të marrë më shumë kohë dhe punë intensive. Ndërkohë që krijimi dhe zbatimi i një sistemi të përmirësuar elektronik të menaxhimit të çështjeve për të gjithë sistemin gjyqësor aktualisht nuk mund të arrihet, ne po punojmë në mënyrë aktive me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID-it dhe me EURALIUS.*

Për këtë, Këshilli është angazhuar në kuadër të Projektit “Drejtësi për të Gjithë” të mbështetur nga USAID, që edhe me asistencën e EURALIUS V, të adresojë problematikat e sistemit elektronik ICMIS në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, sipas Udhërrëfyesit, KLGJ është në pritje të burimeve të tjera të ndërmjetme (EURALIUS do të vendoste në dispozicion një qendër të dhënash të vendimeve të gjykatave më të ulëta) në ndihmë të përmirësimit të sistemit aktual ICMIS. Lidhur me këtë pikë të planveprimtaria KLGJ ka miratuar Vendimin nr. 317, datë 19.12.2019, “Për krijimin e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë” veprimtaria e të cilit është zgjeruar dhe është zgjatur me vendimin nr. 155, datë 15.05.2020. Objekti i veprimtarisë të këtij komisioni është edhe mbikqyrja dhe zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga KLGJ dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, më 29 Prill 2020 dhe afati është zgjatur pa afat dhe deri sa të jetë në fuqi Memorandumi i Mirëkuptimit.

6.7. Sigurimi i burimeve financiare⁶⁵

Sigurimi i burimeve financiare është shumë i rëndësishëm në mënyrë që Gjykata e Lartë të sigurojë rikonstruktionet ndërtimore, metodat e duhura elektronike të menaxhimit të

⁶⁵ “Raporti i monitorimeve për periudhën janar- prill” dhe “Udhërrëfyesi mbi funksionalitetin e Gjykatës së Lartë”

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

çështjeve, rekrutimin dhe plotësimin e vendeve vakante në administrimin e gjykatës (kjo problematikë e fundit është evidentuar dhe më sipër).

Referuar Programit të Transparencës së Gjykatës së Lartë⁶⁶, buxheti i vitit 2020 i miratuar ishte 155,553,000 lekë dhe shpenzimet faktike janë 122,946,393 lekë (79%), ndërkohë në vitin 2021, bazuar dhe në raportin e monitorimeve për periudhën janar – prill 2021⁶⁷ i publikuar nga KLGJ, realizimi i planit të shpenzimeve në këtë periudhë për zërin e shpenzimeve të personelit sipas monitorimit është vetëm 63.8 % për shkak të *mungesave në strukturat e sistemit gjyqësor, situatës së vështirë e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19*, i cili ka kushtëzuar aktivitetin e sistemit gjyqësor. Duket se nga njëra anë raportohet se vështirësitë në rekrutimin e stafit mbështetës vijnë nga mungesa e financave, sipas raportimit, financat janë, por nuk shpenzohen për shkak të mungesës së strukturave.

Ndërkohë, për rikonstrukcione ndërtimore, në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës të Gjykatës së Lartë është alokuar fondi prej 18,650,000 lekë për ndërtimin e dhomës së serverit. Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është 5%, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 8%.

Gjithashtu, financat janë të domosdoshme për të bërë të mundur modifikimet në sistemin ICMIS, e cila konsiderohet si thembra e Akilit në sistemin aktual gjyqësor. Referuar “Raportit të monitorimeve të periudhës janar-prill 2021”⁶⁸, vihet re se buxheti vjetor për shpenzimet kapitale të trupëzuara është në total 178.000 lekë dhe veçanërisht për periudhën janar-prill është 140,140 mijë lekë ku konkretisht është alokuar për zërin “Studime dhe projekte”, fondi prej 63,500 mijë lekë, për blerje patenta, licenca, software (ICMIS). Në raport theksohet se ky fond është parashikuar veçanërisht për *fillimin e ndërtimit të sistemit të ri elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore*. Ndërtimi i një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas një studimi të ekspertëve të EURALIUS, arrin në vlerën prej 3.6 milion Euro. Ky fond është mbajtur i pa detajuar sipas objektit dhe do të jetë Këshilli që do të vendosë për realizimin e tij, sipas zhvillimit të situatës. Për periudhën raportuese ky projekt nuk është realizuar.⁶⁹ Kështu, realizimi i treguesit për periudhën raportuese është 20%, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 21%.

6.8. Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura

Pjesë e planit të veprimeve të parashikuara në Udhërrëfyës është edhe angazhimi i KLGJ për të vënë në efencë dhe monitoruar Memorandumin e Mirëkuptimit.

Për këtë qëllim KLGJ ka krijuar Komisionin e Përkohshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Objekti i veprimtarisë së këtij komisioni, ndër të tjera, është edhe mbikëqyrja

66 http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Informacion_mbi_buxhetin_dhe_te_dhenat_financiare_te_Gjykates_se_Larte_4061_1-10.php

67 <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/06/RAPORTI-I-MONITORIMEVE-PE%CC%88R-PERIUDHE%CC%88N-JANAR-%E2%80%93-PRILL-2021-.pdf>

68 fq5-8 e <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/06/RAPORTI-I-MONITORIMEVE-PE%CC%88R-PERIUDHE%CC%88N-JANAR-%E2%80%93-PRILL-2021-.pdf>

69 fq.15 e “Raporti i monitorimeve për periudhën janar - prill 2021”

RES PUBLICA - NJËZET E TETË REKOMANDIME

dhe zbatimimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, më 29 Prill 2020. Referuar raportit vjetor të KLGJ 2020, nuk evidentohen veprimtari apo arritje të vecanta të këtij Komisioni.

Ndër kontributet më të rëndësishme që Memorandumi ofron në zgjidhjen e situatës së krijuar në Gjykatën e Lartë, është rekrutimi i një stafi mbështetës juristësh të cilët do të ndihmojnë administratën e kësaj gjykate për të trajtuar me shpejtësi çështjet e stokut të mbetura në gjykatë, përmes ngritjes së një ekipi Nëpunësish për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP).

Krijimi i Ekipit për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura prej 12 juristësh të përgatitur synonte të ndihmonte në procesin e filtrimit të çështjeve që nuk kalojnë testin e pranueshmërisë.

Në praktikë, 12 Nëpunësit për Uljen e Numrit të Çështjeve, pas përzgjedhjes së tyre, kanë nisur punën dhe janë trajnuar nga Këshilltarët ligjorë lidhur me aspektet e punës, sipas një përgjigje që Gjykata e Lartë i ka kthyer qendrës Res Publica. Vihet re, nga seancat e shpallura për gjykim⁷⁰, se hartimi i planit të veprimit dhe standardet e performancës⁷¹ për secilën kategori/nënkategori çështjesh, për të cilën afati i parashikuar ishte deri në Gusht të vitit 2020, është vendosur në zbatim.

Efektet e punës së ekipit në fund të vitit 2020 u demonstruan në inventarizimin e 22, 995 çështjeve (66% e të gjithë volumit të çështjeve në gjykatë), ku secila prej tyre është rishikuar fizikisht, është filtruar sipas 42 pikave të veçanta të të dhënave dhe është regjistruar në databazë.⁷² Nëpërmjet këtyre të dhënave, Gjykata ka krijuar plane individuale për veprim, për çështjet penale, civile dhe administrative, të cilat do t'i japin një efikasitet në rritje veprimtarisë së saj gjyqësore.

6.9. Metodologjia e punës për administrimin e dosjeve gjyqësore të prapambetura

Përcaktimi i metodologjisë për administrimin e dosjeve gjyqësore të prapambetura është një tjetër synim i përcaktuar në planin e punës sipas Udhërrëfyesit. Referuar përgjigjes së kthyer, kërkesës për informacion të qendrës Res Publica, nga Gjykata e Lartë, lidhur me metodologjinë e punës që po ndiqet nga gjykata për çështjet e prapambetura, ajo shprehet se në trajtimin e dosjeve po ndjek dy parime: atë kronologjik dhe atë prioritar. Me parimin kronologjik kuptohet gjykimi i çështjeve më të vjetra, ndërsa sipas parimit prioritar do të gjykohen më shpejt çështjet prioritare që ligji dikton nevojën të shqyrtohem më shpejt, si për shembull çështjet e juridiksionit, ekstradimeve, kompetencës, apo konfliktit mes gjykatave.

Gjithashtu është synuar të identifikohen çështjet që kanë një natyrë, për të cilat mbahet një qëndrim i unifikuar në interpretim të ligjit, duke u mundësuar gjyqtarëve të japin zgjidhje të

70 Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/Ceshtje_te_Shpallura_per_Gjykim_849_1.php

71 Udhërrëfyesi i KLGJ-së, fq 19

72 http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Deklarate_per_Median_e_Zevendes_Kryetarit_te_Gjykatës_se_Larte_Z_Sokol_Sadushi_8027_1.php

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

shpejta shumë çështjeve që kanë natyrë të njëjtë, brenda një dite, duke specifikuar natyrën e tyre. Kjo reflektohet në marrjen e vendimeve brenda një dite. Për shembull nga një përzgjedhje e rastësishme është vënë re se në datën 14 Prill 2021, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar çështje civile të lidhura kryesisht me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe çështje të lidhura me zgjidhjen e kontratës së punës. Po kështu, në datën 19 Prill 2021 janë shqyrtuar kryesisht çështje me palë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Institutin e Sigurimeve Shoqërore apo Drejtorinë e Policisë.

6.10. Kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi.

Shqyrtimi i çështjeve në dhomat e këshillimit pritet të kenë shpejtësi dhe efikasitet. Megjithatë, shqyrtimi i këtyre çështjeve, edhe kur kanë të njëjtën natyrë, kërkon shpenzimin e një kohe të arsyeshme nga ana e gjykatës. Për të vlerësuar shpenzimin e kësaj kohe të gjykatës në këto çështje, në tabelat në vijim kemi marrë në shqyrtim çështjet e gjykuara në dhomë këshillimi të një muaji. Rezultatet jepen në tabela si më poshtë:

Fig. 2 - Çështjet civile të gjykuara në dhomë këshillimi në Prill 2021

| Prill 2021 | Cështje civile në dhomë këshillimi |
|------------|---|
| 1 prill | 22 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |
| 7 prill | 5 çështje, nga ora 10.00 - 11.00, kohëzgjatja nuk është publikuar |
| 14 prill | 10 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |
| 15 prill | 77 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |
| 21 prill | 19 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |
| 28 prill | 13 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |
| 29 prill | 16 çështje pa publikuar orar dhe kohëzgjatje |

Fig. 3 - Çështjet administrative të gjykuara në dhomë këshillimi në Prill 2021

| Prill 2021 | Cështje administrative në dhomë këshillimi |
|------------|--|
| 19 prill | 20 çështje, nga të cilat 15 me kohëzgjatje 10 min, pjesa tjetër nuk publikohet |
| 20 prill | 46 çështje, nga të cilat 28 me kohëzgjatje 15 min, pjesa tjetër 10 min |

Një problematikë që u evidentua fillimisht gjatë periudhës së monitorimit ishte dhe mospublikimi i orareve dhe kohëzgjatjes për një pjesë të madhe të çështjeve. Ky problem rezulton i zgjidhur sot, nga një vëzhgim i bërë nga Res Publica gjatë muajit Shtator 2021.

Përveç kësaj, lidhur me çështjet penale, në faqën e Gjykatës së Lartë nuk gjenden të publikuara dhe nuk është bërë transparent asnjë plan lidhur me çështjet që do të shqyrtoheshin në muaj përpara qershorit. Kujtojmë se një ndër synimet e KLGJ-së për rritjen e transparencës dhe besimit të publikut është dhe informimi i publikut për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe veprimtarive të tjera që lidhen me efikasitetin e gjykatës. Gjithashtu referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 482 i tij, përcakton detyrimin e publikimit të ditës, orës dhe përbërjen e trupit gjykues që merr në shqyrtim listën e rekurseve në Dhomë Këshillimi të paktën 15 ditë para datës së shqyrtimit jo vetëm me shpallje në ambjentet e Gjykatës së Lartë, njoftim individual, por edhe në faqen e internetit.

6.11. Ndryshimet ligjore

Udhërrëfytyesi, ndër të tjera, ka përcaktuar si objektiv edhe ndryshimet e domosdoshme që duhet të kryhen nga legjislatori lidhur me kodet e procedurës dhe ligjet në fuqi. Problematikat e identifikuara synimet janë: hartimi dhe dorëzimi në Ministrinë e Drejtësisë të ndryshimeve ligjore për Kodet e Procedurës Administrative, Civile dhe Penale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përbërjes dhe kompetencave të kolegjeve, duke pranuar ndryshimin në rolin e Gjykatës në kuadër të reformës në drejtësi.

Këto ndryshime kaluan në Kuvend, në Mars 2021 dhe hynë në fuqi në Qershor 2021. Kështu ky synim mund të konsiderohet i plotësuar edhe pse këto ndryshime janë të kritikueshme mbi të gjitha për procedurën e ndjekur në kundërshtim me kushtetutën, që solli si pasojë edhe mangësi dhe zgjidhje fragmentare të problematikës. Sipas KLGJ në një shkresë drejtuar qendrës Res Publica, Ministria e Drejtësisë ka filluar iniciativën për nismat ligjore përkatëse, por më pas ka rezultuar që këto nisma janë trajtuar si nisma të deputetëve, duke shmangur të gjithë procesin dhe konsultimet që ndjek një projektligj i inicuar nga Qeveria. Qëllimi i kësaj zgjedhje duket se është nxitimi për të plotësuar një objektiv para mbarimit të mandatit (para zgjedhjeve të 25 Prillit 2021), por kjo sjellje nuk është e justifikuar në rastin e propozimeve të ndryshimeve të ligjeve kaq të rëndësishme, për të cilët pati reagim nga 64 organizata të shoqërisë civile.⁷³

73 <https://isp.com.al/index.php/2021/03/24/votimi-i-10-ligjeve-nga-kuvendi-pa-transparence-pa-konsultim-pa-respekt-per-procedurat-dhe-nje-mesazh-negativ-per-integritetin-e-aktivitetit-parlamentar-dhe-reformes-ne-drejttesi/>

VII. PËRMBLEDHJE SINTETIKE E REKOMANDIMEVE

Më sipër u dhanë rekomandime gjatë gjithë materialit, sipas aspekteve të ndryshëm të trajtuar, bazuar mbi praktika të mira ndërkombëtare. Për lehtësinë e lexuesit, në vijim po paraqesim një listë të përmbledhur të rekomandimeve, duke i ndarë ato sipas llojit.

A. Ndryshimet ligjore

1

Pranueshmëria e rekursit të gjykohet nga një gjyqtar i vetëm

Gjykimi me një gjyqtar të vetëm është mekanizëm që përdoret nga GJEDNJ dhe kjo ka sjellë efekt përmirësues në aftësinë filtruese të vetë GJEDNJ. Gjyqtari i vetëm, kompetent për refuzimin e kërkesave të papranueshme, lehtësoi barrën e çështjeve. Vetëm në raste të caktuara, kur gjyqtari i vetëm vlerëson çështjen komplekse, ai mund të thërrasë një panel prej tre gjyqtarësh. Aktualisht, shumica dërrmuese (87%) e kërkesave pranë GJEDNJ shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm.

Në Shqipëri rezulton se rreth 80% e çështjeve të depozituara në Gjykatën e Lartë nuk e kalojnë testin e pranueshmërisë. Duke angazhuar “gjyqtarin e vetëm” mund të eliminohet më shpejt kjo kategori e çështjeve të prapambetura, të cilat janë 4/5 e totalit të çështjeve.

Vërtet natyra kolegjiale e vendimmarrjes përbën një mjet shtesë të garantimit të paanshmërisë së gjykatësve dhe gjykimi me një gjyqtar teorikisht nuk ofron garanci optimale, por vendimi për mospranimin e një rekursi nuk është në thelb një gjykim, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim nëse çështja pranohet për t’u gjykuar apo jo. Garancitë për këtë lloj vendimarrje sigurohen nga vet statusi dhe eksperiencia e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Përfitimet janë të sigurta në adresimin e problematikës së uljes në masë të një numri të madh çështjesh që pret të gjykohet. Ngarkesa e çdo gjyqtari do të binte automatikisht. Një parashikim i tillë në kodet e procedurës dhe ligjit për gjykimet administrative mund të jetë ishte edhe një ndryshim tranzitor, deri në normalizimin e situatës post reformë.

2

Të krijohet një sistem për “gjkimet pilot”

Shpesh rekursat trajtojnë çështje që janë shqyrtuar më herët nga Gjykata e Lartë dhe për të cilat ka jurisprudencë të konsoliduar. Për këtë situatë, GEDNJ në vitin 2011 përfshiu instrumentin e “gjkimit pilot”, ku shqyrtohet me përparësi një recurs që adreson një problem strukturor ose sistematik në kuadrin ligjor të brendshëm, një problem që rezulton të jetë objekt i rekurseve të shumta, që rrisin numrin e çështjeve të prapambetura. Përmes “gjkimit pilot” Gjykata e Lartë mund të japë urdhërime detyruese për gjykatat e shkallëve të tjera, lidhur me masat që duhet të ndërmerren, nga të cilat mund të përfitojnë edhe palët e tjera që kanë paraqitur rekurse të ngjashme.

3

Të rritet numri i gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjore

Sipas një renditje të bërë, Shqipëria mban vendin e fundit në rajon dhe disa vendeve të Këshillit të Evropës, për numrin e gjyqtarëve për banorë. Konkretisht për 100 mijë banorë numri i gjyqtarëve është 12.5, krahasuar me mesataren e vendeve të tjera prej 25,4. Rekomandohet që ky numër në kushtet e një kërkesë kaq të madhe për shpejtimin e çështjeve gjyqësore të mund të rritet duke tentuar të paktën të arrijë mesataren.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të njëjive mbështetëse në funksion të rritjes së efikasitetit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, rekomandohet edhe rritja e numrit të këshilltarëve nga dy këshilltarë në tre të tillë për çdo gjyqtar, duke ndihmuar evadimin më të shpejtë të dosjeve.

4

Të përforcohen kriteret e pranueshmërisë, duke mos pranuar rekursat për çështje që nuk paraqesin “disavantazhe të rëndësishme”

Rekomandohet që të miratohen kriteret e reja, më të forta, të pranueshmërisë së çështjeve për shqyrtim. Në rastet kur pala që ka paraqitur recurs nuk vërteton se pëson një “disavantazh të rëndësishëm” si rezultat i shkeljes së pretenduar, rekursat të deklarohen të papranueshme.

5

Sistemi ligjor të inkurajojë zgjidhjet me pajtim ose me ndërmjetësim

Meqenëse mbingarkesa e Gjykatës së Lartë buron nga një numër i përgjithshëm i lartë i konflikteve gjyqësore që në shkallë të parë, nevojitet të konsiderohen mekanizmat e zgjidhjeve me pajtim me ndihmën e një ndërmjetësuesi. Krahas ndryshimeve ligjore në ligjin për ndërmjetësimin të eksplorojnë mundësi të tjera, që paditë të vecanta ta kenë si parakusht hapjen

e një procesi gjyqësor pas një përpjekje për zgjidhje me ndërmjetësim. Kjo mund të kërkojë ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Civile, duke u kujdesur për të ruajtur balancën midis ekonomizimit të procedurave gjyqësore dhe aksesit në gjykatë. Shembulli i Rumanisë, i trajtuar më lart, mund të jetë i përshtatshëm për kontekstin shqiptar, pavarësisht se kjo masë do të ndikojë në numrin e çështjeve në të ardhmen dhe jo për emergjencën e sotme.

6

Sistemi ligjor të inkurajojë zgjidhjet e konflikteve me arbitrazh

Mbingarkesa e Gjykatës së Lartë buron nga një numër i përgjithshëm i lartë i konflikteve gjyqësore që në gjykimet në shkallë të pare. Për këtë arsye nevojitet të konsiderohet incentivimi i përdorimit të mekanizmave alternativë të zgjidhjes së konflikteve përmes gjykatave të arbitrazhit. Kodi i Procedurës Civile parashikon këtë mënyrë të zgjidhjes së konflikteve, por kjo duhet të shoqërohet me gjetjen e mënyrave të tjera nxitëse për krijimin e këtyre gjykatave në bashkëpunim me dhomat e tregtisë, ose të tjerë aktorë të mundshëm.

B. Masat që mund të merren nga qeveria

7

Të merren masa për vlerësimin e rekurseve të dorëzuara nga autoritetet shtetërore dhe nga Avokatura e Shtetit, me qëllim për të filtruar rekursat që nuk kanë shance fitoreje

Autoritetet dhe shoqëritë shtetërore paraqesin një sasi të madhe rekursesh, qoftë edhe për shkak të detyrimit që kanë juristët e këtyre autoriteteve që të ndjekin të gjitha shkallët e gjykimet. Shpesh rekursat nuk kanë merita. Është e nevojshme që Avokatura e Shtetit, e cila ka kapacitet të mjaftueshme për të analizuar cilësinë e këtyre rekurseve, të heqë një numër të madh rekursesh nga barra e Gjykatës së Lartë. Kjo veprimtari mund të urdhërohet nga qeveria, duke lënë ato rekurse që kanë shance për t'u trajtuar nga Gjykata e Lartë dhe synojnë vërtet të mbrojnë interesat e shtetit.

8

Masat legislative, por kur është e mundur edhe masat e tjera, të konsultohen me shoqërinë civile

Është e nevojshme që shoqëria civile të ftohet vazhdimisht të konsultohet për masat që mendohen të merren. Konsultimi është një hap i detyrueshëm në rastin e ndryshimeve ligjore, por çmohet i nevojshëm edhe për masat e tjera administrative. Një nga problemet e reformës në drejtësi ishte moskonsultimi i shumë faktorëve në kohën e duhur, duke prodhuar një sistem që solli shumë efekte anësore të pamenduara. Staf i ekspertëve të angazhuar për reformën në drejtësi shpesh ishte akademik, pa lidhje direkte me terrenin. Shoqëria civile është më afër terrenit, si dhe Dhoma e Avokatisë, e cila mund të luajë një rol domethënës në këtë fazë.

C. Masat që mund të merren nga KLGJ

9

Të rishikohen kriteret e përzgjedhjes së NUNÇP

Përzgjedhja e aplikuesve për NUNÇP që kanë një eksperiencë shumëvjeçare profesionale, duhet të prioritizohet në procesin e rekrutimit të tyre. Kandidatët me mbi 6 vjet eksperiencë pune nuk duhet të përjashtohen nga mundësia e konkurimit. Kriteri preferencial i eksperiencës në mësimdhënie nuk paraqet relevancë për përshkrimin e detyrave të pozicionit të punës. Vendosja e kriterëve duhet të jetë e mirëanalizuar, të mos jenë thjesht formale dhe t'i përgjigjen qëllimit për të cilin vendosen. Përveç NUNÇP, plotësimi me numrin e duhur të stafit mbështetës duhet të përshtatet dhe të jetë më fleksibël, si në kriteret, ashtu edhe në nxitje të formave të ndryshme.

10

Të merren masat për trajnimin vazhdues të NUNÇP

Duke pasur parasysh eksperiencën e pakët të NUNÇP përballë detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara, nevojitet që të shtohen garancitë duke kompensuar përgatitjen e tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme të këtij stafi.

11

Masat duhet të shoqërohen me ngritjen dhe funksionimin e një sistemi monitorimi dhe publikim i vazhdueshëm i statistikave

Duke njohur nevojën që të gjitha masat e rekomanduara më sipër, duhet të shoqërohen me futjen e një sistemi monitorimi, KLGJ tashmë ka vendosur për ngritjen e një sistemi të tillë. Funksionimi i tij mbetet për t'u parë se si do të vijojë në praktikë. Res Publica sugjeron që një sistem i tillë të jetë i aftë për të siguruar të dhëna statistikore të përditësuara dhe të besueshme për numrin e kërkesave, apelimeve dhe rekurseve të paraqitura, të përpunuar dhe në pritje para gjykatave, si dhe për kohëzgjatjen e tyre mesatare. Sistemi mund të ndërtohet në një mënyrë të tillë që të mbledhë informacione edhe për aspekte të tjera të procesit, si numri i masave të sigurimit të padisë, vendimet me ekzekutim të përkohshëm, etj.

12

Të përmirësohet sistemi i menaxhimit të çështjeve, duke kompiuterizuar regjistrimet dhe veprimet e tjera

Krijimi i sistemeve të kompjuterizuara për regjistrimin dhe ndjekjen e çështjeve është thelbësor për garantimin e menaxhimit të duhur të ngarkesës së çështjeve të çdo gjykate. Sistemet

PËR PËRSHPEJTIIMIN E EVADIMIT TË DOSJEVE NGA GJYKATA E LARTË

kompjuterike të menaxhimit të çështjeve duhet të prioritetizohen, pasi ato janë një mjet kyç që u mundëson personelit dhe përdoruesve të kenë akses elektronik të shpejtë dhe ekonomik në informacionin mbi fazën e procedimeve dhe të realizojnë korrespondencën e nevojshme gjatë procedimeve, gjë e cila ka ulur ngarkesën e punës dhe ka shpejtuar gjykimin, siç shihet në Slloveni, Spanjë, Poloni, Turqi dhe Gjermani (shih faqet 36-37 më lart). Në ndihmë mund të vijë Udhërrëfyesi i Komisionit Europian për Eficencën e Drejtësisë, të Këshillit të Evropës,” Për masat strukturore të miratuara nga disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës për përmirësimin e funksionimit të së drejtës civile dhe administrative”, miratuar më 7 Dhjetor 2016.

13

Të merren masa për plotësimin sa më të shpejtë të trupave gjyqësore

Aktualisht Gjykata e Lartë funksionon me 9 gjyqtarë. Sipas një deklaratë të publikuar më 25 Qershor 2021, Kryetarja e KLGJ u shpreh se Gjykata e Lartë mund të arrinte të funksiononte me 10 gjyqtarë në Korrik 2021. Megjithatë, procesi ka vështirësi të shumta dhe nuk është e sigurtë se kur do të shtohet edhe anëtari tjetër i kësaj gjykatë, ndërsa do të ishim ende në nivelin e gjysmës së gjykatës edhe pas këtij zhvillimi.

14

Të plotësohet numri i këshilltarëve dhe personelit ndihmës, pavarësisht se vendet e gjyqtarëve janë ende vakantë

Aktualisht në Gjykatën e Lartë janë të punësuar 16 këshilltarë, nga të cilët 10 janë magjistratë dhe 6 jo magjistratë. Ndërsa është kërkesë ligjore të ruhet një raport 2 me 1 i këshilltarëve me gjyqtarët, ky numër mund të plotësohet deri në 36, aq sa të ruhet raporti me numrin në potencial të gjyqtarëve dhe jo me numrin real të tyre.

15

Të merren masa për emërimin e Kancelarit të Përhershëm

Sipas informacionit që disponojmë, nuk ka përfunduar procedura e emërimit të Kancelarit të Përhershëm të Gjykatës së Lartë. Është e nevojshme që ky proces të përfundojë, në mënyrë që puna të vijojë normalisht.

16

Të vihen në funksion Qendra e Dokumentacionit

Një synim i KLGJ është edhe ngritja e Qendrës së Dokumentacionit në Gjykatën e Lartë. Një ndër problemet e evidentuara që mund të pengonte ngrijen e qendrës është sigurimi i burimeve financiare. Nevojiten të merren masa që të sigurohen financat, të plotësohet stafi dhe të funksionojë qendra sipas vendimit të miratuar të KLGJ.

17

Të merren masat për emërimet e gjyqtarëve dhe ngritja e tyre në detyrë

KL Gj sjell në vëmendje se për pozicionet vakante në instancat gjyqësore ka hezitim të gjyqtarëve për shkak të efekteve psikologjike të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe vonesat në verifikimin e kandidatëve, por nuk referon asnjë zgjidhje. Ky ngërç ka nevojë të adresohet, pavarësisht se nuk varet vetëm nga shkaqe objektive.

18

Të merren masa për përshpejtimin/prioritizimin e procesit të vetingut

Një ndër problemet në procesin e emërimit të gjyqtarëve është dhe procesi i vetingut. KL Gj ka propozuar mekanizmin zhblllokues që lejon gjyqtarët e pavetuar të ngrihen në detyrë, përmes një verifikimi të brendshëm nga KL Gj, kur organet e vetingut nuk e finalizojnë vetingun e kandidatëve brenda një afati 3 mujor.

19

Të sigurohen mjetet financiare për ndërtimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve

Ndërtimi i një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas EURALIUS, arrin në vlerën prej 3.6 milion Euro dhe deri në momentin e publikimi të këtij raporti nuk është realizuar (përqindja e realizimit të treguesit të performancës është 21%). Nevojitet një shtysë serioze e të gjithë aktorëve që të mundësojnë realizimin e plotë të sistemit të menaxhimit të çështjeve, duke nisur nga aspekti financiar, e më tej në realizimin teknik të tij.

20

Të sigurohet infrastruktura e duhur duke rritur kapacitetin akomodues të godinës së Gjykatës së Lartë dhe të gjykatave të tjera.

Përmirësimi i infrastrukturës, duke shtuar ambientet, salla dhe zyra për administratën dhe njësitë ndihmëse të gjykatave, të Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të tjera, është një domosdoshmëri për zgjidhjen e kësaj problematike të veçantë, të raportuar nga vetë KL Gj, si dhe të ngritur edhe në tryezën konsultative që Res Publica zhvilloi me aktorë të shoqërisë civile dhe institucione miqësore, si Avokati i Popullit, në kuadër të hartimit të këtij raporti.

21

Të propozohet rritja e numrit të kandidatëve që hyjnë në Shkollën e Magjistraturës

Në kushtet kur numri i gjyqtarëve të larguar nga sistemi është i madh, rekomandohet rritja e numrit të kandidatëve që pranohen në Shkollën e Magjistraturës.

22

Të shihet mundësia e përfshirjes edhe të masave disiplinore ndaj avokatëve që haptazi abuzojnë me dorëzimin e rekurseve abuzive

Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të kërkojë bashkëpunimin me Dhomën e Avokatisë për të vlerësuar mundësinë e marrjes së masave disiplinore ndaj avokatëve të cilët bëjnë rekurse abuzive para Gjykatës së Lartë.

D. Masa që mund të merren nga Gjykata e Lartë

23

Të publikohen vendimet për kalimin e çështjes për njësim/ndryshim të praktikës gjyqësore dhe të konsiderohet Avokati i Popullit për të paraqitur amicus curiae

Publikimi i vendimit të ndërmjetëm për njësim/ndryshim të praktikës gjyqësore në faqen e gjykatës do të ndihmojë palët e treta të njihen dhe të paraqesin mendimet me shkrim. Një institucion i përshtatshëm për të paraqitur opinione amicus curiae është Avokati i Popullit, i cili ka njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore, si dhe ka një arkivë të mirë të rekomandimeve të formuara nga inspektime e analiza, të nxitura nga ankimet e paraqitura ndër vite. Opinion i këtij organi mund të konsiderohet nga gjykata, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 881, pika 7 e Kodit të Procedurës Civile.

24

Relacionet për çështjet të përgatiten nga nëpunësit/këshilltarët dhe të miratohen nga gjyqtarët

Meqënëse ekzistojnë mundësitë që të ketë abuzime me kërkesat për përshpejtim, pranë gjyqtarit mund të paraqiten kërkesa të shumta, duke rritur kështu volumin e punës. Në këto raste mund të mos jetë gjyqtari që duhet të paraqesë një relacion të detajuar, por t'u lihet nëpunësve gjyqësorë dhe/ose këshilltarëve dhe të vetëm të miratohet nga gjyqtari.

25

Vendimet e moskalimit në shqyrtim të çështjeve, si dhe vendimet e pranimit të rekurseve qartazi të bazuar, të përmbajnë një arsyetim të shkurtër

Në çështjet Gorou k. Greqisë (nr. 2) [DHM], no. 12686/03), apo edhe Vevecka k. Shqiperisë ((dec), nr. 40554/04) GJEDNJ është shprehur se “gjykatave të larta”, për shkak të rolit dhe pozitës në sistemet ligjore vendase, nuk u kërkohet të përfshijnë në gjykimet e tyre një arsyetim të hollësishëm kur thjesht u duhet të refuzojnë një rekurs si të papranueshëm, ose që

nuk ka asnjë shans “fitoreje”. Standardet e procesit të rregullt ligjor nuk shkelen nëse gjykata vendos moskalimin për shqyrtim, duke paraqitur një arsyetim të shkurtër e të përmbledhur, i cili është më i lehtë për t’u përgatitur dhe shkurton kohë.

Lidhur me vendimet qartazi të bazuar, shembull i Italisë, siç trajtohet më lart në raport, mund të konsiderohet si një opsion i mire gjithashtu. Gjykatat administrative mund të dalin me një vendim të formës së shkurtuar duke përmbledhur arsyet themelore kur gjykata vëren se një kërkesë është qartazi e bazuar ose, anasjelltas, dukshëm e pabazuar.

26

Gjykata të marrë vendime propio motu, duke shmangur kthimet për rigjykim

Njëlloj si në rastin e Sllovakisë, së trajtuar më lart, Gjykata e Lartë të zgjidhë propio motu çështjet, duke ndrequr vendimet e gjykatave më të ulëta dhe të dalë me një vendim të formës së prerë në vend që ta dërgojë çështjen për rishqyrtim në gjykatat më të ulëta. Me ndryshimet ligjore të fundit, të miratuara në Mars 2021, Gjykatës së Lartë iu shtua edhe kjo mundësi (siç ishte para reformës në drejtësi), dhe Gjykata e Lartë duhet të inkurajohet të veprojë sa më shumë në këtë mënyrë, e cila pavarësisht se mund të sjellë ngarkesë të shtuar në arsyetimin e vendimeve të tilla (të cilat statistikisht përbëjnë jo më shumë se 20% të rasteve), sjell shpejtimin e zgjidhjes së çështjes, i cili është synimi final i gjykimit në një kohë të arsyeshme.

27

Të përgatitet dhe shpërndahet një pyetësor për avokatët për çështjet që ata vlerësojnë prioritare

Avokatët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në filtrimin e çështjeve të prapambetura. Gjykata e Lartë mund të hartojë një pyetësor që përmban pyetje për të ndihmuar Gjykatën të klasifikojë çështjet në grupe të ndryshme dhe më pas të vendosë se cilit grupi duhet t’i jepet përparësi. Pyetësori mund të jetë elektronik dhe të zhvillohet në bashkëpunim me Dhomën e Avokatëve.

28

Të përmirësohet metodat dhe proceset e punës, për administrimin e dosjeve

Metodat aktuale manuale dhe elektronike të punës së Gjykatës nuk mbështesin përpunimin e efektshëm të çështjeve. Një ndër problemet e evidentuara është dhe sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve (ICMIS), i cili paraqet një sërë mangësish. Nevojitet të vijojë angazhimi i KLGJ që të adresojë problematikat e sistemit elektronik me bashkëpunim me dhe EURALIUS dhe me projektin “Drejtësi për të gjithë” të mbështetur nga USAID.

* * *

www.respublica.org.al
www.publeaks.al

